



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:
“Psikologji Shkollore”
Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc.Dr. Eglantina DERVISHI

Dr. Jonida LESH

Korrik / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesional në “Psikologji Shkollore”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Psikologji Shkollore”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 202, datë 28.05.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 192, datë 25.01.2011 Vendim Senati Nr. 6 datë 28.02.2018 Miratuar me shkrese MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 412, dt.28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim BA Nr. 57, datë 05.07.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	4 PAE/ 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020 - 24 studentë; 2020-2021 - 25 studentë; 2021-2022 - 26 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Albanian University" (AU) ish shkolla e lartë universitare jopublike "Ufo dental" është licensuar me VKM Nr. 197, datë 10.04.2004¹. Ka ndryshuar statusin dhe është riorganizuar sipas VKM Nr.597, datë 28.5.2009 për ndryshimin e emrit të Universitetit Privat "UFO University"² dhe gjithashtu mbështetur në VKM Nr. 603, datë 24.8.2011, për ndryshimin e emrit të universitetit privat nga "UFO University" në "Albanian University". Riorganizimi institucional është mbështetur në urdhrin e MAS Nr.52, datë 05.02.2016³. Albanian University është akredituar për herë të parë nga Bordi i Akreditimit me vendim Nr. 90, datë 20.10.2017 "Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Privat "Albanian University"⁴. Riakreditimi i dytë bazohet në Vendimin e BA-së, Nr. 01, date 24.01.2020 "Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat "Albanian University"⁵, me kohëzgjatjen prej 3 (tre) vite.

Albanian University përbëhet nga 3 Fakultete: Fakulteti i Shkencave Shoqërore; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Njësia bazë që e ofron Masterin Profesional në "Psikologji Shkollore" është Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme që është pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Ky program studimi i është nënshtruar një sër procedurash përgjatë viteve që ka qenë aktiv në AU, vlerësimi i parë në kuadër të licensimit të dhënë sipas Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr. 367, datë 17.09.2012⁶ ka qenë pozitiv me kushte, ndërsa vlerësimi i dytë në kuadër të licensimit: VKA Nr. 404, datë 11.01.2013⁷ ishte negativ, me argumentet përkatëse dhe pas tij vjen vlerësimi i tretë në kuadër të licensimit sipas Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr. 465, datë 03.05.2013⁸ i cili është pozitiv. Akreditimi i Bordit të Akreditimit Nr. 44, datë 19.05.2017⁹

¹Evidenca 11. Vendimi dt.10.04.2004 Për dhënien e lejes për hapjen e SHLUJ UFO Dental.

²Vendimi Për ndryshimin e emrit dhe hapjen e programeve të reja të studimit pranë SHLUP UFO Dental. Dokumenti nr 10.

³Evidenca 6. Urdhër për riorganizimin institucionaltë IAL (MAS – Albanian University).

⁴Vendimi për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Privat "Albanian University". Dokumenti nr 13.


⁵Evidenca 2. Vendimi për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti Privat "Albanian University"..

⁶ Evidenca 3. Vendim Universiteti Albanian University, për programet e studimit të ciklit të dyte që përfundojnë me Master Shkencor në 1. Psikologji Zhvillimi dhe Shkollore, 2. Këshillim PSikologjik. Për programet e ciklit të dytë që përfundojnë.

⁷ Evidenca 4. Vendim Universiteti Albanian University, për programet e studimit të ciklit të dyte që përfundojnë me Master Shkencor në 1. Psikologji Zhvillimi dhe Shkollore. Për programin e ciklit të dytë që përfundon në Master Profesional (MP) – Psikolog.

⁸ Evidenca 5. Vendim Universiteti Albanian University, për programet e studimit të ciklit të dyte që përfundojnë me Master Shkencor në 1. Psikologji Zhvillimi dhe Shkollore. Për programin e ciklit të dytë që përfundon në Master Profesional (MP)

⁹ Evidenca 7. Vendimi për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në PSikologji Shkollore, te Universitetit privat Albanian University.



(ndryshuar me VBA Nr. 44/1, datë 15.12.2017¹⁰; ndryshuar me VBA Nr. 44/2, date 02.02.2018)¹¹ - Akredituar vetëm për brezat e studentëve aktualisht të regjistruar dhe që ndjekin studimet në këtë program, përfshirë ata të regjistruar në vitin akademik 2017-2018, deri në diplomimin e tyre. Me vendim senatin nr. 6 date 28.02.2018, është riorganizuar programi në 60 ECTS me kohezgjatje 1 vit akademik. Ky riorganizim është miratuar me shkresë MASR Nr. 6313/2 prot, date 18.07.2018¹² dhe regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë të formës së Diplomës sipas UMASR Nr. 552, datë 01.11.2017¹³; dhe mbështetur në Urdhërin Nr. 412, dt.28.10.2020¹⁴. Ky program studimi i hapur me urdhër të MASH Nr. 202, dt.28.05.2013¹⁵, akredituar me vlersim pozitiv me rekomandime sipas VBA nr.57, datë 05.07.2019¹⁶, me kohëzgjatje akademike 3 vite - akreditimi i mëparshëm mbaron në 30.09.2022.

¹⁰ Evidenca 8 Vendim Për ndryshimin e VBA nr 44 datë 19.05.2017 "Për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Psikologji Shkollore", të Universitetit privat Albanian University

¹¹ Evidenca 9 Vendim Për ndryshimin e VBA nr 44 datë 19.05.2017 "Për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Psikologji Shkollore", të Universitetit privat Albanian University

¹² Evidenca 10. Shkresë kthim përgjigje nga MASR për riorganizimin e MP universitetit Privat Albanian University.

¹³ Evidenca 11. Urdhër për regjistrimin e formave të diplomave Bachelor, Master Profesional, Master I Shkencave dhe Diplomë Specializimi, 01.11. 2017, të Universitetit Privat "Albanian University"

¹⁴ Evidenca 14. Urdhër për regjistrimin e formave të diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Psikologji Shkollore" të Universitetit Privat "Albanian University"

¹⁵ Evidenca 1. Urdhër për hapjen e programit të studimit MSc, Psikologji Zhvillimi dhe Shkollore dhe MP Psikologji Shkollore ne Albanina University.

¹⁶ Evidenca 12. Vendim Nr.57, datë 05.07.2019

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI PERIODIK

Mbështetur në Vendimin Nr. 57, datë 05-07-2019.¹⁷ Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dyrë, Master Profesional në “Psikologji Shkollore”, Universiteti Privat “Albanian University” vlersohet pozitivisht me kohëzgjatje 3 (tre) vjeçare me rekomandimet e mëposhtme:

1. Institucioni të përfshijë në syllabuset e programit të studimit instrumentat e nevojshme për përkthimin e aftësive didaktiko-akademike në kompetenca profesionale;

Duke iu referuar këtij rekomandimi ndeshemi në vështirësi për të vlerësuar drejtë përmbushjen e tij nga ana e Albanian University. Syllabuset¹⁸ kanë një lloj konfuzioni përse i përket tipologjisë së lëndës dhe njohurive didaktiko-teorike që formojnë, kjo duke iu referuar një sër problemesh lidhur me temat mësimore dhe njohurive teorike që janë për nivelin bachelor dhe që nuk të lejojnë profilizimin pastaj në linjë me profilin shkollor. Po i referohemi syllabusit të lëndës “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolehentët”¹⁹ i cili duke iu referuar tematikave mësimore 1, 2,3,4,5,6, 7,8,9,10 fokusohet tek komunikimi si mjet ndërveprimi social dhe aspak i lidhur me tipologjinë e lëndës e aq më pak në linjë me nevojat e studentëve apo në funksion të zhvillimit të ndonjë lloj kompetence profesionale në fushën e psikologjisë shkollore. E njëjta situatë paraqitet edhe për syllabuset e lëndëve “ Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”²⁰; “Hyrje në Psikologji Shkollore”²¹, “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²² të cilat përmes temave të trajtuara nuk të japin mundësi për të zhvilluar ndonjë kompetencë të re e aq më pak të lidhur me këtë profil profesional, përvece një përsëritje të koncepteve bazë të temave të trajtuar në nivelin bachelor në fushën e psikologjisë së zhvillimit, këshillimit apo komunikimit social. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se *ky rekomandim përmbushet pjesërisht.*

2. Institucioni të rishikoj syllabuset e programit të studimit lidhur me organizimin dhe formulimin e tematikave si dhe përditësimin e literaturës në funksion të realizimit të programit të studimit, kombëtare e ndërkombëtare;

Për të vlerësuar këtë rekomandim Grupi i Vlerësimit të Jashtëm duke marrë në shqyrtim syllabuset e këtij program studimi, vlereson se ato paraqesin probleme lidhur me brendinë e tyre në dy drejtime kryesore:

- a. Temat e trajtuara nuk përputhen në pjesën me të madhe me tipologjinë e lëndës, si “Dimensioni Kongitiv -Sjellor, Nxitja e aftësive Akademike dhe Menaxhimi Sjellor”

¹⁷Vendimi Nr. 57, datë 05-07-2019. Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dyrë, MP në “Psikologji Shkollore”, Universiteti Privat “Albanian University”

¹⁸ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

¹⁹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁰ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²¹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²² Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

ku brendia e temave kanë një fokus në psikologjinë kongitive, të ezauruara nga studentët në nivelin bachelor. Po ashtu duke iu referuar syllabusit të lëndës “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²³, kemi tema që fokusohen në një hyrje në psikologjinë e zhvillimit sesa në tipologjinë e kësaj lëndë bazuar në emërtimin e saj, ku mund të përmendim disa prej temave si “Aspekte të përgjithshme të Zhvillimit”; “Teoritë e Zhvillimit Psikologjik”; “Metodat e vëzhgimit në psikologjinë e zhvillimit” etj. Po ashtu lënda “Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”²⁴ po të shohësh me vëmendje temat e trajtuara duket se jep një informacion më tepër për psikologjinë e këshillimit dhe lë pak ose aspak hapsira për aspekte që kanë të bëjnë me dilemat dhe sfidat profesionale të psikologut shkollor, më të pakuptimtë pastaj e bëjnë edhe temat që nuk kanë lidhje me psikologun shkollor por atë ligjor si psh tema me titull “Shkruajtja e raporteve për përdorim gjyqësor” kur e dimë se një psikolog shkollor vetëm referon dhe nuk merret me hartimin e raporteve të vlerësimit për nevojat e gjykatës; apo tema numër 10 me titull “Cështjet e etikës në punën me minoritetet seksuale” termi “minoritet seksual” si koncept nuk na ndihmon të kuptojmë qartë llojin e informacionit që trajton apo lidhjen me rolin e psikologut shkollor në drejtim të formimit të kompetencave profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët? Një tjetër problematikë lidhet me temën numër 3 që fokusohet tek kontrata e miratimit të informuar me titullin “Kontratat e psikologëve me dhe brenda organizatave” dhe temën numër 5, 12 që sërish fokusohet tek kontrata e miratimit të informuar dhe konfidencialiteti. Lëndët “Hyrje në Psikologji Shkollorë”²⁵ dhe “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²⁶ paraqesin një situatë të paqartë bazuar në përmbajtjen e syllabuseve, ku tema të caktuara përsëriten sërish edhe pse të dyja këto lëndë bazuar te syllabuset²⁷ realizohen në auditor nga i njëjti lektor. I referohemi edhe lëndëve “Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”²⁸ dhe “Hyrje në Psikologji Shkollorë”²⁹ ku në të dyja këto lëndët trajtohet tema “Etika e Psikologut Shkollorë” edhe pse me të njëjtët student presupozohet se cështjet etike të jenë ezauruar plotësisht në lëndën që i dedikohet etikës.

Bazuar tek lënda tjetër “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolështentët” kemi një situatë shqetësuese lidhur me bredninë e temave të cilat nuk kanë lidhje me tipologjinë e kësaj lëndë të përshtatur për nevojat e studentëve të ciklit të dytë të studimeve, por më tepër për nevojat e nxënësve apo studentëve të nivelit bachelor lidhur me elementët bazë të komunikimit, citojmë këtu tema të caktuara mësimore si: tema 1- Objektivat e shkencës së psikologjisë së komunikimit; Modelet kryesore të komunikimit”; tema 2- Elementët, faktorë dhe cështje që lejojnë përparësitë dhe nxisin pengesat në procesin e komunikimit”; tema 3 – “Procesi i dëgjimit, Qëndrimet dhe situata optimale gjatë komunikimit”. Gjithashtu një problematikë e cila duhet adresuar lidhet me faktin që si

²³ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁴ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁵ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁶ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁷ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁸ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

titullar i lëndës “Hyrje në Psikologji Shkollore”³⁰ figuron E. H. me titullin akademik Profesor i Asociuar që i përket profilit të biologjisë pa ndonjë lidhje me degën e psikologjisë. Kjo evidencë paraqitet si shqetësuese lidhur me mënyrën sesi mund të jetë ky syllabus në përputhje me profilin e psikologut shkollore. Profesion i psikologut bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009³¹, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar³². Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Bazuar në syllabuset e lëndëve mësimore dhe te titullarët³³ e angazhuar në hartimin e syllabuseve në këtë master evidentohet se një pjesë e stafit nuk është brenda profilit të psikologjisë. *Në rolin e GVJ gjykojmë se ndoshta një vëmendje e shtuar duhet të tregohet në lidhje me disa pedagogë të cilët u përkasin disiplinave të tjera dhe që mund të cungojnë nivelin e njohurive të trasmetuara tek studentët e masterit profesional në “Psikologji Shkollore”.*

- b. Literature bazë e përdorur në një pjesë të konsiderueshme të tyre është e para një dekade, dhe një pjesë e kësaj literature përpos faktit që është botim i para 10-20 viteve, ajo është ezauruar në lëndë specifike gjatë ciklit të parë të studimeve nga ana e studentëve. I referohemi tekstit “Etika në Këshillim” e autoreve M. Dh & A.S.; “Psikologji Zhvillimi” që përdoret si tekst bazë për lëndën “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”³⁴. Për lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët” si literaturë bazë janë dy tekste: “Psikologji Komunikimi” B. C (2001) dhe “Psikologji Komunikimi” e autores A. SH (2008). Të dy tekste që i përshtaten njohurive të përgjithshme për komunikimin në përgjithësi, për studentët e nivelit bachelor dhe pa një lidhje të qarte me lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët”. Gjithashtu duke u bazuar në syllabuset e lëndës dhe në dokumentacionin në dispozicion kemi vështirësi të vlersojmë në mënyrë objektive mbi “Draft leksionesh të pedagogut” e cila është cituar si pjesë e literaturës bazë të përdorur për disa lëndë, por që nuk shoqërohet me ciklin e leksioneve që të mund ta shqyrtojmë e të japim një opinion lidhur me të. Gjithashtu bazuar tek syllabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” sipas të dhënave rezulton se kjo lëndë realizohet në auditor, e ndarë në dy semestra, 120 orë, e shoqëruar me tema mësimore mbi: “Zhvillimin e aftësive të të menduarit”; “Zhvillimin emocional”; “Këshillimin individual”; “Këshillimin në grup”; “Droga, duhani. Alkoli” etj dhe si literaturë bazë kemi librin autores G. S. “Nga teoria në praktikë” tekst për metodologjinë e të nxënit. GVJ është konfuz lidhur me mënyrën sesi një tekst që nuk i trajton këto tema e ndihmon titullarin e lëndës dhe lektorin në auditor t’i trajtojë para studentëve në lëndën e “Praktikës Profesionale”. Një tjetër lëndë

³⁰ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

³¹ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

³² Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

³³ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

³⁴ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

me problematika është edhe “Vlerësimi dhe këshillimi me fëmijët dhe adoleshentët” me tema të cilat nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejt me tipologjinë e lëndës por fokusohen te “Roli i shkollës e komuniteti”, “Roli i psikologut shkollorë” apo “Shkolla dhe organizimi i sistemeve zhvillimi i politikave dhe mjedisi”. Njohuri këto që nëse i referohemi syllabuseve që GVJ shqyrtoi janë dhënë nga i njëjti pedagog edhe në një lëndë tjetër që jep në këtë master si “Hyrje në Psikologji Shkollorë”³⁵. Dhe më tej temat përsëriten për një tjetër lëndë “Psikologjia Sociale e Mjediseve Shkollorë”. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se *ky rekomandim përmbushet pjesërisht*.

3. Institucioni të shtojë në kurrikulën e programit të studimit lëndën e “Metodave të Kërkimit Shkencor”, si një domosdoshmëri për formimin e studentëve përpara diplomimit të tyre;

Në lidhje me këtë rekomandim të dhënë nga Bordi i Akreditimit (BA) për institucionin e arsimit të lartë “Albanian University” duke iu referuar planit mësimorë³⁶ nuk evidentojmë ndonjë ndryshimi në këtë plan dhe integrimin në të, të një lënde apo moduli të “Metodave të Kërkimit Shkencor”. Gjithsesi ky rekomandim i dhënë nga BA duhet vlersuar në linjë me bazën ligjore në fuqi, duke respektuar Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”³⁷; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”³⁸ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, ku si formë e menaxhimit të detyrimeve përmbyllëse në kuadër të diplomës mund shfrytëzohen dy opsione që ligji t’i lejon në kuadër të detyrimeve përmbyllëse si”- opsioni i dhënies së një provimi të përgjithshëm të formimit teorik , - ose dosje profesionale përmes studimit të rastit. Të dyja këto forma i përshtaten këtij masteri profesional dhe zgjidhja në këtë mënyrë mbështetet edhe në bazën ligjore në fuqi. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se *ky rekomandim përmbushet pjesërisht*.

4. Institucioni të rregullojë praktikat profesionale përmes marrëveshjeve specifike në terma specifike, përfshirë në to edhe sistemin e mentorimit;

Bazuar në të dhënat që disponohen kemi vështirësi të kuptojmë mënyrën e realizimit të lëndës së “Praktikës Profesionale”³⁹ pasi duke iu referuar syllabusit të lëndës, duket se praktika profesionale realizohet në auditor. Sipas të dhënave rezulton se kjo lëndë realizon 120 orë në

³⁵ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

³⁶ Evidenca 20. Plani mësimorë në MP Psikologji Shkollorë

³⁷ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

³⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 04-06-2022).

³⁹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

auditor, e ndarë në dy semestra e shoqëruar me tema mësimore, edhe pse në planin mësimor ajo figuron si veprimtari që i përket kategorisë D dhe është pjesë e lëndëve plotësuese që realizohet në terren. Ndërkohë duke iu referuar këtij profili profesional dhe kompetencave profesionale që duhet të zhvillojnë studentët në terren përmes eksperiencës së praktikës synohet që institucionet e përzgjedhura të jenë shkolla, kopshte apo cerdhe publike apo private, me qëllim që t'i ndihmojnë ato të realizojnë objektivat e lëndës në fjalë. Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit⁴⁰ në funksion të praktikës profesionale për masterin profesional në “Psikologji Shkollore” kemi disa marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e lartë Universitare “Nehemiah Gateway” Pogradec; një tjetër institucion i quajtur SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës, një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”, Bashkia Tiranë, organizata “Rrjeti Akademik Shqiptar” dhe Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”⁴¹. Marrëveshjet e nënshkruara nga AU në funksion të realizimit të praktikës profesionale vazhdojnë të mos kenë impakt në cilësinë e programit të studimit PM “Psikologji Shkollore” duke mos qenë të lidhur drejtpërdrejt me fushën e psikologjisë shkollore, por më tepër i përshtaten nevojave të profilit të psikologjisë klinike. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se **ky rekomandim përmbushet pjesërisht.**

5. Institucioni të shtoj aplikimet në projekte aplikative kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e psikologjisë shkollore dhe të mundësojë përfshirjen në to të stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi;

Mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni e kemi të vështirë të vlerësojmë përmbushjen e këtij rekomandimi. Nuk rezulton ndonjë dokument ku tregohet aplikimi i njësisë bazë apo grupit të pedagogëve të këtij programi e studentëve në ndonjë projekt kombëtar e ndërkombëtar⁴². Bazuar në raportin vjetor të njësisë bazë⁴³ rezulton aplikimi individual nga ana e përgjegjësit të njësisë bazë në 3 projekte kombëtare. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se **ky rekomandim përmbushet kryesisht.**

⁴⁰ Edivenca 8. Marrëveshje për praktikën mësimore.

⁴¹ Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Marrëveshjet MP psikologji Shkollore

⁴² Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Raport Vjetor NJSBC v.a. 2020-2021.

⁴³ Evidenca 33. Raporti vjetor 2020-2021.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit 1 vjecar Master Profesional në “Psikologji Shkollore” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit, aplikuar nga Universiteti Privat “Albanian University”. Grupi i vlerësimit të jashtëm i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Eglantina Dervishi (drejtuese e grupit), Dr. Jonida Lesha (anëtare), dhe Msc. Majlinda Demireli (koordinatore teknike) nisi punën për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universitetin Privat “Albanian University”, MASR, publikun e gjerë dhe studentët sesi programi i studimit përmbush standardet. Përmes këtij raporti njësisë kryesore dhe bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale për studentët. Standartet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në gjashtë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit Master Profesional; Struktura dhe Përmbajtja e Programit të Studimit Master Profesional; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit dhe Mbështetja e Studentëve; Studentët dhe Mbështetja e tyre, Sigurimi i Cilësisë së Programit të Studimit Master Profesional. Vlerësimi i secilës fushe bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a- nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin cdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimit të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit master profesional në “Psikologji Shkollore”.

Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 15.07.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24/25 Prot, datë 18.07.2022. Universiteti Privat “Albanian University” përcjell në ASCAL më datë 22 Korrik, me anë të shkresës me Nr. 482 Prot, datë 21.07.2022 “Kthim përgjigje shkresës Nr. 24/25 Prot, datë 18.07.2022”.

Bazuar në shqyrtimin e komenteve të ardhura nga institucioni lidhur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit MP në “Psikologji Shkollore”, GVJ rikujton se në asnjë pjesë të raportit nuk është përdorur gjuhë fyese, siç pretendohet dhe ripërmendet disa herë përgjatë komenteve mbi draft-raportin e vlerësimit të jashtëm. GVJ vlerëson përkushtimin dhe seriozitetin e treguar nga institucioni për të adresuar në mënyrë specifike secilën prej çështjeve të mëposhtëme, por sugjeron mbajtjen e një komunikimi korrekt në përballjen me situatën, duke shmangur kapjen pas justifikimeve që duan të shpërqëndrojnë vëmendjen nga problematikat kryesore që adreson raporti. Shpresojmë që komentet tona bazuar në evidencat e dokumentacionit institucional të dërguar në ASCAL, si dhe të dhënat e gjeneruara duke aksesuar faqen zyrtare të AU-së, të jenë tashme ezauruese, dhe të ndihmojnë institucionin që të njëjtin përkushtim dhe angazhim të shfaqin edhe në drejtim të marrjes në konsideratë të rekomandimeve të GVJ, me qëllim përmirësimin e standarteve të cilësisë në programin e studimit MP në “Psikologji Shkollore”.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi draft-Raportin të paraqitura sipas fushave, shprehet si vijon:

6. Lidhur me komentën që bëhet për **Rekomandimin 1. të akreditimit të mëparshëm** *“Institucioni të përfshijë në syllabuset e programit të studimit instrumentat e nevojshme për përkthimin e aftësive didaktiko-akademike në kompetenca profesionale”* GVJ ka marrë në konsideratë se:

Bazuar në dokumentacionin e dërguar pranë ASCAL është realizuar edhe vlersimi i rekomandimeve të dhëna nga akreditimi⁴⁴ mëparshëm i këtij programi studimi. Bazuar në problematikat e shumta të evidentuara në Raportin e Vlersimit të Jashtëm duke cituar dokumentacionin⁴⁵; që institucioni ka dërguar, gjykojmë se argumentat tona janë ezauruese lidhur me nivelin e përbushjes së këtij rekomandimi. Gjithashtu rikujtojmë njësinë bazë që cungimi i njohurive që të lejonë përkthimin e aftësive-didaktiko akademike në kompetenca profesioanle është një komponent i rëndësishëm i formimit profesional të studentit, për të cilin institucioni ka përgjegjësi ligjore ta garantojë përmes mbështetjes në respektimin e udhëzimeve që rregullojnë këtë aspekt si Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”⁴⁶; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁴⁷ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009⁴⁸, “Për

⁴⁴Vendimi Nr. 57, datë 05-07-2019. Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dyrë, MP në “Psikologji Shkollore”, Universiteti Privat “Albanian University”

⁴⁵ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁴⁶ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

⁴⁷ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 04-06-2022).

⁴⁸ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave për përfshirjen e profesionit të psikologut në grupin e profesioneve të rregulluar. Argumenti i sjell lidhur me justifikimin e ripërsëritjes së njohurive të marra në nivelin bachelor për t’u ritrajtuar në nivelin master për qëllime të rritjes profesionale, mbetet e paqartë sesi mund të ndihmojë studentët e një profili profesional të përfitojnë nga njohuri të përgjithshme të marra në një cikël të mëparshëm studimi. Vlerësimin e përmbushjes së këtij rekomandimi GVJ e ka bazuar në shqyrtimin e brendisë së disa komponentëve të syllabuseve të lëndëve mësimore si: temat e leksionit, temat e seminarit, literatura e përdorur. Vlerësimi i këtij komponenti është bërë duke u mbështetur në një sër elementësh. Gjithashtu rikujtojmë Institucioni se të gjitha komentet mbi përmbushjen e këtyre rekomandimeve u janë prezantuar përfaqësuesve të institucionit në takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, përfaqësuesit e institucionit i pranuan dhe nuk i kundërshtuan ato⁴⁹. Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.

7. Lidhur me komentin që bëhet për **Rekomandimin 2**, “*Institucioni të rishikoj syllabuset e programit të studimit lidhur me organizimin dhe formulimin e tematikave si dhe përditësimin e literaturës në funksion të realizimit të programit të studimit, kombëtare e ndërkombëtare*” GVJ ka marrë në konsideratë se:

Duke marrë në shqyrtim syllabuset e këtij program studimi, vleron se ato paraqesin probleme lidhur me brendinë e tyre në dy drejtime kryesore:

- Temat e trajtuara nuk përputhen në pjesën më të madhe me tipologjinë e lëndës, specifikisht lëndët; 1-“Dimensioni Kongitiv -Sjellor, Nxitja e aftësive Akademike dhe Menaxhimi Sjellor”; 2-“Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”; 3-“Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”; 4-“Hyrje në Psikologji Shkollore”; 4-“Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët”; 5- lëndës “Praktikë Profesionale”; 6-“Vlerësimi dhe këshillimi me fëmijët dhe adoleshentët”.
- Literature bazë e përdorur në një pjesë të konsiderueshme të tyre është e para një dekade, dhe një pjesë e kësaj literature përpos faktit që është botim i para 10-20 viteve, ajo është ezauruar në lëndë specifike gjatë ciklit të parë të studimeve nga ana e studentëve.
 - a. Në raport nuk është kërkuar ndërhyrje në syllabuset e lëndëve duke kaluar masën 20% se kjo kërkon nisjen e procedurave të riorganizimit të këtij program studimi. Është sugjeruar nga GVJ, të merren masa që të përmirësohen syllabuset. Duke qenë se kjo çështje u është parashtruar si problematikë nga akreditimi i mëparshëm, dhe përgjatë 3 viteve akademike, koha për të përmirësuar aspekte të caktuara, duke ruajtur kufirin e 20%, mund të ketë qenë e mjaftueshme.
 - b. Lidhur me literaturën është e pavend justifikimi i mospasjes së literaturës bazë në gjuhën shqipe, duke qenë se Institucioni presupozohet se ka infrastrukturën e nevojshme për të mbuluar nevojat e programit të studimit kur kërkon të licensohet dhe akreditohet. Kjo qoftë përsa i përket infrastrukturës, fizike, bazës së literaturës

⁴⁹ Evidencë 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

akademike për fushën specifike dhe burimet njerëzore të kualifikuara për këtë nevojë. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë u nënshtrohen të njëjtave rregulla dhe procedura dhe u përgjigjen individualisht këtyre kritereve, ashtu sic edhe vlersohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, individualisht. Gjykojmë se koha nga licensimi, hapja dhe riorganizimi i këtij program duhet të kenë qenë të mjaftueshme për t'i dhënë kohë institucionit të reflektojë dhe të ndërmarrë hapa konkret për adresimin e këtyre çështjeve.

Bazuar në argumentat e lartpërmendura, lutemi institucionit, për më tepër hollësi t'i referohet dokumentacionit institucional që kemi shqyrtuar, duke cituar dhe dhënë referencën e plotë për çdo evidencë tonën të paraqitur në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.

8. Lidhur me komentin që bëhet për **Rekomandimin 3**, "*Institucioni të shtojë në kurrikulën e programit të studimit lëndën e "Metodave të Kërkimit Shkencor", si një domosdoshmëri për formimin e studentëve përpara diplomimit të tyre*", GVJ ka marrë në konsideratë se:

Komenti ynë si grup lidhet me mospërfshirjen në planin mësimor⁵⁰ të ndonjë ndryshimi në këtë plan dhe integrimin në të, të një lënde apo moduli të "Metodave të Kërkimit Shkencor", siç sugjeron rekomandimi nga akreditimi i mëparshëm. Por as nuk sheh të jetë ndërmarrë ndonjë nismë nga institucioni për ta zgjidhur këtë problem në bazë të hapsirës që të jep Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"⁵¹; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"⁵² dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, ku si formë e menaxhimit të detyrimeve përmbyllëse në kuadër të diplomës mund shfrytëzohen dy opsione që ligji t'i lejon në kuadër të detyrimeve përmbyllëse si"- opsioni i dhënies së një provimi të përgjithshëm të formimit teorik, - ose dosje profesionale përmes studimit të rastit. GVJ sugjeron se të dyja këto forma i përshtaten këtij masteri profesional dhe zgjidhja në këtë mënyrë mbështetet edhe në bazën ligjore në fuqi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm duke iu referuar dokumentacionit si udhëzimi i temës së diplomës, takimit me stafin akademik, studentëve dhe përgjegjës të njësive bazë, konkludon se detyrimet përmbyllëse përmbushem akoma me mbrojtje teme diplome, me një metodologji të mirëfilltë të kërkimit shkencorë edhe pse ky master nuk zhvillon kompetenca të tilla tek studentët. Institucionit i mbetet të ndërhyjë për të bërë këtë rregullim i cili nuk kërkon asnjë sforcë dhe është në linjë me udhëzimet ligjore në fuqi. Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.

⁵⁰ Evidenca 20. Plani mësimorë në MP Psikologji Shkollore

⁵¹ Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri" https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

⁵² VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 04-06-2022).

9. Lidhur me komentin që bëhet për **Rekomandimin 4**, “*Institucioni të rregullojë praktikat profesionale përmes marrëveshjeve specifike në terma specifike, përfshirë në të edhe sistemin e mentorimit*” GVJ ka marrë në konsideratë se:

Bazuar në të dhënat që disponohen nga takimet me stafin, njësinë bazë, studentët dhe syllabusin e lëndës, rezultojnë se praktika nuk realizohet në institucione që janë në linjë me profilin profesional të këtij programi studimi. Profili profesional është ai i psikologut shkollor, i cili është pjesë e organigramës së institucioneve të arsimit parauniversitar në vendin tonë. Kjo lëndë ka dhe një handicap tjetër që lidhet me tjetërsimin e natyrës së saj duke dalë jashtë kornizës konceptuale të këtij masteri. Lënda e “Praktikës Profesionale”⁵³ duke iu referuar syllabusit të lëndës, realizohet në auditor. Sipas të dhënave rezultojnë se kjo lëndë realizon 120 orë në auditor, e ndarë në dy semestra e shoqëruar me tema mësimore, edhe pse në planin mësimor ajo figuron si veprimtari që i përket kategorisë D dhe është pjesë e lëndëve plotësuese që realizohet në terren. Gjithashtu bazuar tek syllabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” sipas të dhënave rezultojnë lënda trajton tema mësimore mbi: “Zhvillimin e aftësive të të menduarit”; “Zhvillimin emocional”; “Këshillimin individual”; “Këshillimin në grup”; “Droga, duhani. Alkoholi” etj dhe si literaturë bazë kemi librin autores G. S. “Nga teoria në praktikë” tekst për metodologjinë e të nxënësve. GVJ është konfuz lidhur me mënyrën sesi një tekst që nuk i trajton këto tema e ndihmon titullarin e lëndës dhe lektorin në auditor t’i trajtojë para studentëve në lëndën e “Praktikës Profesionale”. Ndërkohë duke iu referuar këtij profili profesional dhe kompetencave profesionale që duhet të zhvillojnë studentët në terren përmes eksperiencës së praktikës synohet që institucionet e përzgjedhura të jenë shkolla, kopshte, cerdhe publike apo private, me qëllim që t’i ndihmojnë ato të realizojnë objektivat e lëndës në fjalë. Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit⁵⁴ në funksion të praktikës profesionale për masterin profesional në “Psikologji Shkollore” kemi disa marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e lartë Universitare “Nehemiah Gateëay” Pogradec; një tjetër institucion i quajtur SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës, një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”, Bashkia Tiranë, organizata “Rrjeti Akademik Shqiptar” dhe Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”⁵⁵. Marrëveshjet e nënshkruara nga AU në funksion të realizimit të praktikës profesionale vazhdojnë të mos kenë impakt në cilësinë e programit të studimit PM “Psikologji Shkollore” duke mos qenë të lidhur drejtpërdrejt me fushën e psikologjisë shkollore, por më tepër i përshtaten nevojave të profilit të psikologjisë klinike. *Për sa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon.*

⁵³ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁵⁴ Evidenca 8. Marrëveshje për praktikën mësimore.

⁵⁵ Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Marrëveshjet MP psikologji Shkollore

Duke iu referuar komenteve të institucionin lidhur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, kemi këto komente:

1. Standarti II.1-

Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.

- Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” duhet të synojë përmes moduleve dhe lëndëve⁵⁶, të formojë shprehi dhe kompetenca në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes në kontekstin shkollor, por pak hapsirë të jep bazuar në përmbajtjen e syllabuseve, literaturës së përdorur nga ana e stafit akademik të angazhuar në program studimi. Kjo bazuar në rolin profesional të psikologut shkollor cënon cilësinë në mësimdhënie si në drejtim të zhvillimit të shprehive profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët, por gjithashtu edhe si këshilluese në institucione shkollore ku marrin shërbime psikologjike kategori të fëmijëve me nevoja të veçanta. Për të pasur më të lehtë orientimin e studentëve në tregun e punës por edhe drejt vetëpunësimit të tyre kërkohen kompetenca profesionale që justifikojnë emërtimin e këtij masteri.

Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.

- Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” mbështetur në përmbajtjen e programeve lëndore dhe literaturën e përdorur janë dy element të rëndësishëm në drejtim të njohurive të përparuara për këtë fushë studimi dhe më tej në drejtim të zhvillimit të kompetencave shkencore dhe profesionale të studentëve. Përmbajtja e programit të studimit krijon kushte për zhvillim kompetencash profesionale të psikologut shkollor por duket e kufizuar hapsira nëse i referohemi përmbajtjes së lëndëve mësimore dhe literaturës së përdorur⁵⁷. Gjithsesi njësia bazë duhet të mbështetet personelin akademik me infrastrukturën e duhur me tekste fizike që mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. Pavarsisht faktit që institucioni ka akses në disa platforma elektronike të literaturës, kjo nuk garanton në të gjitha rastet publikime cilësore dhe akses në revista e libra me indeks të lartë.

Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

- Programi i studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Shkollore” duhet të jetë konform pritshmërive të studentëve për të zhvilluar kompetencat e shprehive profesionale në drejtim të njohurive teoriko-praktike për të punuar si psikolog shkollor pas përfundimit

⁵⁶ Evidenca 66. Tabelat.

⁵⁷ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

të masterit. Gjithashtu drejtimi i secilës lëndë⁵⁸ përmban një sër veprimtarish didaktiko-praktike që duhet të realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin praktik të koncepteve teorike nga ana e studentit. Përvoja e praktikës profesionale e cila duhet të jetë organizuar në mënyrë që t'u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës si kopshtet, cerdhet dhe shkollat publike apo private.

Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.

- Syllabuset e programit të studimit të ciklit të dytë në MP në “Psikologji Shkollore” janë konform Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”⁵⁹; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe disa shtesave që i janë bërë VKM Nr. 41, Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021⁶⁰. Syllabuset e secilës lëndë janë të organzuara sipas strukturës si më poshtë me: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat dhe konceptet themelore, temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sër veprimtarishë praktike që realizohen si pjesë e seminareve. Syllabusi i praktikës profesionale⁶¹ paraqet disa handikape në mënyrën sesi është hartuar dhe zbatuar, referuar asaj çfarë përmban plani mësimor i kësaj lëndë të shqyrtuar nga GVJ në dokumentacionin që AU ka depozituar pranë ASCAL.

Bazuar në këto kritere që janë pjesë e Standartit 2.1, Shkalla e përmbushjes së standardit nuk ndryshon.

2. Standarti II.3

Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

- Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” sipas informacioneve të marra gjatë vizitës në institucione me drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të programit të lëndëve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Mbetet të shohim stabilizimin e tij në linjë me kërkesat e një arsimi

⁵⁸ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁵⁹ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

⁶⁰ VKM nr.185, datë 25.3.2021 për ndryshime në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL e RSH” <https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per-ndryshime-ne-vkm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/> (Aksesuar më 04.06.2022)

⁶¹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushën e psikologjisë shkollore.

*Gjatë takimit në institucion si në takimin me njësinë bazë dhe Njësinë e kurrikulës nuk u konfirmua të ishte ndërmarrë ndonjë inisiativë në drejtim të përmirësimit dhe përditësimit, asnjëherë e jo në mënyrë të vazhdueshme, cdo fillim viti akademik. Gjë e cila pasqyrohet edhe në problematikat e shumta që ka në drejtim të syllabuseve të lëndës dhe të mënyrës sesi realizohet praktika profesionale te ky program studimi . Bazuar në këtë kriter që është pjesë e Standartit 2.3, **Shkalla e përmbushjes së standardit nuk ndryshon.***

3. Standarti II. 4

Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

- Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” duhet të synojë zhvillimin e njohurive teoriko-praktike tek studentët, në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuar në tregun e punës për profesionin e psikologut shkollor. Gjithashtu programi duhet të përfshijë element mbi zhvillimin e disa shprehive profesionale që e ndihmojnë psikologun shkollor të realizojë detyrën e tij në ofrimin e shërbimeve psikologjike në mënyrë profesionale. Mbështetur në disa element të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij gjykojmë se programi i pasqyron ato pjesërisht. Kemi një balancë midis mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimorë, ndarjen sipas semestrave, orë në auditor dhe frekuentimin, vlersimin e dijeve dhe një sër aktivitetesh specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët. Bazuar në planin mësimorë të lëndeve kemi të vështirë të konfirmojmë arritjen e objektivave formuese, bazuar në temat mësimore apo literaturën e përdorur nga pedagogu, e cila nuk i përshtatet nivelit master. Ndërsa duke iu referuar emërtimit dhe komponentëve mësimore, numrit të krediteve, kohëzgjatjes së studimeve ky program lejon transferimin e studimeve, mobilitetet apo dhe licensimin e studentit pas përfundimit të studimeve. Ajo që mbetet për t’u diskutuar është niveli i njohurive dhe kompetencave profesionale të fituara nga studenti në përfundim të tij.

Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.

- Duke iu referuar përditësimit të literaturës bazë e përdorur në një pjesë të konsiderueshme të syllabuseve të lëndëve mësimore është e para një dekadë, dhe një pjesë e kësaj literature përpos faktit që është botim i para 10-20 viteve, ajo është ezauruar në lëndë specifike gjatë ciklit të parë të studimeve nga ana e studentëve. I referohemi tekstit “Etika në Këshillim” e autoreve M. Dh & A.S.; “Psikologji Zhvillimi” që përdoret si tekst bazë për lëndën “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”⁶². Për lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëscentët” si literaturë bazë janë dy tekste: “Psikologji Komunikimi” B. C (2001) dhe “Psikologji Komunikimi” e autores A. SH (2008). Të dy tekste që i

⁶² Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

përshtaten njohurive të përgjithshme për komunikimin në përgjithësi, për studentët e nivelit bachelor dhe pa një lidhje të qarte me lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adoleshentët”. Gjithashtu duke u bazuar në syllabuset e lëndës dhe në dokumentacionin në dispozicion kemi vështirësi të vlersojmë në mënyrë objektive mbi “Draft leksionesh të pegagogut” e cila është cituar si pjesë e literaturës bazë të përdorur për disa lëndë, por që nuk shoqërorhet me ciklin e leksioneve që të mund ta shqyrtojmë e të japim një opinion lidhur me të. Gjithashtu bazuar tek syllabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” sipas të dhënave rezultojnë se kjo lëndë realizohet në auditor, e ndarë në dy semestra, 120 orë, e shoqëruar me tema mësimore mbi: “Zhvillimin e aftësive të të mënduarit”; “Zhvillimin emocional”; “Këshillimin individual”; “Këshillimin në grup”; “Droga, duhani. Alkoli” etj dhe literaturë të autores G. S. “Nga teoria në praktikë” tekst për metodologjinë e të nxënit. GVJ është konfuz lidhur me mënyrën sesi një tekst që nuk i trajton këto tema e ndihmon titullarin e lëndës dhe lektorin në auditor t’i trajtojë para studentëve në lëndën e “Praktikës Profesionale”. Një tjetër lëndë me problematika është edhe “Vlerësimi dhe këshillimi me fëmijët dhe adoleshentët” me tema të cilat nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejt me tipologjinë e lëndës por fokusohen te “Roli i shkollës e komuniteti”, “Roli i psikologut shkollorë” apo “Shkolla dhe organizimi i sistemeve zhvillimi i politikave dhe mjedisi”. Njohuri këto që nëse i referohemi syllabuseve që GVJ shqyrtoi janë dhënë nga i njëjti pedagog edhe në një lëndë tjetër që jep në këtë master si “Hyrje në Psikologji Shkollore”⁶³. Dhe më tej temat përsëriten për një tjetër lëndë “Psikologjia Sociale e Mjedisëve Shkollore”. Kujtojmë institucionin dhe strukturat përgjegjëse për këtë program studimi se profesioni i psikologut bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009⁶⁴, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar⁶⁵. Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. *Nga sa më sipër rezultojnë e vështirë përmbushja e këtij kriteri sipas vlersimit të bërë nga GVJ.*

Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.

- Duke iu referuar këtij kriteri konstatojmë se temat e trajtuara nuk përputhen në një pjesë të tyre me tipologjinë e lëndës, psh. si “Dimensioni Kongitiv - Sjellor, Nxitja e aftësive Akademike dhe Menaxhimi Sjellor” ku brendia e temave kanë një fokus në psikologjinë kongitive, të ezauaruara nga studentët në nivelin bachelor. Po ashtu duke iu referuar syllabusit të lëndës “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”⁶⁶, kemi tema që fokusohen në një hyrje në psikologjinë e zhvillimit sesa në tipologjinë e kësaj lëndë bazuar në emërtimin e saj, ku mund të përmendim disa prej temave si “Aspekte të përgjithshme të Zhvillimit”; “Teoritë e Zhvillimit Psikologjik”; “Metodat e vëzhgimit në psikologjinë e zhvillimit” etj. Po ashtu lënda “Etika

⁶³ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁶⁴ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

⁶⁵ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

⁶⁶ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

Profesionale e Psikologut Shkollor”⁶⁷ po të shohësh me vëmëndje temat e trajtuara duket se jep një informacion më tepër për psikologjinë e këshillimit dhe lë pak ose aspak hapsira për aspekte që kanë të bëjnë me dilemat dhe sfidat profesionale të psikologut shkollor, më të pakuptimtë pastaj e bëjnë edhe temat që nuk kanë lidhje me psikologun shkollor por atë ligjor si psh temat me titull “Shkruajtja e raporteve për përdorim gjyqësor” kur e dimë se një psikolog shkollor vetëm referon dhe nuk merret me hartimin e raporteve të vlerësimit për nevojat e gjykatës; apo tema numër 10 me titull “Cështjet e etikës në punën me minoritetet seksuale” termi “minoritet seksual” si koncept nuk na ndihmon të kuptojmë qartë llojin e informacionit që trajton apo lidhjen me rolin e psikologut shkollor në drejtim të formimit të kompetencave profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët? Një tjetër problematikë lidhet me temën numër 3 që fokusohet tek kontrata e miratimit të informuar me titullin “Kontratat e psikologëve me dhe brenda organizatave” dhe temën numër 5, 12 që sërisht fokusohet tek kontrata e miratimit të informuar dhe konfidencialiteti. Lëndët “Hyrje në Psikologji Shkollore”⁶⁸ dhe “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”⁶⁹ paraqesin një situatë të paqartë bazuar në përmbajtjen e syllabuseve, ku tema të caktuara përsëriten sërisht edhe pse të dyja këto lëndë bazuar te syllabuset⁷⁰ realizohen në auditor nga i njëjti lektor. I referohemi edhe lëndëve “Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”⁷¹ dhe “Hyrje në Psikologji Shkollore”⁷² ku në të dyja këto lëndët trajtohet tema “Etika e Psikologut Shkollorë” edhe pse me të njëjtët student presupozohet se cështjet etike të jenë ezauruar plotësisht në lëndën që i dedikohet etikës. Bazuar tek lënda tjetër “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adoloshentët” kemi një situatë shqetësuese lidhur me bredninë e temave të cilat nuk kanë lidhje me tipologjinë e kësaj lëndë të përshtatur për nevojat e studentëve të ciklit të dytë të studimeve, por më tepër për nevojat e nëxësve apo studentëve të nivelit bachelor lidhur me elementët bazë të komunikimit, citojmë këtu tema të caktuara mësimore si: tema 1- Objektivat e shkencës së psikologjisë së komunikimit; Modelet kryesore të komunikimit”; tema 2- Elementët, faktorë dhe cështje që lejojnë përparësitë dhe nxisin pengesat në procesin e komunikimit”; tema 3 – “Procesi i dëgjimit, Qëndrimet dhe situata optimale gjatë komunikimit”. Gjithashtu një problematikë e cila duhet adresuar lidhet me faktin që si titullar i lëndës “Hyrje në Psikologji Shkollore”⁷³ figuron E. H. me titullin akademik Profesor i Asociuar që i përket profilit të bio-kimisë pa ndonjë lidhje me degën e psikologjisë. Kjo evidencë paraqitet si shqetësuese lidhur me mënyrën sesi mund të jetë ky syllabus në përputhje me profilin e psikologut shkollor. Profesionin e psikologut bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009⁷⁴, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesionin e psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar⁷⁵. Profesionin e rregulluar është një veprimtari apo

⁶⁷ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁶⁸ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁶⁹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁷⁰ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁷¹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁷² Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁷³ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁷⁴ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

⁷⁵ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Bazuar në syllabuset e lëndëve mësimore dhe të titullarët⁷⁶ e angazhuar në hartimin e syllabuseve në këtë master evidentohet se një pjesë e stafit nuk është brenda profilit të psikologut.

Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.

- Duke iu referuar syllabuseve të lëndëve mësimore ashtu sic jemi shprehur më sipër ato kanë një sër problemesh të lidhura me temat mësimore që shpesh janë jo të lidhura drejtpërdrejtë me këtë profil profesional përsa i përket aftësive dhe kompetencave profesionale që duhet të formojë tek studentët e këtij program profesional. Gjithashtu edhe literature e përdorur e cila jo vetëm është botim i para një apo dy dekadave më parë, në një pjesë të lëndëve mësimore është edhe përsëritje e njohurive të dhëna në nivelin bachelor.

Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

- Duke iu referuar një sër elementësh që kanë të bëjnë me përmbajtjen e programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore” mund të themi se programi bazuar në emërtimin e tij dhe në një sër elementësh që lidhen me komponentët mësimore dhe sistemin e krediteve (ECTS) mundëson që studentët të futen në procedurat për licensim pranë Urdhrit të Psikologut, por mungesa e zhvillimit të kompetencave profesionale dhe shprehive teorike mund të krijojë vështirësi për studentët, kjo gjë gjithashtu do të kishte ndikim negativ edhe në punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

Në lidhje me komentin tuaj për Standartin II.4,

- a) kujtojmë institucionin se GVJ është kompetent në fushën që mbulon dhe këtë aspekt e vleron ASCAL paraprakisht, kur përcakton grupin e ekspertëve sipas kualifikimit dhe kompetencave profesionale, duke u mbështetur në ndershmërinë, korrektësinë, transparencën dhe vlerat morale të ekspertëve të saj. GVJ jep rekomandime për të gjitha ato aspekte që janë pjesë e Fushave të vlersimit, standarteve dhe kriterëve të përfshira në këtë raport. Këtë proces pune e mbështet në Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021⁷⁷ lidhur me vlerësimin e këtij program studimit. Aspekte të tjera nuk janë as në kompetencat dhe as në interes e GVJ.

- b) Duke iu referuar vizitës në institucion, konkretisht takimin me përfaqësues të njësisë bazë, stafit akademik, zyrës së kurrikullës dhe cilësisë, nuk rezulton të jetë ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me këtë kriter. Komentet tona i mbështesim pikërisht në të dhënat që institucioni juaj

⁷⁶ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁷⁷ Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë. (2021). Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021. <https://www.ascal.al/sq/sigurimi-i-cilesise/kodi-i-cilesise>. (Aksesuar më 22.07.2022).

na siguron si në formë dokumentash ashtu edhe përmes takimeve informuese të realizuar për qëllime të raportit të vlerësimit të programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore”.

- c) Kujtojmë institucionin se GVJ jep rekomandime të cilat mund të merren ose jo në konsideratë nga institucioni. Por ka një bazë ligjore e cila detyron institucionet e arsimit të lartë t’i përmbushin si përsa i përket kualifikimit të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie në linjë me kualifikimin akademik, fushën e ekspertizës profesionale dhe kontributit në veprimtari kërkimore -shkencore në linjë me programin e studimit ku ato angazhohen. Për informacione më të hollësishme, referojuni Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”⁷⁸; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁷⁹ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009⁸⁰, “Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave për përfshirjen e profesionit të psikologut në grupin e profesioneve të rregulluar.

- d) Kujtojmë institucionin se rekomandimet tona bazohen në njohjen e mirë të fushës profesionale të cilën po vlerësojmë dhe mënyrës sesi komponentët përbërës të secilës fushë janë në funksion të një programi që mundëson vizibilitetin e diplomës në tregun e punës dhe në vijimin e një karriere profesionale. Duke u cunguar dijet dhe njohuritë, bazuar në problemet me syllabuset, kompetencat profesionale referuar mënyrës sesi realizohet praktika profesionale në auditor dhe në institucione të përzgjedhura për të, ku nuk ka psikolog shkollore, çënohet në mënyrë të drejtpërdrejtë kualifikimi profesional i studentëve dhe hallka e parë është pikërisht përballja me provimin e shtetit, në të cilin duhet të demostrojnë njohuri -teoriko-praktike mbi profilin e tyre. Të drejtën instiucionit për ta zhvilluar këtë program studimi sipas vizionit të tij nuk ia heq as GVJ përmes rekomandimeve të dhëna, e askush tjetër. Rekomandimet tona bazohen në detyrimin e instiucionit për respektuar bazën ligjore në fuqi përsa i përket mënyrës sesi ofron këtë program studimi. Bazuar në këto kritere që janë pjesë e Standartit 2.4, *Shkalla e përmbushjes së standardit nuk ndryshon.*

4. Standarti II. 6

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

⁷⁸ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

⁷⁹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 04-06-2022).

⁸⁰ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

- Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme konform rregullave të paracaktuara nga ligjet në fuqi dhe kjo evidentohet në statutin e AU -së, mbështetur në rregulloren e këtij programi studimi. Kordinimi i punës midis njësisë kryesore, asaj bazë dhe rolit të kordinatorit të programit të studimit⁸¹ në “Psikologji Shkollore” krijojnë një infrastrukturë të përshtatshme për mbarëvajtjen e punës në këtë program studimi. Në drejtim të bashkëpunimit me partner nga tregu i punës nuk kemi evidence për të gjykuar mbi ndëveprim të drejtpërdrejt me profesionistët e terrenit në kontekstin e praktikës profesionale.

Bashkëpunimi me tregun e punës ndoshta do të kishte ndihmuar njësinë bazë të adresonte më mënyrën e duhur dhe në kohë të gjitha problematikat e hasura me syllabuset, literaturën, dhe organizimin e praktikës profesionale, e cila theksojmë se realizohet duke rënë ndësh me vendimin e hapjes, licensimit dhe akreditimit të mëparshën në të cilën Praktika Profesionale është lëndë e Kategorisë D, e që duhet të realizohet në terren, dhe të shoqërohet në një syllabus që rregullon çështjen e mentorimit në institucion me mentorimin në terrenin profesional nga një profesionist, psikolog shkollore, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në cerdhe, kopshte dhe shkolla.

Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.

- Duke iu referuar këtij kriteri rezulton e vështirë të vlerësohet ky kriter bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion. Mbetet e paqartë sesi institucionin ka reflektuar pas një sër sfidash që ka pasur ky program studimi që përgjatë ekzistencës së tij që nga licensimi i tij në 2013 për të përmbushur kriteret për ofrimin e një program cilësor. Bazuar në raportin vjetor 2020-2021⁸² kemi disa aktivitete që janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit institucional që AU ka nënshkruar për shkëmbim të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore, por janë kryesisht konferenca shkencore studentore dhe disa leksione të hapura të me të ftuar. Këto institucione vështirë të krijojnë mundësi stë mirë në drejtim të realizimit të praktikave profesionale apo dhënies së njohurive mbi fushën e studimit të këtij masteri profesional në të gjitha rastet.

Kriteri në vetvete i rithotë ato që janë çështje që duhen adresuar lidhur me plotësimin e tij. GVJ për të mos dashur të përsëris, nuk ka shtuar gjë tjetër, pasi gjykon se informacioni i dhënë të ndihmon të kuptosh drejtë situatën. Bazuar në këto kritere që janë pjesë e Standartit 2.4, Shkalla e përmbushjes së standardit nuk ndryshon.

5. Standarti III. 1

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

- AU dhe njësia kryesore dhe ajo bazë në drejtim të realizimit të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit

⁸¹Evidenca 22. Kordinator i programit.

⁸² Evidenca 33. Raporti vjetor 2020-2021.

akademik të angazhuar në mësimdhënie, ka ngritur një strukturë të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë^{83,84}, i cili punën e tij e bazon në tre dokumenta që janë: Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,⁸⁵ Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti⁸⁶ dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë⁸⁷. Gjithashtu dhe një sër vendimesh që lidhen me ekspertizën e jashtme që i shtohet kësaj strukture në drejtim të rritjes së cilësisë të lidhur me vendimarrjen e Bordit të Administrimit për konsulencë juridike pranë Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nga Dr. E. P⁸⁸, dhe vendimi për të propozuar Prof. Asoc. B. K.⁸⁹ në rolin e konsulentit për çështjet e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave në “Albanian University” konsiderohen si tepër të rëndësishme në funksion të misionit për rritjen e cilësisë. Përmes tyre duhet të monitorohet puna e personelit akademik dhe ndihmës akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor. Pavarësisht këtyre strukturave dhe burimeve njërezore në dispozicion të rritjes së cilësisë dhe të përmirësimit të kurrikulave, ky program studimi ka këto vështirësi të cilat po kompromentojnë cilësinë në mësimdhënie.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

- AU duke iu referuar strukturave të ngritura lidhur me monitorimin e ecurisë së programeve të vlerësimit në nivel institucional ndërmerr një sër veprimtarish në drejtim të monitorimit të cilësisë. Mbështetur në raportimin nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmes raporteve që i ka vënë në dispozicion Njësisë Bazë do duhej të kishte pasur një reagim në favor të rritjes së cilësisë.

*Lidhur me këto kritere gjykojmë se ka një mospërputhje në të kupturit e situatës ku kemi një sër strukturash mbështetëse për monitorimin e cilësisë në mësimdhënie dhe nga ana tjetër problematikat e shumta që ky program ka në drejtim të përmbajtjes së lëndëve mësimore, literaturës, realizimit të praktikës profesionale dhe mënyrës sesi është hartuar syllabusi i kësaj të fundit. Bazuar në këto kritere që janë pjesë e Standartit 3.1, **Shkalla e përmbushjes së standardit nuk ndryshon.***

6. Standarti III. 3

Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.

⁸³ Evidenca 52. Vendim senati për krijimin e komisionit të përhershëm në rang institucional.

⁸⁴ Evidenca 51. Vendim senati për ngritjen e zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë në rang institucional.

⁸⁵ Evidenca 59. Rregullore e NJSBC.

⁸⁶ Evidenca 53. Sigurimi I cilësisë njësia bazë

⁸⁷ Evidenca 54. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

⁸⁸ Evidenca 55. Vendimi i Bordit të Administrimit konsulente juridike pranë NJSBS Dr. E. P.

⁸⁹ Evidenca 56. Vendim mbi caktimin e personelit akademik si konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Prof. Asoc. B. K.

- Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit nga GVJ konstatojmë se literatura bazë në gjuhën shqipe, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin një literaturë e cila nëse i referohemi syllabuseve të lëndëve mësimore⁹⁰ të vënë në dispozicion paraqesin një sër mangësish. Një pjesë e literaturës bazë është e një viti botimi e një deкаде më parë dhe shkon ndesh me kërkesat ligjore për përditësim të literaturës mësimore me një literaturë të viteve të fundit dhe një pjesë e kësaj literature përpos faktit që është botim i para 10-20 viteve⁹¹, ajo është ezauruar në lëndë specifike gjatë ciklit të parë të studimeve nga ana e studentëve. I referohemi tekstit “Etika në Këshillim” e autoreve M. Dh & A.S.; “Psikologji Zhvillimi” që përdoret si tekst bazë për lëndën “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”⁹². Për lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët” si literaturë bazë janë dy tekste: “Psikologji Komunikimi” B. C (2001) dhe “Psikologji Komunikimi” e autores A. SH (2008). Të dy tekste që i përshtaten njohurive të përgjithshme për komunikimin në përgjithësi, për studentët e nivelit bachelor dhe pa një lidhje të qarte me lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët”. Gjithashtu bazuar tek syllabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” sipas të dhënave rezulton se kjo lëndë realizohet në auditor, e ndarë në dy semestra, 120 orë, e shoqëruar me tema mësimore mbi: “Zhvillimin e aftësive të të mënduarit”; “Zhvillimin emocional”; “Këshillimin individual”; “Këshillimin në grup”; “Droga, duhani. Alkoli” etj dhe literaturë të autores G. S. “Nga teoria në praktikë” tekst për metodologjinë e të nxënit. GVJ është konfuz lidhur me mënyrën sesi një tekst që nuk i trajton këto tema e ndihmon titullarin e lëndës dhe lektorin në auditor t’i trajtojë para studentëve në lëndën e “Praktikës Profesionale”. Një tjetër lëndë me problematika është edhe “Vlerësimi dhe këshillimi me fëmijët dhe adoleshentët” me tema të cilat nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejt me tipologjinë e lëndës por fokusohen te “Roli i shkollës e komuniteti”, “Roli i psikologut shkollorë” apo “Shkolla dhe organizimi i sistemeve zhvillimi i politikave dhe mjedisi”.

Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.

- Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Shoqërore ka në dispozicion të drejtimin kryesore për programin e studimit një numër të caktuar tekstesh në gjuhën shqipe⁹³. Gjithashtu sipas informacionit të marrë pranë bibliotekës kemi një listë prej 175 tekstesh fizike, nga të cilat 40 në fushëm e psikologjisë. Prej të cilave pjesa më e madhe e tyre kanë një vit botimi para 2010, ndërsa ato pak tekste dhe artikuj të viteve të fundit janë punime doktrature dhe artikuj shkencorë. Një pjesë e vogël e teksteve janë në gjuhë të huaj kryesisht botime të viteve 2001-2010. Nuk kemi mjaftueshëm evidenca të vëna në dispozicion nga institucioni për të gjykuar mbi cilësinë e literaturës së detyruar që duhet të përditësohej nga pedagogu dhe që duhet ishte e viteve të fundit, (siç deklarohej nga

⁹⁰ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁹¹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁹² Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

⁹³ Evidenca 6. Procedura e blerjes se teksteve 2019,2020, 2021.

përgjegjësi i njësisë kryesore dhe bazë), kjo pasi nga shqyrtimi i literaturës në bibliotekë nuk përputhet me kërkesën e institucionit në drejtim të teksteve mësimore. Kërkesën tonë për të parë një procedurë për marrjen e teksteve të reja për këtë vit akademik nuk i vu në dispozicion ndonjë informacion apo material as nga biblioteka dhe njësisia bazë.

*GVJ e bën vlerësimin e Standarteve duke u mbështetur në mënyrë rigoroze në cdo kriter që përfshihet në këtë raport. Në këto kushte jemi të detyruar të theksojmë çështje të caktuar që trajtohen e ritrajtohen në Standarte e Kritere të ndryshme sa herë që do të parashtrihen. Format i Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, është një instrument i standartizuar nga ASCAL dhe detyron si ekspertë vlerësimi nuk është tjetërsimi, por respektimi i ngurtë i cdo kriteri që përbën këtë raport. Bazuar në këto kritere që janë pjesë e Standartit 3.3, **Shkalla e përmbushjes së standardit nuk ndryshon.***

7. Standarti III. 4

Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

- Duke iu referuar nevojës në rritje për cilësisë në mësimdhënie, një sër aktivitetesh janë ndërmarrë nga institucioni, si trajnime të stafit akademik⁹⁴, leksione të hapura, tryeza të rumbullakta etj. Ndër to mund të evidentojmë trajnimin e Prof. G. A. me tematikë mbi “Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit ERASMUS+⁹⁵. Përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Optime” dhe pjesëmarrjes në konferencat që AU organizon pa pagesë për stafin e tij akademik, gjithashtu synon të mbështetet ky aspekt nga institucioni. *Megjithatë nuk kemi ndonjë evidencë që stafi i angazhuar në këtë program studimi të shfrytëzojë këto mundësi.*

Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.

- Në lidhje me këtë kriter nuk kemi evidencë të qarta përse i përket testimit dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat e reja në mësimdhënie. Por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, dhe formulari i vetvlerësimit të performancës, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie. azuar në këto kritere që janë pjesë e Standartit 3.4, **Shkalla e përmbushjes së standardit nuk ndryshon.**

⁹⁴ Evidenca 17. Shkresa për modulet e trajnimit.

⁹⁵ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Psikologji Shkollore”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	“Albanian University” që ofron programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Shkollore” zotëron të gjithë mekanizmat e nevojshëm në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me statutin e tij të brendshëm ⁹⁶ , rregullores së AU-së ⁹⁷ e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁹⁸ ; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁹⁹ dhe Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019. Kjo është evidentuar edhe në Rregulloren e njësisë kryesore ¹⁰⁰ dhe asaj të njësisë bazë ¹⁰¹ , por edhe atë të programit të studimit ¹⁰² që mbështetet në misionin dhe qëllimet e tij dhe në linjë me nevojat e tregut të punës, në linjë me interesat kombëtarë.
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të dytë master profesional në “Psikologji Shkollore” është në thelb në linjë me vlerat akademike, kulturore kombëtare në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ¹⁰³

⁹⁶ Evidenca 14. Statuti i Albanian University.

⁹⁷ Evidenca 12. Rregullore e përgjithshme AU.

⁹⁸ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

⁹⁹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁰⁰ Evidenca 60. Rregullore e FSHSH.

¹⁰¹ Evidenca 19. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

¹⁰² Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

¹⁰³ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” <https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKEN>

	janë pasqyruar në statutin e tij dhe rregullores së njësish kryesore ¹⁰⁴ e asaj bazë ¹⁰⁵ , dhe rregullores së programit të studimit ¹⁰⁶ të ciklit të dytë master profesional në "Psikologji Shkollore".			
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të dytë master profesional në "Psikologji Shkollore" është në përputhje me qëllimin dhe misionin e AU-së dhe është integruar në linjë me fushën e studimit brenda njësish bazë të tij, Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme. Gjithashtu duke iu referuar kushteve specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve, ky program studimi respekton lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendshme që synon zhvillimin e kompetencave profesionale të studentit dhe paisjen me diplomë referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ¹⁰⁷ sipas të gjitha rregullave dhe ligjeve të shtetit.			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi i ciklit të dytë në "Psikologji Shkollore" konsiderohet një profil i nevojshëm dhe në linjë me zhvillimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar në vendin tonë. Shërbimi psiko-social konsiderohet i një rëndësie të vecantë përsa i përket rolit mbështetës të sektorit psiko-social që ofron shërbime psikologjike për kategorinë e fëmijëve dhe adoleshentëve përgjatë viteve të shkollimit. Duke u mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar (GVJ) i cili lidhet me studimin e tregut të punës ¹⁰⁸ paraqesin një prespektivë optimiste dhe me një fushë të gjerë veprimi, gjë që reflektohet edhe në brendësi të raportit me një garanci në drejtim të përfitimit të njohurive teorike dhe trajnimeve profesionale që lehtësojnë vizibilitetin e diplomës së tyre në tregun e punë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

CORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KE RKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁰⁴ Evidenca 60. Rregullore e FSHSH.

¹⁰⁵ Evidenca 19. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

¹⁰⁶ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

¹⁰⁷ Ligj Nr. 23/2018 Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10 247, Datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve" http://qsha.gov.al/infos/njesim_diplome/ligj_23-2018_10052018.pdf (Aksesuar më 05-06-2022).

¹⁰⁸ Evidenca 10. Analiza e tregut të punës.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

27

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit master profesional në “Psikologji Shkollore” është në linjë me strategjinë e zhvillimit institucional ¹⁰⁹ dhe synon konsolidimin e dijeve, respektimit të lirisë akademike, autonomisë së stukturave përkatëse në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit në drejtim të avancimit në cilësinë e programeve të studimit, duke synuar hapjen e programeve në gjuhë të huaj. Dokumentacioni i Institucionit i shqyrtuar nga GVJ gjithashtu shpalos ambicjen e tij edhe në drejtim të ndërkombëtarizimit përmes përfshirjes në projekte të Bashkimit Evropian, edhe pse nuk kemi evidentuar ndonjë hap konkret të ndërmarrë nga institucioni deri tani.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Duke iu referuar statutit të AU-së ¹¹⁰ dhe rregullores së institucionit ¹¹¹ në të pasqyrohet ambicja e institucionit në drejtim të zhvillimit në të gjitha drejtimit akademike, si dhe të rritjes së cilësisë në programet e studimit të ofruara prej tij. Kjo linjë përthyeret në kontributit konkret në drejtim të prioriteteve të tij akademik edhe në mënyrën sesi është hartuar program i studimit në “Psikologji Shkollore”, duke iu përshtatur kësaj politike të brendëshme të institucionit.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit master profesional në “Psikologji Shkollore” ofrohet duke qenë në linjë me prioritetet e institucionit. Mbështetur në të dhënat e vëna në dispozicion, konfirmojmë se emërtimi, organizimi struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit dhe strategjisë së tij për zhvillim ¹¹² . Ndërsa duke iu referuar planit strategjik të njësisë bazë ¹¹³ ai fokusohet në disa aktivitete ekstrakurrikulare në të cilat janë përfshirë pedagogë e student të kësaj njësie, por që nuk të ndihmon të kuptosh se ky synon ta cojë njësinë bazë kjo strategji.

¹⁰⁹ Evidenca 11. Plani strategjik institucional 2017-2022.

¹¹⁰ Evidenca 14. Statuti i Albanian University.

¹¹¹ Evidenca 14. Statuti i Albanian University.

¹¹² Evidenca 11. Plani strategjik institucional 2017-2022.

¹¹³ Evidenca 13. Plani strategjik i departamentit të psikologjisë së përgjithshme.

<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar konform ligjit për Arsimin e Lartë¹¹⁴ dhe akteve nënligjore¹¹⁵ përsa i përket hartimit të tij¹¹⁶ dhe duke qenë në linjë me prioritetet kombëtare lidhur me shërbimet psiko-sociale në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Hartimi dhe zhvillimi i programit të studimit jep një kontribut të drejtpërdrejt në fushën e shërbimeve mbështetëse për nevojat e shoqërisë në fushën e edukimit. Kjo lidhur me rolin e psikologut shkollor si një profesionist i që mbështet, ndihmon, orienton fëmijët, adoleshentët, stafet pedagogjike drejt krijimit të një klime mbështetëse për të gjithë në kontekstin shkollor. Në kushtet aktuale roli i këtij programi studimi me drejtim human, na jep mundësinë të gjithëve të mund të edukohemi me vlerat e larta të respektit për dinjitetin, integritetin dhe kompetencat profesionale për t’i shërbyer komunitetit tonë në një kohë sfidash të shumta.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfaqësojnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Psikologji Shkollore” synon formimin e kompetencave dhe shprehive praktike që do t’i lejojnë studentët të orientohen lehtësisht drejt rolit të tyre profesional. Objektivat e tij janë të përcaktuar qartë në planin e tij mësimorë përmes lëndëve të lidhura që përmban e përmes të cilave synon zhvillimin e kompetencave teoriko-praktike që i përgjigjen nevojave të profilit profesional të</p>

¹¹⁴ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri.

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

¹¹⁵ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 04-06-2022).

¹¹⁶ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/view?as=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UËZËNhMËEiYjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).



<p>duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>psikologut shkollor. Në rregulloren e programit të studimit¹¹⁷ janë të përcaktuara qartë objektivat akademik që synojnë t'i japin këtij program studimi një karakter profesional me dije dhe kompetenca në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes psikologjike në kontekstin shkollor. Kjo në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”¹¹⁸, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” si dhe Vendimi nr. 879. datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave¹¹⁹ nevojat e tregut të punës për psikolog shkollorë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Studimi i tregut të punës për profilin e psikologut shkollorë është bazuar kryesisht në të dhënat që grupi i cili ka bërë dhe analizën e tregut të punës duke u mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit mbi të dhënat e marra nga alumni. Nga të dhënat e Zyrës së Karrierës dhe Alumni (AU)¹²⁰ që përfshirjnë vitet 2018-2021, rezulton se 75% e studentëve janë të punësuar. Gjithashtu sipas analizës së tregut të punës, bazuar në të dhënat e marra përmes vet-raportimit të studentëve rezulton se 65% e studentëve janë të punësuar brenda profilit të tyre të studimit dhe 60 % jasht profilit, ndërsa 5 % nuk kanë dhënë informacion. Këto të dhëna duken pak konfuze në terma shifrash dhe përqindjesh, kjo ndosha lidhur me ndonjë lapsus në të shkruar, gjithsesi kjo gjë nuk na lejon të qartësohemi shumë. Bazuar në analizën e tregut të punës gjithashtu rezulton se mbështetur në numrin e lartë të institucioneve të arsimit parauniversitare publike dhe private ka një nevojë të lartë për psikolog shkollor dhe kjo është një tjetër argument për vijimin e investimit në zhvillimin e këtij program studimi nga ana e AU-së.</p> <p><i>GVJ sugjeron grupin hartues të këtij raporti të tregohen më të kujdeshmën me mënyrën sesi formulohet raporti me qëllim që</i></p>

¹¹⁷ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollorë

¹¹⁸ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

¹¹⁹ Vendimi nr. 879. datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).

¹²⁰ Evidenca 10. Analiza e tregut të punës.

	<i>të mos ndeshemi në paqartësi lidhur me atë që është brendia e tij, pasi raporti fillon si analizë për programin psikologji klinike dhe vijon me profilin e psikologjisë shkollore, më tej shifrat duken konfuzë dhe nuk të qartësojnë idetë mbi atë që po lexon.</i>
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” duhet të udhëhiqet nga parimi i zhvillimit të kompetencave profesionale të psikologut shkollor dhe kjo gjë shpaloet në mënyrën sesi është hartuar programi, objektivat formuese të tij etj. Gjithashtu referuar mënyrës sesi do të realizojë formimin e studentit të profilit të psikologjisë shkollore në drejtim të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale ka një sër strukturash ku mund të mbështetet sic janë plani mësimor i cili duhet parë si themelet e formimit profesional të studentit dhe për këtë është e rëndësishme një thellim në dije, njohuri e aftësi. Njohuritë teorike dhe përvojat praktike do të lejojë më pas një profilizim në përputhje me prirjet, kompetencat dhe interesat profesionale të studentit, gjë të cilën programi parashikohet ta realizojë.
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Programi i studimit MP në “Psikologji shkollore” duke u bazuar në përmbajtjen e programit lëndor ¹²¹ dhe tipologjinë e lëndëve të formimit karakterizues dhe integruese është i përafërt edhe me një sër programesh të tjera në IAL-et publike e private në vend. Sigurisht bëhet e vështirë të vlersohet mundësia e transferimit të studimeve apo punësimin në tregun ndërkombëtar kjo edhe në një sër kushtesh të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejtë me cilësinë e programit të studimit. Megjithatë duhet vlersuar synimi i AU për të fokusuar vëmendjen te ndërkombëtarizimi i programeve të studimit kjo bazuar në planin e tij strategjik ¹²² , duke synuar ofrimin e programeve në gjuhë të huaj, si një ide që do kontribuojë në lehtësimin e procesit të mobilitetit, transferimit dhe njësimin të diplomës edhe në tregun ndërkombëtar. Në thelb ky program studimi përmes lëndëve dhe moduleve synon paisjen e studentit me njohuri dhe kompetenca që janë të ngjashme me atë që mund të marrë një student edhe nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend për këtë profil profesional.
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e	Programi i studimit Master Profesional në “Psikologji Shkollore” është hartuar duke u mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në

¹²¹ Evidenca 20. Plani mësimorë në MP Psikologji Shkollore

¹²² Evidenca 11. Plani strategjik institucional 2017-2022.

<p>përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,¹²³, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” si dhe Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave¹²⁴ dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021¹²⁵. Vlen të theksohet se bazuar në historikun e vendit tonë për fushën e Psikologjisë ka patur një mungesë përvoje në drejtim të zhvillimit të kësaj shkence para viteve 90. Duhet të kemi parasysh se programet lëndore tipikisht përgjatë gjithë historisë së zhvillimit të kësaj disipline janë bazuar dhe kanë evoluar duke u mbështetur në programet ndërkombëtare dhe duke marrë si model zhvillim, qasjen që këto vende kanë pasur ndaj psikologjisë. Në këtë kuadër përgjithësisht programet e studimit në këtë fushë kanë ngjashmëri në drejtim të programit lëndor dhe objektivave formuese e kompetencave profesionale që synojnë të zhvillojnë. Gjithashtu një sër elementësh të strukturës së këtij programi studimi si kreditet sipas Sistemit Evropian të Trasferimit të Krediteve (ECTS)¹²⁶, kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlersimit, profili i programit, diploma¹²⁷ dhe suplementi i saj¹²⁸ etj, janë të gjithë element të pranishëm që janë në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura</p>	<p>Referuar të dhënave që disponohen kemi vështirësi të kuptojmë mënyrën e realizimit të lëndës së “Praktikës Profesionale”¹²⁹ pasi duke iu referuar syllabusit të lëndës, duket se praktika profesionale realizohet 120 orë në auditor, e ndarë në dy semestra e shoqëruar me tema mësimore, edhe pse</p>

¹²³ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

¹²⁴ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2U8ZEnhMEEIYjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).

¹²⁵ VKM nr.185, datë 25.3.2021 për ndryshime në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL e RSH” <https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per-ndryshime-ne-vkm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/> (Aksesuar më 04.06.2022)

¹²⁶ Evidenca 66. Tabelat.

¹²⁷ Evidenca 61. Format diplome.

¹²⁸ Evidenca 63. Suplement dhe listë notash.

¹²⁹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.

në planin mësimor ajo figuron si veprimtari që i përket kategorisë D dhe është pjesë e lëndëve plotësuese që realizohet në terren. Ndërkohë duke iu referuar këtij profili profesional dhe kompetencave profesionale që duhet të zhvillojnë studentët në terren përmes eksperiencës së praktikës synohet që institucionet e përzgjedhura të jenë shkolla, kopshte apo cerdhe publike apo private, me qëllim që t'i ndihmojnë ato të realizojnë objektivat e lëndës në fjalë. Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit¹³⁰ në funksion të praktikës profesionale për masterin profesional në “Psikologji Shkollore” kemi disa marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e lartë Universitare “Nehemiah Gateway” Pogradec; një tjetër institucion i quajtur SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës, një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”. Bashkia Tiranë, organizata “Rrjeti Akademik Shqiptar” dhe Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”¹³¹. Cështja që na shqetëson është sesi mundet këto institucione t'i shërbejnë njësisë bazë për nevojat e menaxhimit me sukses të praktikës profesionale të studentëve të psikologjisë shkollore.

GVJ sugjeron njësinë bazë si përgjegjësen kryesore për monitorimin e cilësisë në programin e studimit dhe të planit mësimorë të tregohet e kujdeshme në mënyrën se si hartohen dhe zbatohen nga pedagogu objektivat formuese të secilës lëndë:

- Praktika duhet të realizohet në terren.

- Mbështetur në marrëveshjet e nënshkruara gjykohet e pamjaftueshme mundësia që u ofrohet studentëve të psikologjisë shkollore për të përzgjedhur llojin e institucioneve në funksion të praktikës profesionale.

¹³⁰ Edivenca 8. Marrëveshje për praktikën mësimore.

¹³¹ Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Marrëveshjet MP psikologji Shkollore

	<i>Në këto kusht marrëveshjet në funksion të realizimit të praktikës profesionale vazhdojnë të mos kenë impakt në cilësinë e programit të studimit PM “Psikologji Shkollore”.</i>			
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” me kohë të plotë, i organizuar me 60 ECTS ofrohet në gjuhën shqipe. Duke iu referuar synimeve të institucionit për të përthithur student nga trojet shqiptare, procedurat dhe kriteret e pranimit lejojnë çdo student të interesuar për t’u bërë pjesë e këtij mastri profesional. Nuk kemi evidenca për të gjykuar mbi përfshirjen e elementeve të mësimdhënies, moduleve, lëndëve në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj. Vlen të theksohet se në vendin tonë në përgjithësi programet që ofrojnë element në programin e studimit në gjuhë të huaj nuk kanë një shtritje të gjerë, në këto kushte përmbushja e këtij kriteri duhet vlersuar bazuar në kontekstin e vendit dhe avancimit të institucioneve të arsimit të lartë drejt standarteve ndërkombëtare.			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Bazuar në të dhënat e marra në analizën e tregut të punës ¹³² rezulton një numër i lartë institucioneve të arsimit parauniversitar publike dhe private që mund të kenë hapsira pune psikologët shkollore. Bazuar në evidencat e marra me stafin dhe anëtarët e njësisë bazë rezulton se ndër studentët që kanë ndjekur këtë master profesional ndër vite, evidentojnë se një numër i madh studentësh kanë qenë në marrëdhënie pune. Këto student kanë ushtruar rolin e psikogut shkollore në institucione të ndryshme brenda vendit tonë apo nga Kosova. Motivacionet për nisjen e këtij mastri janë të lidhura me zhvillimin e kompetencave profesionale dhe ruajtjen e vendit të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përputhje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

¹³² Evidenca 10. Alnaliza e tregut të punës.

<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e institucionit mbi stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie dhe duke iu referuar CV¹³³ të tyre mund të gjykojmë se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform fushës akademike specifike. Gjithsesi duke qenë një profil shkollor duhet parë me kujdes përfshirja e stafit akademik për të mbuluar lëndë e module të ndryshme. Kualifikimet e pjesëshme dhe të shkurtra në fushën e psikologjisë nuk të shndërrojnë në mësimdhënës të sukseshmë për të formësuar njohuri e kompetenca të psikologut shkollor dhe as nuk të lejojnë liqensimin nga Urdhri i Psikologut. Nëse një lektor nuk përmbush kushtet për liqensim nuk mund të formojë breza psikologësh shkollorë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që njësi bazë por edhe sturkturat e tjera pranë institucionit përgjegjëse për monitorimin e cilësisë të jenë të kujdesshëm në mënyrën sesi shpërndahet ngarkesa mësimore dhe përzgjidhet stafi akademik që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi me një profil tepër specifik përsa i përket fushës së kualifikimit të kandidatit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është në përputhje me kushtet dhe kriteret klasifikuese të fushës akademike kjo referuar udhëzimeve kombëtare për arsimin e lartë. Njësia bazë që ofron programin e studimit master profesional në “Psikologji Shkollorë” është Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme. Gjithashtu numri i identifikimit të diplomës në Rregjistrin Shtetëror të Diplomave e Certifikatave bazuar në kodifikimin e programit të studimit MP në “Psikologji Shkollorë”¹³⁴ është sipas direktivave dhe Udhëzimit Nr.12, datë 18.03.2009, “Për krijimin e Rregjistrin Shtetëror dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”¹³⁵.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në</p>	<p>Njësia bazë që ofron këtë program studimi ka një koherencë me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit¹³⁶ dhe asaj të programit të studimit¹³⁷ përsa i përket përputhjes me</p>

¹³³ Evidenca 64. CV e pedagogëve

¹³⁴ Evidenca 14. Urdhër për rregjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë, master profesional në “Psikologji Shkollorë, Universiteti privat “Albanian University”

¹³⁵ Udhëzimit Nr.12, datë 18.03.2009, “Për krijimin e Rregjistrin Shtetëror dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor “

https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/02/Udhezim_12_18_03_2009.pdf (Aksesuar më 09.06.2022)

¹³⁶ Evidenca 11. Plani strategjik Institucional 2017-2022.

¹³⁷ Evidenca 13 Plani strategjik i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

<p>përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>fushën akademike dhe kërkimit shkencore, si dhe është një linjë me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. Kjo i jep mundësinë, Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme, të ketë shanse në rritje për zhvillimin e burimeve njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu bazuar në klasifikimin/kodifikimin e programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore”, profili i ofruar nga AU është në harmoni me dhe në përputhje me statutin e tij të brendshëm¹³⁸ dhe rregullores së AU-së¹³⁹ e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”¹⁴⁰; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”¹⁴¹; me disa ndryshime të tjera¹⁴²; ¹⁴³.</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i studimit në “Psikologji Shkollore” i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme është në harmoni me fushën e shkencave shoqërore dhe në linjë me profilin e njësisë bazë që ofron programin e studimit master profesional në “Psikologji Shkollore”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

¹³⁸ Evidenca 14. Statuti i Albanian University.

¹³⁹ Evidenca 12. Rregullore e përgjithshme e AU.

¹⁴⁰ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁴¹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁴² Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më më 04-06-2022).

¹⁴³ VKM nr.185, datë 25.3.2021 për ndryshime në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL e RSH” <https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per-ndryshime-ne-vkm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/> (Aksesuar më 04.06.2022)


Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>AU për të siguruar mbarëvajtjen e programit të studimit MP në “Psikologji Shkollorë” ka njësitë e saj¹⁴⁴; ¹⁴⁵të cilat kanë një rol mbështetës në drejtim të detyrave dhe përgjegjësiive specifike sipas hierarkisë. Njësia bazë përmes strukturave të saj kordinatori i programit të studimit¹⁴⁶, grupit mësimorë mbikëqyrin, monitorojnë dhe bashkëpunojnë midis tyre për qëllime të mbarëvajtjes të procesit mësimor për këtë program studimi. Këto stuktura funksionojnë duke u mbështetur tek rregulloret përkatëse¹⁴⁷; ¹⁴⁸; ¹⁴⁹ dhe bashkëpunimi brenda institucionit përligjet përmes ndarjes së detyrave mes njësive e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Duke u mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AU dhe të konfirmuar në takimet e zhvilluara me drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë por edhe nga studentët, kemi praninë e disa marrëveshjes institucionale të lidhura si me institucione brenda vendit por edhe me institucione ndërkombëtare¹⁵⁰ si “Shoqata e Psikologëve të Shqipërisë dhe të Kosovës”, “Organizata Plan & Go”, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i Sarajevës, dhe Shkolla e Lartë “Nehemiah Gateway” Bucimas, Pogradec, Bashkia Tiranë, organizata “Rrjeti Akademik Shqiptar” dhe Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”,</p>

¹⁴⁴ Evidenca 5. Ngritja e grupit të vlerësimit të brendshëm

¹⁴⁵ Evidenca 30. Grupi I cilësisë në nivel departamenti

¹⁴⁶ Evidenca 22. Kordinatori i programit

¹⁴⁷ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit master profesional në Psikologji Shkollorë

¹⁴⁸ Evidenca 19. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

¹⁴⁹ Evidenca 53. Sigurimi i cilësisë Njësia bazë.

¹⁵⁰ Evidenca 16. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.



	<p>Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”¹⁵¹.</p> <p>Vlen të theksohet se duhet parë sesi mund të shfrytëzohen këto marrëveshje për qëllime të realizimit të objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, të praktikave profesionale dhe mundësive për mobilitet të studentëve të AU. Marrëveshjet e bashkëpunimit të AU-së me institucionet homologe jasht vendit janë kthyer në aplikative në aktivitetet e përbashkëta të ndërmara drejtim të kërkimit shkencor si konferencat, workshop-et, leksionet e hapura dhe trajnime të stafit të zhvilluara pranë këtij institucioni^{152; 153; 154, 155}. Në bazë të këtyre evidencave gjykohet se këto marrëveshje nuk janë të mjaftueshme në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve të këtij programi profesional në psikologji shkollore.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale në programin e ciklit të dytë Master Profesional në “Psikologji Shkollore” institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ një dokument të titulluar “Marrëveshjet për Praktikat Mësimore”. Bazuar te syllabusi i lëndës “Praktika Profesionale”¹⁵⁶, nga të dhënat që disponohen kemi vështirësi të kuptojmë mënyrën e realizimit të lëndës, pasi duke iu referuar syllabusit të lëndës, duket se praktika profesionale realizohet në auditor (120 orë në auditor) e ndarë në dy semestra e shoqëruar me tema mësimore, edhe pse në planin mësimor ajo figuron si veprimtari që i përket kategorisë D dhe është pjesë e lëndëve plotësuese që realizohet në terren. Ndërkohë duke iu referuar këtij profili profesional dhe kompetencave profesionale që duhet të zhvillojnë studentët në terren përmes eksperiencës së praktikës, synohet që institucionet e përzgjedhura të jenë shkolla, kopshte apo cerdhe publike apo private, me qëllim që t’i ndihmojnë ato të realizojnë objektivat e lëndës në fjalë. Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit¹⁵⁷ në funksion të praktikës profesionale për masterin profesional në “Psikologji Shkollore” kemi disa marrëveshje bashkëpunimi</p>

¹⁵¹Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL dhe documentacioni shtesë. Marrëveshjet MP psikologji Shkollore

¹⁵²Evidenca 17. Shkresa për modulet e trajnimit.

¹⁵³Evidenca 35. Trajnime të stafit akademik.

¹⁵⁴Evidenca 33. Raporti Vjetor 2021-2022.

¹⁵⁵ Evidenca 39. Aktivitete 2021-2022.

¹⁵⁶ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

¹⁵⁷ Edivenca 8. Marrëveshje për praktikat mësimore.

	<p>me Shkollën e lartë Universitare “Nehemiah Gateway” Pogradec; një tjetër institucion i quajtur SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës, një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”, Bashkia Tiranë, organizata “Rrjeti Akademik Shqiptar” dhe Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”¹⁵⁸. Cështja që na shqetëson është sesi mundet këto institucione t’i shërbejnë njësisë bazë për nevojat e menaxhimit me sukses të praktikës profesionale? Marrëveshjet e praktikës në funksion të realizimit të praktikës profesionale vazhdojnë të mos kenë impakt në cilësinë e programit të studimit PM “Psikologji Shkollore”.</p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë bazë të bëj një përpjekje aktive për të përshtatur dhe përzgjedhur institucionet dhe kompanitë me nevojat e studentëve të këtij profili profesional, pasi përvoja praktike në terrenin e punës krijon mundësi për njohjen reale të mjediseve të ndryshme profesionale në fushën e psikologjisë shkollore. E gjithë kjo përkthehet në mundësi për studentët për të njohur rolin dhe detyrat e psikologut shkollore në kontekste të ndryshme profesionale si shkolla, kopshte, cerdhe.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit institucional që AU duhet të nënshkruaj për qëllime të zhvillimit të praktikave profesionale, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore janë faktor kyçe për zhvillimin e profilit të psikologut shkollore. Bazuar në disa marrëveshje institucionale të lidhura si me institucione brenda vendit por edhe me institucione ndërkombëtare¹⁵⁹ si “Shoqata e Psikologëve të Shqipërisë dhe të Kosovës”, “Organizata Plan & Go”, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i Sarajevës, dhe Shkolla e Lartë “Nehemiah Gateçay” Bucimas, Pogradec, SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës¹⁶⁰, dhe një</p>

¹⁵⁸Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Marrëveshjet MP psikologji SHkollore

¹⁵⁹ Evidenca 16. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

¹⁶⁰ Edivenca 8. Marrëveshje për praktikat mësimore.

	<p>institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”, Bashkia Tiranë, organizata “Rrjeti Akademik Shqiptar” dhe Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”¹⁶¹. Bazuar në këto të dhëna GVJ ka të vështirë të vlersoj sesi këto institucione, një pjesë e madhe e të cilave as nuk përshtaten në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilin e psikologut shkollor e as nuk janë të aksesueshëm për studentët e masterit profesional në “Psikologji Shkollore”, bazuar vetëm tek distanca fizike, do i shërbej institucionit për kryerjen dhe mbikqyerjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të këtij program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme përgjatë vitit 2021-2022 ^{162, 163}, kemi një sër aktivitetesh si leksione të hapura me profesor të ftuar vendas dhe të huaj, workshop-e, tryeza të rumbullakta, aktivitete bamirësie që janë me përfitim për studentët e programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore”. Gjithashtu në drejtimin e trajnimeve profesionale të ofruara për stafin e AU, studentët dhe alumnit (ish student) kanë marrë pjesë në aktivitetin dy ditorë GRADUA¹⁶⁴, të financuar nga Erasmus +. Ky aktivitet kishte si qëllim trajnimin për përdorimin e Platformës Gradua e cila shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. Platforma të ndihmon të krijosh një CV të tyre personale, të kenë qasje të lehtë në informacion mbi mundësitë e punësimit, ofertave të punës nga kompanitë dhe praktikës profesionale.</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të</p>	<p>Njësi bazë përmes strukturave të saj monitoron në vijimësi ecurinë e përgjithshme të programit të studimit përmes disa formave monitoruese si analizës së raportit të vjetor të njësisë bazë¹⁶⁵, analizës së pyetësorëve të realizuar me stafin¹⁶⁶, drejtuesin e njësisë bazë¹⁶⁷, raportit të vetvlersimit të</p>

¹⁶¹Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Marrëveshjet MP psikologji Shkollore

¹⁶²Evidenca 33. Raporti Vjetor 2021-2022.

¹⁶³Evidenca 39. Aktivitete 2021-2022.

¹⁶⁴Evidenca 33. Raporti Vjetor 2021-2022.

¹⁶⁵Evidenca 33. Raporti Vjetor 2021-2022.

¹⁶⁶Evidenca 31. Formulari i Pedagogut.

¹⁶⁷Evidenca 32. Formulari i Drejtuesit të Departamentit



realizimit të programeve të studimeve.	programit të studimit ¹⁶⁸ dhe studentëve ¹⁶⁹ por edhe përmes strukturave të saj për monitorimin e cilësisë së veprimtarive teoriko-didaktike dhe praktikë që ofrohen prej saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe	Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” është hartuar në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e përditësuar siç janë: Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ¹⁷⁰ dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ¹⁷¹ ; Vendimit nr. 879. datë 18.12.2019 ¹⁷² dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021 ¹⁷³ duke

¹⁶⁸ Evidenca 34. Model raporti i vetvlerësimit të programit

¹⁶⁹ Evidenca 28. Pyetësori i Studentëve

¹⁷⁰ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt(Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁷¹ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>. (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁷² Vendimi nr. 879. datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5IZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2U&ZËNhMËE1Yjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁷³ VKM nr.185, datë 25.3.2021 për ndryshime në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL e RSH” <https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per->

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>respektuar Sistemin Evropian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS)¹⁷⁴.</p> <p>Kemi balancë në ndarje të lëndëve në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas udhëzimeve të MASR. Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” realizohet me 60 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij 1 vit akademik, i ndarë në dy semestra me peshën e fitimit të 30 krediteve për semestër¹⁷⁵. Në përfundim të programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore lëshohet diploma “Master Profesional” në fushën “Psikologji Shkollore ”¹⁷⁶.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” duhet të synojë përmes moduleve dhe lëndëve¹⁷⁷, të formojë shprehi dhe kompetenca në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes në kontekstin shkollor, por pak hapsirë të jep bazuar në përmbajtjen e syllabuseve, literaturës së përdorur nga ana e stafit akademik të angazhuar në program studimi. Kjo bazuar në rolin profesional të psikologut shkollor cënon cilësinë në mësimdhënie si në drejtim të zhvillimit të shprehive profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët, por gjithashtu edhe si këshilluese në institucione shkollore ku marrin shërbime psikologjike kategori të fëmijëve me nevoja të veçanta. Për të pasur më të lehtë orientimin e studentëve në tregun e punës por edhe drejt vetëpunësimit të tyre kërkohen kompetenca profesionale që justifikojnë emërtimin e këtij masteri.</p> <p><i>Sugjerimet e GVJ për njësinë bazë janë që të angazhohet në vijimësi për të përmirësuar brendinë e syllabuseve të lëndës duke shfrytëzuar hapsirën ligjore deri në masën 20% me qëllim që të jenë realisht të arritshëm objektivat e programit të studimit për të formuar profesionist në fushën e psikologjisë shkollore ashtu sic është emërtuar ky program studimi, gjë e cila paraqet veshitërsi në kushtet aktuale bazuar në syllabuset e lëndëve mësimore¹⁷⁸ dhe të cv-ve stafit të angazhuar në këtë profil profesional¹⁷⁹(një pjesë e stafit akademik i përkasin profilut të psikologjisë klinike ose një pjesë nuk janë fare të fushë së</i></p>

[ndryshime-ne-ykm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/](#) (Aksesuar më 04.06.2022)

¹⁷⁴ Evidenca 20. Plani mësimor në MP Psikologji Shkollore

¹⁷⁵ Evidenca 66. Tabelat

¹⁷⁶ Evidenca 61. Format diplome.

¹⁷⁷ Evidenca 66. Tabelat.

¹⁷⁸ Evidenca 20. Plani mësimor në MP Psikologji Shkollore

¹⁷⁹ Evidenca 64. Cv e pedagogëve.



	<i>psikologjisë), ku një pjesë e stafit nuk i përkasin fushës së psikologjisë shkollore dhe as nuk kanë një eksperiencë punë në drejtim të profilit shkollor.</i>
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” mbështetur në përmbajtjen e programeve lëndore dhe literaturën e përdorur janë dy element të rëndësishëm në drejtim të njohurive të përparuar për këtë fushë studimi dhe më tej në drejtim të zhvillimit të kompetencave shkencore dhe profesionale të studentëve. Përmbajtja e programit të studimit krijon kushte për zhvillim kompetencash profesionale të psikologut shkollor por duket e kufizuar hapsira nëse i referohemi përmbajtjes së lëndëve mësimore dhe literaturës së përdorur¹⁸⁰. Gjithsesi njësia bazë duhet të mbështetes personelin akademik me infrastrukturën e duhur me tekste fizike që mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. Pavarisht faktit që institucioni ka akses në disa platforma elektronike të literaturës, kjo nuk garanton në të gjitha rastet publikime cilësore dhe akses në revista e libra me indeks të lartë.</p> <p><i>Bazuar në sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u> që njësia bazë duhet të monitoroj me kujdes përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve mësimore me qëllim që ti përshtaten ciklit të dytë të studimit dhe profilit profesional, si dhe impenjimi serioz i stafit për të përditësuar literaturën bazë me botime akademike që janë në linjë me profilin dhe emrëtimin e lëndës mësimore që ato mbulojnë, kujdes në drejtim të mospërsëritjes të së njëjtës temë mësimore në lëndë të ndryshme.</i></p>
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Shkollore” duhet të jetë konform pritshmërive të studentëve për të zhvilluar kompetencat e shprehitë profesionale në drejtim të njohurive teoriko-praktike për të punuar si psikolog shkollor pas përfundimit të masterit. Gjithashtu drejtimi i secilës lëndë¹⁸¹ përmban një sër veprimtarish didaktiko-praktike që duhet të realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin praktik të koncepteve teorike nga ana e studentit. Përvoja e praktikës profesionale e cila duhet të jetë organizuar në mënyrë që t’u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës si kopshtet, cerdhet dhe shkollat publike apo private.</p>

¹⁸⁰ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

¹⁸¹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

	<p><i>GVJ për këtë kriter sugjeron një angazhim të vazhdueshëm të stafit akademik në përditësimin e literaturës me publikime cilësore lidhur me fushën specifike të specializimit të këtij profili profesional, duke treguar kujdes në përzgjedhjen e literaturës që i përshtatet programit të studimit të ciklit të dytë dhe jo të rrezikohet përsëritja e të njëjës literature e cila mund të jetë ezauruar përgjatë ciklit të parë të studimeve.</i></p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Syllabuset e programit të studimit të ciklit të dytë në MP në “Psikologji Shkollore” janë konform Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”¹⁸²; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe disa shtesave që i janë bërë VKM Nr. 41, Vendimi nr. 879 datë 18.12.2019, dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021¹⁸³. Syllabuset e secilës lëndë janë të organzuara sipas strukturës si më poshtë me: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat dhe konceptet themelore, temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sër veprimtarishë praktike që realizohen si pjesë e seminareve. Syllabusi i praktikës profesionale¹⁸⁴ paraqet disa handikape në mënyrën sesi është hartuar dhe zbatuar, referuar asaj çfarë përmban plani mësimor i kësaj lëndë të shqyrtuar nga GVJ në dokumentacionin që AU ka depozituar pranë ASCAL.</p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë bazë të hartoj planin mësimorë të lëndës “Praktikë Profesionale” konform udhëzimeve dhe objektivave formative dhe të zgjeroj numrin e institucioneve të asimit parauniversitar si cerdhe, kopshte, shkolla si qendra ku të zhvillohet praktika profesionale me qëllim që të jetë në linjë me profilin profesional të këtij program studimi dhe t’u shërbej studentëve për të zhvilluar kompetenca profesionale dhe njohuri praktike lidhur me rolin e psikologut shkollor.</i></p>

¹⁸² Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJ1802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁸³ VKM nr.185, datë 25.3.2021 për ndryshime në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL e RSH” <https://ust.edu.al/vkm-nr-185-date-25-3-2021-per-ndryshime-ne-vkm-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-ial-e-rsh/> (Aksesuar më 04.06.2022)

¹⁸⁴ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimorë janë konform ligjit për arsimin e lartë¹⁸⁵ dhe urdhrave¹⁸⁶ duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite sipas përqindjes së detyrueshme bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018¹⁸⁷ dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021¹⁸⁸. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 10% (6 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 40 % (24 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese 27 % (16 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (6 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 13 % (8 ECTS); <p>Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” ka një balancë të qartë të peshës që zë secila lëndë veprimtari formuese brenda programit të studimit referuar kërkesës që imponohet nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021. Duke iu referuar kriterëve të tjera përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018¹⁸⁹, si kodi i etikës apo numrit të krediteve dhe kohëzgjatjen e tij në vite janë konform aktet ligjore e nënligjore.</p>
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë MP në “Psikologji Shkollore” respekton kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe VKM</p>

¹⁸⁵ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt(Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁸⁶Vendimi nr. 879. datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2U5ZjEhMEEIYjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).

¹⁸⁷ VKM Nr.41, datë 24.01.2018/

¹⁸⁸ VKM Nr.185, datë 25.03.2021

¹⁸⁹ Vendimi nr. 879. datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYEx8ZnNobnxneDo3NzYxM2U5ZjEhMEEIYjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).

profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Nr.185, datë 25.03.2021 duke përfshirë respektimin e numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga GVJ evidentohet se ky program studimi parashikon për realizimin e diplomës dhe aktiviteteteve kërkimore 16 orë të zhvilluara në auditor, 184 orë punë individuale e pavarur e studentit, me 8 ECTS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Shoqërore, si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për organizimin akademik dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë në AU ka si pjesë të saj njësinë bazë përgjegjëse, Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme. Mësohet nga takimi me përgjegjësen e departamentit dhe antarë të departamentit se njësia bazë ngre grupin cilësisë ¹⁹⁰ në nivel departamenti dhe grupin e vlerësimit të brendshëm ¹⁹¹ për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL konform Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017 ¹⁹² . Universiteti Privat "Albanian University" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master

¹⁹⁰ Evidenca 30. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

¹⁹¹ Evidenca 22. Kordinatori i Programit.

¹⁹² Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (2017). Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit

<https://eëë.ascal.al/media/documents/publikime/Manual%20afatet%20e%20akreditimit%20IAL%20dhe%20programet%202017.pdf> (Aksesuar më 02.03.2022).

	Profesional në "Psikologji Shkollore", nëpërmjet shërbimit në AMS.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia kryesore "Fakulteti i Shkëncave Shoqërore" dhe njësia bazë "Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme", përgjegjëse për programin e studimit MP në "Psikologji Shkollore" përmbush detyrimet ligjore në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë". Fakulteti i Shkëncave Shoqërore përbëhet nga këto departamente: <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; 2. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme; 3. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes;
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Njësia kryesore, Fakulteti i Shkëncave Shoqërore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit studimit të ciklit të dytë MP në "Psikologji Shkollore", përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Duke iu referuar CV të tyre mund të gjykojmë se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform fushës akademike specifike. Bazuar në të dhënat që grupi i vlersimit të jashtëm ka shqyrtuar, rezulton se Fakulteti i Shkencave Shoqërore, për vitin akademik 2020-2021 ka patur gjithsej 101 pedagogë , të cilët janë pedagogë efektiv 34 (PAE) dhe 54 (PAK) ¹⁹³ , gjithashtu për nevojat e njësisë kryesore dhe asaj bazë janë angazhuar edhe 13 (PA) , ndërsa për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej 97 pedagogë , nga të cilët janë pedagogë efektiv 32 (PAE) dhe 54 (PAK) si dhe 11 (PA) ¹⁹⁴ .
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Përsa i përket stafit akademik të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme për vitin akademik 2019-2020, sipas evidences rezultojnë 10 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 1 me titull "Prof.As.", 5 me gradën "Dr." dhe 4 me Msc, dhe 14 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 me titullin akademik Prof. dr., 1 Prof asoc., dhe 5 me gradën "Dr." dhe 6 me Msc si dhe personeli administrative në mbështetje të procesit mësimor për njësinë bazë 8 (PA) ¹⁹⁵ .

¹⁹³ Evidenca 66. Tabelat.

¹⁹⁴ Evidenca 66. Tabelat.

¹⁹⁵ Evidenca 66. Tabelat.

	<p>Për vitin akademik 2020-2021 rezultojnë 7 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 1 me titull “Prof.As.”, 4 me gradën “Dr.” dhe 2 me Msc, dhe 9 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 me titullin akademik Prof. dr., 1 Prof asoc., dhe 2 me gradën “Dr.” dhe 4 me Msc¹⁹⁶ dhe personeli administrative 9 (PA)¹⁹⁷.</p> <p>Ndërsa stafi i angazhuar në mësimdhënie për vitin akademik 2021-2022 rezultojnë 8 pedagogë efektiv (PAE) nga ku 1 me titull “Prof.As.”, 4 me gradën “Dr.” dhe 3 me Msc, dhe 9 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 me titullin akademik Prof asoc., dhe 4 me gradën “Dr.” dhe 4 me Msc¹⁹⁸ si dhe personeli administrative në mbështetje të procesit mësimor për njësinë bazë 8 (PA).</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 për programin e studimit MP në “Psikologji Shkollore” rezultoi në mbuluar 80 % nga PAE dhe 20% nga PAK (tabela 6.3)¹⁹⁹.</p> <p>Ngarkesa e mbuluar përmes personelit akademik efektiv është në masën 80 % referuar minimumit të kërkuar nga standardi i cilësisë dhe përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e disponuara lidhur me mënyrën sesi njësia bazë angazhon personelin akademik ndihmës për nevojat e praktikës profesionale kemi të dhëna lidhur me stafin akademik efektiv që mbulon këtë proces. Cështja komplikohet kur krahasohet plani mësimor²⁰⁰ i këtij programi studimi dhe syllabusit të lëndës së “Praktikës Profesionale”²⁰¹ pasi duke iu referuar syllabusit të lëndës, rezultoi se kjo lëndë realizohet me 120 orë në auditor, e ndarë në dy semestra e shoqëruar me tema mësimore, edhe pse në planin mësimor ajo figuron si veprimtari që i përket kategorisë D dhe është pjesë e lëndëve plotësuese që realizohet në terren. Gjithsesi duke u bazuar te marrëveshjet e bashkëpunimit të AU për praktikën mësimore vihet re një mungesë e institucioneve të arsimit parauniversitar si kopshte, cerdhe, shkolla publike e private, që do të lehtësonin procesin e përvetësimit të njohurive praktike dhe të mësuarit nga përvoja e profesionisteve të psikologjisë shkollore.</p>

¹⁹⁶ Evidenca 66. Tabelat.

¹⁹⁷ Evidenca 66. Tabelat.

¹⁹⁸ Evidenca 66. Tabelat.

¹⁹⁹ Evidenca 66. Tabelat.

²⁰⁰ Evidenca 20. Planin mësimorë i MP në Psikologji Shkollore

²⁰¹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.



<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Njësia kryesore në bashkëpunim me njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë MP në “Psikologji Shkollore” në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë”, sipas propozimit të përgjegjës të Departamentit miraton në rolin e kordinatorit për këtë program studimi Prof. Asoc. Dr. P. L.²⁰². Gjithashtu në kuadër të rritjes së cilësisë, ka ngritur një grup të cilësisë në nivel departamenti²⁰³ dhe grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studim²⁰⁴ sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij dhe për të kordinuar më mirë ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Përgjegjësitë e kordinatorit të programit të studimit MP. në “Psikologji Shkollore” përfshirjnë monitorim të objektivave formuese të programit të lëndës. Roli i kordinatorit lehtëson në aksesin e informacionit për studentët dhe për pedagogun e praktikës në lidhje me terenet e mundshme të shfrytëzueshme nga studentët e këtij program studimi për praktikën profesionale por edhe përmes angazhimit të studentëve në një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare të organizuara në rang departamenti apo fakulteti. Koordinator i programit²⁰⁵ referuar informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, raporton në mënyrë periodike tek drejtuesi i njësisë përgjegjëse në lidhje me çdo informacion që lidhet me programin e studimit, por dokumentacion në lidhje me mënyrën sesi monitorohet roli dhe detyrat, apo mënyrën sesi raportohet çdo informacion që lidhet me programin e studimi nuk na u vendos në dispozicion.</p> <p><i>Rekomandimet tona si GVJ në lidhje me këtë aspekt parashatrojnë nevojën e dokumentimit të rolit dhe punës së kordinatorit te drejtuesi i njësisë bazë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.3

²⁰²Evidenca 22. Kordinator i programit.

²⁰³ Evidenca 30. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

²⁰⁴ Evidenca 22. Kordinatori i Programit.

²⁰⁵ Evidenca 22. Kordinatori i Programit.



Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Të dyja këto njësi, si njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe njësia bazë, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë MP në “Psikologji Shkollore”, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, si dhe ndërveprojnë së bashku për të përmbushur më së miri detyrimet ligjore që lidhen me ecurinë e tij si në rastin e miratimit të grupit të cilësisë në nivel departamenti²⁰⁶, emërimit të kordinatorit të programit të studimit²⁰⁷ dhe në rastin e miratimit të grupit të vlerësimit të brendëshëm²⁰⁸ për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” sipas përmbajtjes së planit mësimor²⁰⁹ është në harmoni me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, dhe respektimit të standarit për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë 1 viti akademik, një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmblyëse.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Veprimtaritë formuese në programin e studimit MP në “Psikologji Shkollore”²¹⁰, të ndara sipas komponentëve mësimorë janë konform ligjit për arsimin e lartë²¹¹ dhe urdhrave²¹² duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Kemi një</p>

²⁰⁶ Evidenca 30. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

²⁰⁷ Evidenca 22. Kordinator i programit.

²⁰⁸ Evidenca 5. Ngritja e grupit të vlerësimit të brendëshëm.

²⁰⁹ Evidenca 20. Plani mësimorë I MP në Psikologji Shkollore

²¹⁰ Evidenca 20. Plani mësimorë i MP në Psikologji Shkollore

²¹¹ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 04-06-2022).

²¹² Urdhër Nr. 251, datë 14.06.2013. Për akreditimin e disa programeve të studimit në Ba, MSH, MP.

	<p>ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 10% (6 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 40 % (24 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese 27 % (16 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (6 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 13 % (8 ECTS); <p>Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018)²¹³, duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Masteri profesional në “Psikologji Shkollore” ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi dhe një shpërndarje të qartë të planit mësimor²¹⁴, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program studimi²¹⁵, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlersimit të dijeve.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Porgrami i studimit MP në “Psikologji Shkollore” ka paqruar të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me ecurinë e studentëve në rregulloren mësimore të programit të studimit²¹⁶ është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Institucioni përmes njësive të tij monitoron respektimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit në këtë program</p>

²¹³ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2U&ZËNhMËËlYjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).

²¹⁴ Evidenca 20. Plani mësimorë i MP në Psikologji Shkollore

²¹⁵ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

²¹⁶ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore



	studimi si dhe procedurat e ndjekura në pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e programit të studimit bazuar në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve të AU-së ²¹⁷ .			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 ²¹⁸ , gjithashtu duke iu referuar planit mësimor ²¹⁹ kemi një ndarje të lëndëve mësimore në semestra duke respektuar peshën e ngarkesës në semestra dhe duke ruajtur numrin e krediteve për çdo semester. Bazuar te syllabuset e lëndëve mësimore kemi praninë e komponentëve mësimorë të përfshirë në të si ngarkesa, kodi i etikës, përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e lëndës, forma e kontrollit të dijeve, kontrolli i vazhdueshëm dhe literatura bazë e detyrueshme e ajo e rekomanduar.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” sipas informacioneve të marra gjatë vizitës në institucione me drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore, është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të programit të lëndëve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Mbetet të shohim stabilizimin tij në linjë me kërkesat e një arsimit cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushën e psikologjisë shkollore. <i><u>GJV rekomandon përmirësimin e kurrikulës në drejtim të përmbajtjes së programit të lëndëve mësimore me qëllim që tu përgjigjen kërkesave legjitime të studentëve për arsim cilësor, të tregohet kujdes me lëndët me bazë dhe ato karakterizuese të cilat duhet të orientohen drejt profilit të psikologjisë shkollore.</u></i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

²¹⁷Evidenca 23 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve.

²¹⁸VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 04-06-2022).

²¹⁹ Evidenca 20. Plan i mësimorë i MP në Psikologji Shkollore

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë MP në “Psikologji Shkollore”, ofruar nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, është në koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të krediteve, 60 kredite, kohëzgjatjes normale të tij në 1 vit akademik, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e AU-së.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” mbështetet në VKM Nr. 41, dt.24.01.2018, mund të krijoj kushte të favorshme në drejtim të përfitimit të njohurive, aftësive, licensimit dhe punësimin në profilin e studimit psikolog shkollorë, pasi përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë të arrihet në një profilizim që të jep mundësi të punosh brenda fushës së psikologjisë shkollore. Shpërndarja e lëndëve i jep mundësi studentit të marrë njohuri nga disiplina të psikologjisë shkollore, praktika bazuar në mënyrën e organizimit dhe tematikave që prek, referuar syllabusit të lëndës, institucioneve në dispozicion të praktikës profesionale, nuk të jep shumë mundësi për aftësi praktike.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Plani mësimor i MP në “Psikologji Shkollore”²²⁰ është në harmoni me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, dhe respekton standartet për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë 1 viti akademik. Një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmblyëse. Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit</p>

²²⁰ Evidenca 20. Plani mësimorë i MP në Psikologji Shkollore



	<p>për arsimin e lartë dhe urdhrave duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Shihet me dyshim përmbushja e detyrimit lidhur me rezultatet e të nxënit duke qenë se bazuar te syllabuset e programeve të lëndëve ka paqartësi lidhur me mënyrën sesi studentët e këtij program studimi do arrijnë të marrin një bashkësi dijesh, aftësish dhe kompetencash profesionale të fushës së psikologjisë shkollore.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e shqyrtuara nga GVJ, struktura e programit të studimit PM në “Psikologji Shkollore”²²¹ referuar lëndëve mësimore dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë, është në përputhje me profilin profesional të psikologjisë shkollore. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë A- tipi i Lëndëve Bazë që përmbajnë 10% (ECTS), Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 40 % (ECTS), Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore/Integruese 27 % (ECTS), Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (ECTS), Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 13 % (ECTS). Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018), duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” duhet të synojë zhvillimin e njohurive teoriko-praktike tek studentët, në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuar në tregun e punës për profesionin e psikologut shkollor. Gjithashtu programi duhet të përfshijë element mbi zhvillimin e disa shprehive profesionale që e ndihmojnë psikologun shkollor të realizojë detyrën e tij në ofrimin e shërbimeve psikologjike në mënyrë profesionale. Mbështetur në disa element të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij gjykojmë se programi i pasqyron ato pjesërisht. Kemi një balancë midis mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimorë, ndarjen sipas semestrave, orë në auditor dhe frekuentimin, vlersimin e dijeve dhe një sër akvitetesh specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët. Bazuar në planin mësimorë të lëndëve kemi të vështirë të konfirmojmë</p>

²²¹ Evidenca 20. Plani mësimorë MP në Psikologji Shkollore

	<p>arritjen e objektivave formuese, bazuar në temat mësimore apo literaturën e përdorur nga pedagogu, e cila nuk i përshtatet nivelit master. Ndërsa duke iu referuar emërtimit dhe komponentëve mësimore, numrit të krediteve, kohëzgjatjes së studimeve ky program lejon transferimin e studimeve, mobilitetet apo dhe licensimin e studentit pas përfundimit të studimeve. Ajo që mbetet për t'u diskutuar është niveli i njohurive dhe kompetencave profesionale të fituara nga studenti në përfundim të tij.</p> <p><i>Në këto kushte rekomandimet tona si grup i vlerësimit të jashtëm sugjerojnë njësinë bazë të tregoj përgjegjësi profesionale në rolin që mbulon për të bërë punën që i takon në drejtim të monitorimit dhe përmirësimit të literaturës që t'i përshtatet nevojave profesionale të studentëve të psikologjisë shkollore.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Duke iu referuar përditësimit të literaturës bazë e përdorur në një pjesë të konsiderueshme të syllabuseve të lëndëve mësimore është e para një dekadë, dhe një pjesë e kësaj literature përpos faktit që është botim i para 10-20 viteve, ajo është ezauruar në lëndë specifike gjatë ciklit të parë të studimeve nga ana e studentëve. I referohemi tekstit “Etika në Këshillim” e autoreve M. Dh & A.S.; “Psikologji Zhvillimi” që përdoret si tekst bazë për lëndën “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²²². Për lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët” si literaturë bazë janë dy tekste: “Psikologji Komunikimi” B. C (2001) dhe “Psikologji Komunikimi” e autores A. SH (2008). Të dy tekste që i përshtaten njohurive të përgjithshme për komunikimin në përgjithësi, për studentët e nivelit bachelor dhe pa një lidhje të qarte me lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët”. Gjithashtu duke u bazuar në syllabuset e lëndës dhe në dokumentacionin në dispozicion kemi vështirësi të vlerësojmë në mënyrë objektive mbi “Draft leksionesh të pedagogut” e cila është cituar si pjesë e literaturës bazë të përdorur për disa lëndë, por që nuk shoqërorhet me ciklin e leksioneve që të mund ta shqyrtojmë e të japim një opinion lidhur me të. Gjithashtu bazuar tek syllabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” sipas të dhënave rezultojnë se kjo lëndë realizohet në auditor, e ndarë në dy semestra, 120 orë, e shoqëruar me tema mësimore mbi: “Zhvillimin e aftësive të të mënduarit”; “Zhvillimin</p>

²²² Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

emocional”; “Këshillimin individual”; “Këshillimin në grup”; “Droga, duhani. Alkoli” etj dhe literaturë të autores G. S. “Nga teoria në praktikë” tekst për metodologjinë e të nxënit. GVJ është konfuz lidhur me mënyrën sesi një tekst që nuk i trajton këto tema e ndihmon titullarin e lëndës dhe lektorin në auditor t’i trajtojë para studentëve në lëndën e “Praktikës Profesionale”. Një tjetër lëndë me problematika është edhe “Vlerësimi dhe këshillimi me fëmijët dhe adoleshentët” me tema të cilat nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejt me tipologjinë e lëndës por fokusohen te “Roli i shkollës e komuniteti”, “Roli i psikologut shkollorë” apo “Shkolla dhe organizimi i sistemeve zhvillimi i politikave dhe mjedisi”. Njohuri këto që nëse i referohemi syllabuseve që GVJ shqyrtoi janë dhënë nga i njëjti pedagog edhe në një lëndë tjetër që jep në këtë master si “Hyrje në Psikologji Shkollore”²²³. Dhe më tej temat përsëriten për një tjetër lëndë “Psikologjia Sociale e Mjediseve Shkollore”. Kujtojmë institucionin dhe strukturat përgjegjëse për këtë program studimi se profesioni i psikologut bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009²²⁴, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar²²⁵. Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta.

GVJ rekomandon njësinë bazë por edhe strukturat e tjera të AU-së të reagojnë me shpejtësi ndaj këtij handikapi të krijuar pasi në këtë mënyrë rrezikohet seriozisht cilësia dhe vlefshmëria e diplomës në tregun e punës. Syllabuset e cdo lënde mësimore duhen miratura cdo fillim viti akademik nga njësia bazë dhe ky miratim nuk duhet të konsiderohet një procedurë formale por një proces i nevojshëm për monitorimin e cilësisë në këtë program studimi. Dëshirojmë gjithashtu të tërheqim vëmendjen se këtë rol duhet ta realizojë

²²³ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²²⁴ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

²²⁵ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë



	<p><i>një profesionist i cili minimalisht përmbush kushtet e të pasurit të një profili vetë në fushën e psikologjisë.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Duke iu referuar këtij kriteri konstatohet se temat e trajtuara nuk përputhen në një pjesë të tyre me tipologjinë e lëndës, psh. si “Dimensioni Kongitiv - Sjellor, Nxitja e aftësive Akademike dhe Menaxhimi Sjellor” ku brendia e temave kanë një fokus në psikologjinë kongitive, të ezauruara nga studentët në nivelin bachelor. Po ashtu duke iu referuar syllabusit të lëndës “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²²⁶, kemi tema që fokusohen në një hyrje në psikologjinë e zhvillimit sesa në tipologjinë e kësaj lëndë bazuar në emërtimin e saj, ku mund të përmendim disa prej temave si “Aspekte të përgjithshme të Zhvillimit”; “Teoritë e Zhvillimit Psikologjik”; “Metodat e vëzhgimit në psikologjinë e zhvillimit” etj. Po ashtu lënda “Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”²²⁷ po të shohësh me vëmendje temat e trajtuara duket se jep një informacion më tepër për psikologjinë e këshillimit dhe lë pak ose aspak hapsira për aspekte që kanë të bëjnë me dilemat dhe sfidat profesionale të psikologut shkollor, më të pakuptimtë pastaj e bëjnë edhe temat që nuk kanë lidhje me psikologun shkollor por atë ligjor si psh temat me titull “Shkruajtja e raporteve për përdorim gjyqësor” kur e dimë se një psikolog shkollor vetëm referon dhe nuk merret me hartimin e raporteve të vlerësimit për nevojat e gjykatës; apo tema numër 10 me titull “Cështjet e etikës në punën me minoritetet seksuale” termi “minoritetet seksual” si koncept nuk na ndihmon të kuptojmë qartë llojin e informacionit që trajton apo lidhjen me rolin e psikologut shkollor në drejtim të formimit të kompetencave profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët? Një tjetër problematikë lidhet me temën numër 3 që fokusohet tek kontrata e miratimit të informuar me titullin “Kontratat e psikologëve me dhe brenda organizatave” dhe temën numër 5, 12 që sërish fokusohet tek kontrata e miratimit të informuar dhe konfidencialiteti. Lëndët “Hyrje në Psikologji Shkollore”²²⁸ dhe “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²²⁹ paraqesin një situatë të paqartë bazuar në përmbajtjen e syllabuseve, ku tema të caktuara përsëriten sërish edhe pse të dyja këto lëndë</p>

²²⁶ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²²⁷ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²²⁸ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²²⁹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.



bazuar te syllabuset²³⁰ realizohen në auditor nga i njëjti lektor. I referohemi edhe lëndëve “Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”²³¹ dhe “Hyrje në Psikologji Shkollore”²³² ku në të dyja këto lëndët trajtohet tema “Etika e Psikologut Shkollorë” edhe pse me të njëjtët student presupozohet se çështjet etike të jenë ezauruar plotësisht në lëndën që i dedikohet etikës. Bazuar tek lënda tjetër “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët” kemi një situatë shqetësuese lidhur me bredninë e temave të cilat nuk kanë lidhje me tipologjinë e kësaj lëndë të përshtatur për nevojat e studentëve të ciklit të dytë të studimeve, por më tepër për nevojat e nëxësve apo studentëve të nivelit bachelor lidhur me elementët bazë të komunikimit, citojmë këtu tema të caktuara mësimore si: tema 1- Objektivat e shkencës së psikologjisë së komunikimit; Modelet kryesore të komunikimit”; tema 2- Elementet, faktorë dhe çështje që lejojnë përparësitë dhe nxisin pengesat në procesin e komunikimit”; tema 3 – “Procesi i dëgjimit, Qëndrimet dhe situata optimale gjatë komunikimit”. Gjithashtu një problematikë e cila duhet adresuar lidhet me faktin që si titullar i lëndës “Hyrje në Psikologji Shkollore”²³³ figuron E. H. me titullin akademik Profesor i Asociuar që i përket profilit të bio-kimisë pa ndonjë lidhje me degën e psikologjisë. Kjo evidencë paraqitet si shqetësuese lidhur me mënyrën sesi mund të jetë ky syllabus në përputhje me profilin e psikologut shkollor. Profesion i psikologut bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009²³⁴, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar²³⁵. Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Bazuar në syllabuset e lëndëve mësimore dhe te titullarët²³⁶ e angazhuar

²³⁰ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²³¹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²³² Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²³³ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²³⁴ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

²³⁵ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

²³⁶ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

	<p>në hartimin e syllabuseve në këtë master evidentohet se një pjesë e stafit nuk është brenda profilit të psikologut.</p> <p><i>Në rolin e GVJ gjykojmë se ndoshta një vëmendje e shtuar duhet të tregohet në lidhje me disa pedagogë të cilët u përkasin disiplinave të tjera dhe që mund të cungojnë nivelin e njohurive të trasmetuara tek studentët e masterit profesional në “Psikologji Shkollore”.</i></p>
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Duke iu referuar syllabuseve të lëndëve mësimore ashtu sic jemi shprehur më sipër ato kanë një sër problemesh të lidhura me temat mësimore që shpesh janë jo të lidhura drejtpërdrejtë me këtë profil profesional përsa i përket aftësive dhe kompetencave profesionale që duhet të formojë tek studentët e këtij program profesional. Gjithashtu edhe literature e përdorur e cila jo vetëm është botim i para një apo dy dekadave më parë, në një pjesë të lëndëve mësimore është edhe përsëritje e njohurive të dhëna në nivelin bachelor.</p> <p><i>Bazuar në sa më sipër GVJ rekomandon njësinë bazë të ngrejë një komision ad-hoc, me specialist të profilit të psikologjisë shkollore (Psikologë që përmbushin kriteret ligjore për t’u licensuar vetë tek Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë) që do të bëjë vlerësimin e syllabuseve të lëndëve mësimore me qëllim që linja e temave të përputhet me tipologjinë e lëndës duke respektuar masën deri në 20% të lejuar me ligj.</i></p>
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Duke iu referuar një sër elementesh që kanë të bëjnë me përmbajtjen e programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore” mund të themi se programi bazuar në emërtimin e tij dhe në një sër elementesh që lidhen me komponentët mësimore dhe sistemin e krediteve (ECTS) mundëson që studentët të futen në procedurat për licensim pranë Urdhrit të Psikologut, por mungesa e zhvillimit të kompetencave profesionale dhe shprehive teorike mund të krijojë vështirësi për studentët, kjo gjë gjithashtu do të kishte ndikim negativ edhe në punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p><i>GVJ sugjeron institucionin e Arsimit të Lartë privat “Albanian University” të jetë korrekt me veten dhe studentët përsa i përket detyrimit ligjor për të ofruar një shërbim me cilësi për të gjithë ato student që i besojnë, duke ofruar staf të kualifikuar dhe në linjë me profilin e psikologut shkollore, që</i></p>

	<i>të jenë në gjendje të ofrojnë një program cilësor që përgatit brezat e rinj të psikologëve shkollorë në vend.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	PAK përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																										
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 6 pedagogë gjithsej ndër të cilët 4 PAE dhe 2 PAK (66.6% / 33.4%).</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>4 Dr.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>-</td> <td>2 Msc</td> </tr> <tr> <td>4 PAE</td> <td>2 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim 5 pedagogë gjithsej nga të cilët 3 PAE dhe 2 PAK (60% / 40%).</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>3 Dr.</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>-</td> <td>2 Msc</td> </tr> <tr> <td>3 PAE</td> <td>2 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim 5 pedagogë gjithsej nga të cilët 4 PAE dhe 1 PAK (80% / 20%).</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th><u>PAE:</u></th> <th><u>PAK:</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1 Prof. Asoc.</td> <td></td> </tr> <tr> <td>2 Dr.</td> <td></td> </tr> <tr> <td>1 Msc</td> <td>1 Msc</td> </tr> <tr> <td>4 PAE</td> <td>1 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>Bazuar në këto të dhëna themi se personeli akademik përmbush kriteret ligjore në fuqi bazuar në mbulimin e ngarkesën mësimore të progrmait të studimit MP në</p>	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	4 Dr.	-	-	2 Msc	4 PAE	2 PAK	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	3 Dr.	-	-	2 Msc	3 PAE	2 PAK	<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>	1 Prof. Asoc.		2 Dr.		1 Msc	1 Msc	4 PAE	1 PAK
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																										
4 Dr.	-																										
-	2 Msc																										
4 PAE	2 PAK																										
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																										
3 Dr.	-																										
-	2 Msc																										
3 PAE	2 PAK																										
<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>																										
1 Prof. Asoc.																											
2 Dr.																											
1 Msc	1 Msc																										
4 PAE	1 PAK																										

	<p>“Psikologji Shkollorë” me staf të brendshëm në masën 80% (PAE).²³⁷.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar të dhënave që kemi mbi edukimin dhe kualifikimin e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi mund të thuhet se përgjithsisht përmbushen standartet referuar titujve dhe gradave, edhe pse sugjerohet të kihet parasysh vijimësia e arsimimit të tyre brenda fushës së psikologjisë shkollorë. Ndërthurja mes stafit me kualifikime të tjera jashtë fushës së psikologjisë, si grada e tituj, vështirë të justifikojë mbulimin e lëndëve karakterizuese të programit, do të kushtëzonin përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kualifikimit profesional për të ushtruar profesionin e psikologut shkollor, dhe për të zhvilluar kompetencat profesionale të studentëve të këtij programi studimi. Personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor për vitin akademik 2020-2021 na është vënë në dispozicion dhe referuar realizimit të këtij programi studimi kryesisht kanë kualifikimin në fushën e psikologjisë, por kualifikime në profilin shkollor nuk ka asnjëri prej anëtarëve të stafit akademik. Kualifikimi i tyre i përket fushës së këshillimit, psikologjisë klinike, dhe 1 në profilin e filozofisë²³⁸. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi në një rast ka një përzierje ose është i profilit të përafërta me psikologjinë por jo me profilin profesional të psikologjisë shkollorë (rasti i pedagogut P.L.) duke rrezikuar lehtësisht mos zotërimin e njohurive të mjaftueshme në drejtim të njohjes së thelluar të fushës në psikologjisë shkollorë. Referuar syllabuseve një pjesë e tyre janë hartuar dhe realizohen nga një numër vogël i stafit akademik, jo të gjithë anëtarët e stafit akademik të dërguar nga AU për këtë program studimi kanë emrin në syllabus si lektor i saj. Bazuar tek syllabuset, i gjithë plani mësimorë i këtij masteri mbulohet vetëm nga 3 pedagogë, P.L.; D.T. dhe B.L.</p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë bazë të tregoj kujdes në përpilim të dokumentacionit dhe të përputhjes së të dhënave në tabalet lidhur me ngrakesën mësimore për vitin akademik 2021-2022²³⁹, syllabuseve²⁴⁰ dhe cv të stafit akademik të anagazhuar në mësimdhënie²⁴¹ në këtë program studimi, pasi</i></p>

²³⁷ Evidenca 66. Tabelat (Tab 6.3)

²³⁸ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²³⁹ Evidenca 66. Tabelat (Tab 6.3)

²⁴⁰ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁴¹ Evidenca 64. Cv e Pedagogëve

	<p><i>të dhënat që nuk përputhen me njëra -tjetrën nga krijojnë paqartësi lidhur me konkluzionet tona si grup pune.</i></p> <p><i>Gjithashtu një kujdes i shtuar duhet në ruajtjen e një balance përsa i përket numrit të lëndëve që mund të mbuloj një lektor në auditor dhe kualifikimi i tij në profilin në të cilin është përgjedhur për të dhënë mësim</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Dokumentacioni përmban CV-të e 5 prej pedagogëve të cilët janë angazhuar në mësimdhënie në MP “Psikologji Shkollorë”, R. B., staf akademik me kohë të pjesëshme, B.L., D. T, L. G., P. L janë staf akademik me kohë të plotë. Për L. G. (PAE) dhe R. B (PAK) është vënë në dispozicion një CV por nuk figuron tek syllabuset si lektore për ndonjërin prej lëndëve mësimore për MP “Psikologji Shkollorë” edhe pse është pjesë e listës emërore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Shkollorë”²⁴² që institucioni ka dërguar në ASCAL. Ndërkohë nëse i referohemi syllabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës dhe lektori që e zhvillon atë, kemi një handicap lidhur me titullarin e lëndës “Vlerësimi dhe Këshillimi me Fëmijët dhe Adoleshentët”, E. H., i cili mban titullin akademik Prof. Asoc.Dr. por i përket fushës së biologjisë, i cili ka njohuri dhe kompetenca profesionale për çështjet e Florës dhe Faunës (duke qenë anëtar i “Qendrës Kërkimore Florës dhe Faunës) por nuk shohim ndonjë lidhje me profilin e psikologut shkollor.</p> <p><i>Kujtojmë sërish AU-në, njësinë bazë dhe njësinë kryesore se profesioni i psikologut është një profesioni i rregulluar me ligj në Republikën e Shqipërisë dhe të drejtën e ushtrimit të tij dhe të ofrimit të kualifikimit për brezat e rinjë e kanë të gjithë ato profesionist që përmbushin detyrimet ligjore për t’u pajisur me licencë nga Urdhri i Psikologut, për të ushtruar profesionin e psikologut shkollor.</i></p> <p><u><i>Për sa më sipër GVJ rekomandon:</i></u></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia bazë duhet të vlerësoj me kujdes kualifikimin e kandidatit në fushën akademike dhe kërkimore. Gjatë përzgjedhjes së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë kusht i domosdoshëm për mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në realizimin e lëndës, përzgjedhja e stafit në mënyrë që të kenë asete për</i>

²⁴² Evidenca 66. Tabelat (Tab 6.3)

	<p><i>zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi studimi;</i></p> <p>- <i>Njësia bazë të tregoj kujdes dhe t'u jap rendësinë e duhur gjatë fazës së përzgjedhjes së stafit akademik të këtij masteri respektimit të kriterëve si eksperiencia në mësimdhënie brenda këtij profili profesional dhe kontributit në kërkimin shkencorë përmes krijimtarisë personale në fushën e kërkimit shkencor me publikime e konferenca në profilin e psikologjisë shkollore;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Marrëveshje e bashkëpunimit institucional që AU ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore janë faktor kyçe për formimin e profilit profesional të psikologut shkollor. Bazuar në dokumentacionin institucional që AU ka dorëzuar në ASCAL, kemi disa marrëveshje si me institucione brenda vendit por edhe me institucione ndërkombëtare²⁴³ si “Shoqata e Psikologëve të Shqipërisë dhe të Kosovës”, “Organizata Plan & Go”, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i Sarajevës, dhe Shkolla e Lartë “Nehemiah Gateway” Bucimas, Pogradec, SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës²⁴⁴, dhe një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”. Këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit i janë shtuar edhe disa të tjera si Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”²⁴⁵, si dhe organizatën jofitimprurëse “Rrjeti Akademik Shqiptar”²⁴⁶, Bashkia e Tiranës (marrëveshja e fundit i përket vitit 2017, dhe nga 3 faqe marrëveshje kemi në dispozicion vetëm 2 faqe)²⁴⁷. Bazuar në këto të dhëna GVJ gjykon se këto institucione nuk përshtaten në mënyrë të drejtpërdrejtë me profilin e psikologut shkollor, gjë që vështirëson mundësinë që t’i shërbej</p>

²⁴³ Evidenca 16. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

²⁴⁴ Edivenca 8. Marrëveshje për praktikat mësimore.

²⁴⁵ Evidenca 6, Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje MP Psikologji Shkollore.

²⁴⁶ Evidenca 5, Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje AU & RASH.

²⁴⁷ Evidenca 7, Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje AU & Bashkia Tirane.

	<p>institucionit për kryerjen dhe mbikqyerjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të këtij program studimi.</p> <p><i>Sugjerimet tona si GVJ, për njësinë bazë lidhen me përpjekjen për të përfshirë edhe intitucione si cerdhe, kopshte, shkolla publike dhe private, me qëllim që studentët të kenë mundësi ti prekin këto terrene profesionale që përkojnë më së miri me emërtimin e këtij program studimi në profilin shkollor, që të mund t'i shërbejë nevojave të praktikës profesionale.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve praktike, seminareve dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të këtij programi studimi. Gjatë vizitës në institucion komunikimi me stafin e pranishëm në takim na dha mundësi të qartësohemi plotësisht në lidhje me këtë aspekt. Vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga njësitë përkatëse përgjegjëse për infrastrukturë dhe mbarëvajtjen e procesit të realizimit të orëve praktike që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme konform rregullave të paracaktuara nga ligjet në fuqi dhe kjo evidentohet në statutin e AU -së, mbështetur në rregulloren e këtij programi studimi. Kordinimi i punës midis njësisë kryesore, asaj bazë dhe rolit të kordinatorit të programit të studimit²⁴⁸ në “Psikologji Shkollore” krijojnë një infrastrukturë të përshtatshme për mbarëvajtjen e punës në këtë program studimi. Në drejtim të bashkëpunimit me partner nga tregu i punës nuk kemi evidence për të gjykuar mbi</p>

²⁴⁸Evidenca 22. Kordinator i programit.

	ndëveprim të drejtpërdrejt me profesionistët e terrenit në konteksin e praktikës profesionale.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Njësia bazë monitoron në vijimësi përshtyrjet e studentëve të këtij program studimi përmes rolit të kordinatorit ²⁴⁹ të këtij program studimi, përmes pyetësorëve për studentët ²⁵⁰ dhe për stafin akademik ²⁵¹ etj. Në takimet me drejtuesit e njëzisë bazë, GVJ u informua se njëzia bazë organizon takime periodike me studentët për të marrë feedback-un e tyre për mënyrën e realizimit të programit mësimor dhe aspektin e realizimit të eksperiencës të praktikës profesionale për të cilën bazuar në dokumentacion jemi të paqartë për kushtet në të cilat realizohet.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Albanian University ka ngritur njësinë e kordinimit dhe mbështetjes studentore dhe zyrës së karrierës dhe alumnit. Për të siguruar mbarëvajtjen e punës janë në dispozicion dhe dy rregullore ^{252; 253} që drejtojnë punën e personelit të anagazhuar në këto drejtime dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit. Mbështetja e kësaj zyre nga projekte dhe institucione të ndryshme lejojnë njësinë të përshtas programin me nevojat e tregut të punës, gjithashtu përmes udhëzimit për zhvillimin e karrierës ²⁵⁴ .
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Duke iu referuar këtij kriteri rezultojnë të vështirë të vlerësohet ky kriter bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion. Mbetet e paqartë sesi institucionin ka reflektuar pas një sërë sfidash që ka pasur ky program studimi që përgjatë ekzistencës së tij që nga licensimi i tij në 2013 për të përmbushur kriteret për ofrimin e një programi cilësor. Bazuar në raportin vjetor 2020-2021 ²⁵⁵ kemi disa aktivitete që janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit institucional që AU ka nënshkruar për shkëmbim të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore, por janë kryesisht konferenca shkencore studentore dhe disa leksione të hapura të me të ftuar. Këto institucione vëhstirë të krijojnë mundësi të mirë në drejtim të realizimit të praktikave

²⁴⁹Evidenca 22. Kordinator i programit.

²⁵⁰ Evidenca 28. Pyetësori I studentëve broshura.

²⁵¹ Evidenca 26. Pyetësori personeli akademik dhe studentet viti akademik 2019-2020.

²⁵² Evidenca 48. Rregullore e ZKMS. (Zyrës së koordinimit dhe mbështetjes për studentët).

²⁵³ Evidenca 49. Rregullore e ZKA (Rregullore e Zyres së karrierës dhe alumnit).

²⁵⁴ Evidenca 45. Udhëzuesi për zhvillimin e karrierës.

²⁵⁵ Evidenca 33. Raporti vjetor 2020-2021.

	profesionale apo dhënies së njohurive mbi fushën e studimit të këtij masteri profesional në të gjitha rastet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i plotë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Niveli i plotë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni, nxitur se fundmi edhe nga kushtet e pandemisë ka realizuar trajnime të stafit lidhur me përdorimin e platformës elektronike “Google Classroom” nga lektorja Dr. G. R., mbi manualin për zhvillimin e mësimin online ²⁵⁶ si dhe një sër aktivitetesh si “Vlersimi psikosocial dhe motivimi i studentëve për të rritur vetefikasitetin dhe të nxënit” nga Prof. Asoc. A. Sh., “Roli i personelit akademik në rritjen e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë” nga Dr. N. H. etj ²⁵⁷ . Këto aktivitete mundësojnë stafin akademik në rritjen e kompetencave profesionale në drejtim të mësimdhënies, gjithashtu në përmirësimin e metodave inovative në mësimdhënie.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të	AU dhe njësia kryesore dhe ajo bazë në drejtim të realizimit të monitorimit dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, ka ngritur një strukturë të quajtur

²⁵⁶ Evidenca 47. Manuali i zhvillimit të mësimot online në Microsoft teams.

²⁵⁷ Evidenca 35. Tranime të stafit akademik.

<p>personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë²⁵⁸²⁵⁹, i cili punën e tij e bazon në tre dokumenta që janë: Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,²⁶⁰ Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti²⁶¹ dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë²⁶². Gjithashtu dhe një sër vendimesh që lidhen me ekspertizën e jashtme që i shtohet kësaj strukture në drejtim të rritjes së cilësisë të lidhur me vendimarrjen e Bordit të Administrimit për konsulencë juridike pranë Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nga Dr. E. P²⁶³. dhe vendimi për të propozuar Prof. Asoc. B. K.²⁶⁴ në rolin e konsulentit për çështjet e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave në “Albanian University” konsiderohen si tepër të rëndësishme në funksion të misionit për rritjen e cilësisë. Përmes tyre duhet të monitorohet puna e personelit akademik dhe ndihmës akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor. Pavarësisht këtyre strukturave dhe burimeve njëzore në dispozicion të rritjes së cilësisë dhe të përmirësimit të kurrikulave, ky program studimi ka këto vështirësi të cilat po kompromentojnë cilësinë në mësimdhënie.</p> <p><i>GVJ sugjeron këto struktura të jenë më aktive:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - për të monitoruar punën e njësisë bazë në drejtim të përmirësimit të syllabuseve të lëndëve mësimore; - përditësimit të literaturës së përdorur në funksion të këtij program studimi; - dhe të përzgjedhjes së stafit të cilët përmbushim kriteret për kualifikim e përgjithshëm në fushën e psikologjisë dhe specialitetin në linjë me profilin e psikologjisë shkollore;
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e</p>	<p>Albanian University garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët²⁶⁵, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti</p>

²⁵⁸ Evidenca 52. Vendim senati për krijimin e komisionit të përhershëm në rang institucional.

²⁵⁹ Evidenca 51. Vendim senati për ngritjen e zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë në rang institucional.

²⁶⁰ Evidenca 59. Rregullore e NJSBC.

²⁶¹ Evidenca 53. Sigurimi I cilësisë njësi bazë

²⁶² Evidenca 54. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

²⁶³ Evidenca 55. Vendimi i Bordit të Administrimit konsulente juridike pranë NJSBS Dr. E. P.

²⁶⁴ Evidenca 56. Vendim mbi caktimin e personelit akademik si konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Prof Asoc. B. K.

²⁶⁵ Evidenca 27. Pyetësori nga NJSBC viti akademik 2021-2022.



<p>metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angzhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit. Duke iu referuar të dhënave nga ky proces, rezultojnë se përsa i përket numrit të studentëve pjesëmarrës në rang njësie baze, ky numër është i vogël. Nga 28 student të regjistruar, pjesëmarrës në plotësimin e pyetësorit kanë qenë vetëm 3 prej tyre, kjo në vetvete nuk na lejon të qartësohemi mbi feedback-un e studentëve. Gjithashtu duke iu referuar më tej këtyre statistikave, disa nga komentet e dhëna nga studentët parashtrajnë disa çështje si: - “sugjerim për përmirësimin e zhvillimit të orës së mësimi”; - “organizim dhe kordinim në shpjegimin e temave mësimore” – “do ishte më mirë të jepte leksionin pedagogia e seminarit se është shumë e përgatitur” – “të dërgohen leksionet në kohë”. Edhe pse janë statistika të përgjithshme duke gjykuar mbi cilësinë e syllabuseve të lëndës, literaturës së përdorur, një pjesë e këtyre komenteve mund t’i përshtaten shumë mirë perceptimit të studentëve të programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore”.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve periodike të ndërmarra nga institucioni pas zbardhjes, i vihen në dispozicion njësisë bazë dhe asaj kryesore. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë duke synuar respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, ka ndërmarra hapa që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim si përmes raportit vjetor të vetvlerësimit të programit të studimit,²⁶⁶ i cili lejon të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndryshimet apo praktikën profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel programi, statistika të regjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlersimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikatat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlersim kryhet nga grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti²⁶⁷ monitoron programin në vijimësi, duhe u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë. Gjithashtu nga analiza e të</p>

²⁶⁶Evidenca 34. Modeli i raportit të vetvlerësimit të programit.

²⁶⁷Evidenca 30. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.



	dhënave të mbledhura nga fokus-grupet e organizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ²⁶⁸ në janar të vitit 2022 ka ndërmarrë takime me studentët e programit të studimit në lidhje me cilësinë e ofruar të shërbimeve të ofruara nga AU, dhe ku u janë komunikuar gjetjet njësisë bazë. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	AU duke iu referuar strukturave të ngritur lidhur me monitorimin e ecurisë së programeve të vlerësimit në nivel institucional ndërmerr një sër veprimtarish në drejtim të monitorimit të cilësisë. Mbështetur në raportimin nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmes raporteve që i ka vënë në dispozicion Njësia Bazë do kishe pasur një reagim në favor të rritjes së cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve akademike si plani mësimor ²⁶⁹ , syllabusët e lëndëve ²⁷⁰ , rregullorja e programit të studimit ²⁷¹ , takimet me stafin akademik e studentët, sistemi i trasmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet dhe seminarët, kjo e mbështetur në formën interaktive të zhvillimit të njohurive, në funksion të një të kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione. Këtyre dy formave të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare. Veprimtaritë e tjera ndihmëse ²⁷² si leksionet e hapura me të ftuar të profilit të këtij programi studimit, konferencat shkencore gjithashtu janë në funksion

²⁶⁸ Evidenca 29. Shkresë fokus grupe.

²⁶⁹ Evidenca 20. Plani mësimorë në MP Psikologji Shkollore

²⁷⁰ Evidenca 9. Syllabusët e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁷¹ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

²⁷² Evidenca 33. Raporti vjetor 2020-2021.

	<p>të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimxënies. Me ndikim pozitiv në këtë drejtim është dhe përdorimi i sistemit të teknologjisë së informacionit nga stafi dhe studentët në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të viteve të fundit sipas informacionit të marrë në takimin me stafin akademik dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, nga ditët e vizitës në institucion, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimxënies. Megjithatë implementimi i këtyre kërkesave duhet monitoruar në vijimësi, pasi nëse syllabuset e hartuara dhe të mbuluara nga stafi akademik paraqesin një sër problemesh dhe mungesa e kualifikimit akademik dhe përvoja e punës në profilin e psikologjisë shkollorë, cënon drejtpërdrejtë cilësinë në mësimdhënie në lëndët e tyre mësimore. Këto mangësi do të impaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë cilësinë në zhvillimin e kompetencave dhe njohurive teoriko-praktike në profilin profesional të psikologut shkollorë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit të ciklit të dytë MP në “Psikologji Shkollorë”, duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndëve/moduleve me një literaturë të viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimxënies.</p> <p><i>Mbështetur në raportet e vlersimit të brendshëm të cilësisë dhe në syllabuset e lëndëve mësimore, kërkohet një angazhim më i madh i strukturave të institucionit në drejtim të pasurimit të fondit të bibliotekës dhe gjithashtu të vet stafi akademik të angazhuar në këtë program profesional studimi, për të përditësuar dhe pasuruar sillabuset e lëndëve me</i></p>

	<p><i>literaturë të viteve të fundit, apo minimalisht të trejtojnë kujdes që literature e përdorur të përshtatet me nevojat e studentëve të këtij masteri, duke shmangur rezikun e përsëritjes së informacionit të marrë në ciklin e parë të studimeve .</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duke iu referuar CV-ve të tyre²⁷³, syllabuseve të lëndëve mësimore²⁷⁴, has një sër mangësish në drejtim të kompetencave profesionale që duhet të zotërojnë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve sipas tematikave të mësimore. Temat e trajtuat nuk përputhen në një pjesë të madhe me tipologjinë e lëndës, si te “Dimensioni Kongitiv - Sjellor, Nxitja e aftësive Akademike dhe Menaxhimi Sjellor” ku brendia e temave kanë një fokus në psikologjinë kongitive, të ezauruara nga studentët në nivelin bachelor. Po ashtu duke iu referuar syllabusit të lëndës “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²⁷⁵, kemi tema që fokusohen në një hyrje në psikologjinë e zhvillimit sesa në tipologjinë e kësaj lëndë bazuar në emërtimin e saj, ku mund të përmendim disa prej temave si “Aspekte të përgjithshme të Zhvillimit”; “Teoritë e Zhvillimit Psikologjik”; “Metodat e vëzhgimit në psikologjinë e zhvillimit” etj. Po ashtu lënda “Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”²⁷⁶ po të shohësh me vëmëndje temat e trajtuara duket se jep një informacion më tepër për psikologjinë e këshillimit dhe lë pak ose aspak hapsira për aspekte që kanë të bëjnë me dilemat dhe sfidat profesionale të psikologut shkollor, më të pakuptimtë pastaj e bëjnë edhe temat që nuk kanë lidhje me psikologun shkollor por atë ligjor si psh temat me titull “Shkruajtja e raporteve për përdorim gjyqësor” kur e dimë se një psikolog shkollor vetëm referon dhe nuk merret me hartimin e raporteve të vlerësimit për nevojat e gjykatës; apo tema numër 10 me titull “Cështjet e etikës në punën me minoritetet seksuale” termi “minoritet seksual” si koncept nuk na ndihmon të kuptojmë qartë llojin e informacionit që trajton apo lidhjen me rolin e psikologut shkollor në drejtim të formimit të kompetencave profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët? Një tjetër problematikë lidhet me</p>

²⁷³ Evidenca 64. Cv e pedagogëve.

²⁷⁴ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁷⁵ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁷⁶ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

temën numër 3 që fokusohet tek kontrata e miratimit të informuar me titullin “Kontratat e psikologëve me dhe brenda organizatave” dhe temën numër 5, 12 që sërish fokusohet tek kontrata e miratimit të informuar dhe konfidencialiteti. Lëndët “Hyrje në Psikologji Shkollore”²⁷⁷ dhe “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²⁷⁸ paraqesin një situatë të paqartë bazuar në përmbajtjen e syllabuseve, ku tema të caktuara përsëriten sërish edhe pse të dyja këto lëndë bazuar te syllabuset²⁷⁹ realizohen në auditor nga i njëjti lektor. I referohemi edhe lëndëve “Etika Profesionale e Psikologut Shkollor”²⁸⁰ dhe “Hyrje në Psikologji Shkollore”²⁸¹ ku në të dyja këto lëndët trajtohet tema “Etika e Psikologut Shkollorë” edhe pse me të njëjtët student presupozohet se çështjet etike të jenë ezauruar plotësisht në lëndën që i dedikohet etikës.

Bazuar tek lënda tjetër “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët” kemi një situatë shqetësuese lidhur me bredninë e temave të cilat nuk kanë lidhje me tipologjinë e kësaj lëndë të përshtatur për nevojat e studentëve të ciklit të dytë të studimeve, por më tepër për nevojat e nëxësve apo studentëve të nivelit bachelor lidhur me elementët bazë të komunikimit, citojmë këtu tema të caktuara mësimore si: tema 1- Objektivat e shkencës së psikologjisë së komunikimit; Modelet kryesore të komunikimit”; tema 2- Elementet, faktorë dhe çështje që lejojnë përparësitë dhe nxisin pengesat në procesin e komunikimit”; tema 3 – “Procesi i dëgjimit, Qëndrimet dhe situata optimale gjatë komunikimit”. Gjithashtu një problematikë e cila duhet adresuar lidhet me faktin që si titullar i lëndës “Hyrje në Psikologji Shkollore”²⁸² figuron E. H. me titullin akademik Profesor i Asociuar që i përket profilit të bio-kimisë pa ndonjë lidhje me degën e psikologjisë. Kjo evidencë paraqitet si shqetësuese lidhur me mënyrën sesi mund të jetë ky syllabus në përputhje me profilin e psikologut shkollorë. Profesionin e psikologut bazuar në ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009²⁸³, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e

²⁷⁷ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁷⁸ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁷⁹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁸⁰ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁸¹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁸² Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁸³ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

	<p>Shqipërisë dhe në mbështetjen të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me Propozim të Këshillit të Ministrave vendosi që profesioni i psikologut të përfshihet në grupin e profesioneve të rregulluar²⁸⁴. Profesion i rregulluar është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale të veçanta. Bazuar në syllabuset e lëndëve mësimore dhe te titullarët²⁸⁵ e angazhuar në hartimin e syllabuseve në këtë master evidentohet se një pjesë e stafit nuk është brenda profilit të psikologut.</p> <p><i>Njësia bazë duhet të vlerësoj me kujdes kualifikimin e kandidatit në fushën akademike dhe kërkimore në psikologji shkollore. Gjatë përzgjedhjes së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë kusht i domosdoshëm për mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në realizimin e lëndës, përzgjedhja e stafit në mënyrë që të kenë asete për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi studimi në profilin shkollor. Një vëmendje e shtuar duhet të tregohet në lidhje me disa pedagogë të cilët u përkasin disiplinave të tjera dhe që mund të cungojnë nivelin e njohurive të trasmetuara tek studentët e masterit profesional në “Psikologji Shkollore”.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni përmes strukturave të ngritura synon që përmes kërkesës nga zyrës së kurrikulës dhe cilësisë për përditësimin e literaturës dhe përfshirjes së studentëve në këtë proces ka një përpjekje përmes rolit të kordinatorit të programit MP në “Psikologji Shkollore”, Grupit të Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti si dy struktura që monitorojë kompetencat e personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Përfshirja e studentit në vlersimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët²⁸⁶ për stafin akademik²⁸⁷, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies.</p>

²⁸⁴ Ligji Nr.10171, datë 22.10.2009, Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë

²⁸⁵ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁸⁶ Evidenca 28. Pyetësori I studentëve broshura.

²⁸⁷ Evidenca 26. Pyetësor personel akademik dhe studentet viti akademik 2019-2020.



	Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit. Gjithashtu, edhe fokus grupet janë një tjetër formë që institucioni përdor në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të pedagogëve.								
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Nga vlersimi i mënyrës sesi duhet të jenë hartuar syllabuset duhet të ketë një larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie si role-play, studim rastesh, fokus-grupë që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimit. Këto forma duhet t'i përshtaten disiplinës së psikologjisë shkollore me qëllim që të ndihmojnë studentët të fitojë njohuri praktike mbi rolin dhe detyrat e psikologut shkollor. Mbetet e vështirë që të realizohen këto objektiva kur një pjesë e stafit akademik nuk ka një kualifikim dhe ekperiencë në profilin e psikologjisë shkollore.								
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Duke u mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog –student, respektohet dinjiteti dhe integriteti i çdo studentit. Proçesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë positive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuq përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuq përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuq përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Proçesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Infrastruktura fizike në dispozicion të programit të studimit MP në "Psikologji Shkollore" ²⁸⁸ është e mjaftueshme për realizimin e proçesit mësimor në Godinën e ish-Estradës, me sipërfaqje 4618.2m ² . Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në dispozicion një sipërfaqje të mjaftueshme, në 10 salla

²⁸⁸ Evidenca 33. Raporti vjetor 2020-2021.

	<p>leksioni dhe 20 salla seminari me kapacitetin e nevojshëm për numrin e studentëve të këtij program studimi. Sallat e leksionit dhe të seminarit në dispozicion të procesit mësimor janë të pajisura me videoprojektor dhe kompjuter secila. Sallat janë të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i agjencisë së kontraktuar për këtë shërbim.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Ambjentet të dedikuara procesit mësimor për MP në “Psikologji Shkollore” janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si videoprojektor, disa salla leksioni janë të pajisura me foni dhe internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një laborator informatike me kapacitet 35 vende, bibliotekën online në Elsevier, Eric, Cambridge Journals²⁸⁹. Gjithashtu një ambient që është në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor është dhe biblioteka e cila ka një kapacitet të mjaftueshëm për nevojat e studentëve të këtij programi profesional, me infrastrukturën e nevojshme si kompjuter dhe internet.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Për nevojat e procesit mësimorë stafi akademik dhe studentët shfrytëzojnë dhe sistemin e teknologjisë së informacionit si Google Classroom, Teams për të cilën janë realizuar edhe trajnime të stafit akademik për mënyrën e përdorimit²⁹⁰. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor labore informatike, bibliotekën online në Elsevier, Eric, Cambridge Journals²⁹¹. Platforma elektronike Teams ka bërë të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio visive, duke lejuar studentët të informohen në kohë reale. Ambientet janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht web. Pedagogët dhe studentët shprehën se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit nga GVJ konstatojmë se literatura bazë në gjuhën shqipe, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin një</p>

²⁸⁹ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

²⁹⁰ Evidenca 47. Manuali I zhvillimit të mësimot online në Microsoft teams.

²⁹¹ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.



(fizike dhe elektronike)
garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.

literaturë e cila nëse i referohemi syllabuseve të lëndëve mësimore²⁹² të vënë në dispozicion paraqesin një sër mangësish. Një pjesë e literaturës bazë është e një viti botimi e një dekade më parë dhe shkon ndesh me kërkesat ligjore për përditësim të literaturës mësimore me një literaturë të viteve të fundit dhe një pjesë e kësaj literature përpos faktit që është botim i para 10-20 viteve²⁹³, ajo është ezauruar në lëndë specifike gjatë ciklit të parë të studimeve nga ana e studentëve. I referohemi tekstit “Etika në Këshillim” e autoreve M. Dh & A.S.; “Psikologji Zhvillimi” që përdoret si tekst bazë për lëndën “Dimensioni Social-Emocional dhe Strategjitë për Integrim dhe Përshtatje”²⁹⁴. Për lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët” si literaturë bazë janë dy tekste: “Psikologji Komunikimi” B. C (2001) dhe “Psikologji Komunikimi” e autores A. SH (2008). Të dy tekste që i përshtaten njohurive të përgjithshme për komunikimin në përgjithësi, për studentët e nivelit bachelor dhe pa një lidhje të qarte me lëndën “Komunikimi Klinik me Fëmijët dhe Adolëshentët”. Gjithashtu bazuar tek syllabusi i lëndës “Praktikë Profesionale” sipas të dhënave rezultojn se kjo lëndë realizohet në auditor, e ndarë në dy semestra, 120 orë, e shoqëruar me tema mësimore mbi: “Zhvillimin e aftësive të të mënduarit”; “Zhvillimin emocional”; “Këshillimin individual”; “Këshillimin në grup”; “Droga, duhani. Alkoli” etj dhe literaturë të autores G. S. “Nga teoria në praktikë” tekst për metodologjinë e të nxënit. GVJ është konfuz lidhur me mënyrën sesi një tekst që nuk i trajton këto tema e ndihmon titullarin e lëndës dhe lektorin në auditor t’i trajtojë para studentëve në lëndën e “Praktikës Profesionale”. Një tjetër lëndë me problematika është edhe “Vlerësimi dhe këshillimi me fëmijët dhe adoleshentët” me tema të cilat nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejt me tipologjinë e lëndës por fokusohen te “Roli i shkollës e komuniteti”, “Roli i psikologut shkollorë” apo “Shkolla dhe organizimi i sistemeve zhvillimi i politikave dhe mjedisi”.

Sugjerohet stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi të përditësojë literaturën bazë me tekste akademike cilësore dhe që të jenë të viteve të fundit. Gjithashtu stafi akademik duhet të tregoj kujdes në përzgjedhjen e teksteve mësimore në linjë me profilin e këtij mastëri me qëllim që të

²⁹² Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁹³ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

²⁹⁴ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

	<i>arrihen objektivat e lëndës mësimore në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve të psikologjisë shkollore.</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Shoqërore ka në dispozicion të drejtimit kryesore për programin e studimit një numër të caktuar tekstesh në gjuhën shqipe ²⁹⁵ . Gjithashtu sipas informacionit të marrë pranë bibliotekës kemi një listë prej 175 tekstesh fizike, nga të cilat 40 në fushëm e psikologjisë. Prej të cilave pjesa më e madhe e tyre kanë një vit botimi para 2010, ndërsa ato pak tekste dhe artikuj të viteve të fundit janë punime doktrature dhe artikuj shkencorë. Një pjesë e vogël e teksteve janë në gjuhë të huaj kryesisht botime të viteve 2001-2010. Nuk kemi mjaftueshëm evidenca të vëna në dispozicion nga institucioni për të gjykuar mbi cilësinë e literaturës së detyruar që duhet të përditësohet nga pedagogu dhe që duhet ishte e viteve të fundit, (siç deklarohet nga përgjegjësi i njësisë kryesore dhe bazë), kjo pasi nga shqyrtimi i literaturës në bibliotekë nuk përputhet me kërkesën e institucionit në drejtim të teksteve mësimore. Kërkesës tonë për të parë një procedurë për marrjen e teksteve të reja për këtë vit akademik nuk i vu në dispozicion ndonjë informacion apo material as nga biblioteka dhe njësia bazë.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Pranë bibliotekës të AU kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët. Gjithashtu këtij aspekti i shërbenjë edhe platformat online Elsevier, Eric, Cambridge Journals ²⁹⁶ me të cilat ishte përmbyllur marrëveshja për këtë vit akademik. Stafi akademik dhe studentët e programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore” kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformat elektronike të aksesimit në tre bibliotekat online të Elsevier, Eric, Cambridge Journals. Nuk u pa ndonjë abonim në revista të fushës së psikologjisë në bibliotekë.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve,	Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion ^{297,298} infrastruktura në mbështetje të zhvillimit të veprimtarive didaktiko-teorike dhe kërkimore nga studentët

²⁹⁵ Evidenca 6. Procedura e blerjes së teksteve 2019,2020, 2021.

²⁹⁶ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

²⁹⁷ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

²⁹⁸ Evidenca 33. Raporti vjetor 2020-2021.

<p>detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>dhe stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte e përshtatshme dhe të lejonte akses në një sër formash ndërveprimi, si mbulimi i ambienteve të AU-së me Wi-Fi, biblioteka e pajisur me sallë leximi dhe hapësira komode, laborator i informatikës me 35 vende, dhe 2 kompjuter në ambientet e bibliotekës, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë literaturën on-line të vëna në dispozicion përmes shfrytëzimit të platformave online Elsevier, Eric, Cambridge Journals²⁹⁹.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies stafi dhe studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekat online duke u bazuar edhe në abonimin që ka në platformat online si Elsevier, Eric, Cambridge Journals. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor laboratore informatike, dhe 2 platforma elektronike si “Google Classroom” dhe “Teams” të cilat shfrytëzohen për nevojat e lëndëve mësimore që studentët të azhurnohen mbi materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Duke iu referuar vizitës në institucion, institucioni po angazhohet të bëjë funksional për nevojat e tij sitimin e komunikimit të brendshëm “Pitagora”, i cili do të ndihmojë studentët dhe stafin të realizojnë një sër procedurash në mënyrë eficiente dhe që lejon të gjithë përdoruesit e tij të informohen në kohë reale lidhur me mungesat, sezonin e provimeve, notat etj. Nga të dhënat e marra nga sekretaria mësimore bëjnë këtë proces manualisht dhe me prezencë fizike në institucion të studentëve për tu informuar për notat etj. Përsa i përket përdorimit të hapësirës vetjake dedikuar stafit dhe studentëve mund t’i refrohemi sistemit “Google Classroom” dhe “Teams” ku secili prej përdoruesve regjistrohet dhe në vijim akseson në sistem në çdo kohë dhe vend duke u informuar në lidhje me programin e lëndës, literaturën dhe detyrat e kursit, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme etj. Përdorimi i këtyre dy platformave nga stafi akademik dhe studentët për nevoja të lëndëve mësimore, shihet si tepër efektiv në drejtim të rritjes së aksesit në burimet e brendshme të informacionit.</p>

²⁹⁹ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Duke iu referuar të dhënave të vëna në dispozicion rezulton se institucioni në lidhje me orientimin, asistimin dhe mbështetjen nga ana e personelit akademik për studentët gjatë fazës së diplomimit³⁰⁰ AU-ja ka një strukturë të mirë organizuar, e cila i krijon kushtet e nevojshme studentit në përmbylljen me sukses të kësaj faze. Kjo realizohet konkretisht nga njësia bazë dhe kordinatori i programit të studimit, i cili paraqet studentëve listën e pedagogëve që janë në dispozicion për programin e studimit, më pas student plotëson formularin e aplikimit për temën e diplomës, departamenti bën miratimin e tyre sipas kritereve specifike për punimin e temës duke u bazuar në udhëzuesin e saj, gjithashtu të detyrueshme për studentin takimet me udhëheqësin e tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni bazuar në strategjinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë³⁰¹ synon monitorimin e promovimin e cilësisë në mësimdhënie përmes një sër formash si pyetësorët e studentëve, fokus grupet me studentët, raportet e vetvlerësimit të pedagogëve, formularit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të pedagogëve, formularit të vetvlerësimit të drejtuesit të departamentit etj. AU ka ngritur disa struktura të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie, si Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimdhënien dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave³⁰². Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë^{303,304}, i cili punën e tij e bazon në tre</p>

³⁰⁰Evidenca 24. . Manuali I punimit të temës së diplomës.

³⁰¹ Evidenca 54. Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

³⁰² Evidenca 57. Rregullore e zyrës njësisë së monitorimit të kurrikulave.

³⁰³ Evidenca 52. Vendim senati për krijimin e komisionit të përhershëm në rang institucional.

³⁰⁴Evidenca 51. Vendim senati për ngritjen e zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë në rang institucional.

	<p>dokumenta që janë: Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë,³⁰⁵ Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti³⁰⁶ dhe Strategjia për Sigurimin e Brendëshëm të Cilësisë³⁰⁷. Këto janë evidenca që demostrojnë angazhimin e institucionit në këtë drejtim. Gjithashtu dhe një sër vendimesh që lidhen me ekspertizën e jashtme i shtohet kësaj strukture në drejtim të rritjes së cilësisë të lidhur me vendimarrjen e Bordit të Administrimit për konsulencë juridike pranë Njesisë së Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë nga Dr. E. P³⁰⁸. dhe vendimi për të propozuar Prof. Asoc. B. K.³⁰⁹ në rolin e konsulentit për çështjet e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave në “Albanian University” konsiderohen si tepër të rëndësishme në funksion të misionit për rritjen e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimit e cilësisë dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie në nivel njësie janë të lidhura me rolin e kordinatorit të programit të studimit³¹⁰, grupi i cilësisë në nivel departamenti³¹¹ dhe grupi i sigurimit të brendëshëm të cilësisë³¹². Këto struktura si dhe njësitë për sigurimin e cilësisë në nivel institucional kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë njësinë bazë në këtë drejtim përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - raportit të vlerësimit të brendëshëm³¹³ të programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore”, përmes të cilit vlerësohet cilësia e programit bazuar në 6 fusha kryesore. - raportit vjetor të vetvlerësimit të programit të studimit³¹⁴ i cili lejon të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndyshimet apo praktikën profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel programi, statistika të rregjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse

³⁰⁵ Evidenca 59. Rregullore e NJSBC.

³⁰⁶ Evidenca 53. Sigurimi i cilësisë njësia bazë

³⁰⁷ Evidenca 54. Strategjia për sigurimin e brendëshëm të cilësisë.

³⁰⁸ Evidenca 55. Vendimi i Bordit të Administrimit konsulente juridike pranë NJSBS Dr. E. P.

³⁰⁹ Evidenca 56. Vendim mbi caktimin e personelit akademik si konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Prof Asoc. B. K.

³¹⁰ Evidenca 22. Kordinatori i programit.

³¹¹ Evidenca 30. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

³¹² Evidenca 5. Ngritja e grupit të vlerësimit të brendëshëm.

³¹³ Evidenca 1. RVB. Raporti i vetvlerësimit të programit.

³¹⁴ Evidenca 34. Model raporti i vetvlerësimit të programit.

	<p>të programit të studimit, vlersimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlersim kryhet nga grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti³¹⁵ monitoron programin në vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <p>- fokus-grupeve të organizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë³¹⁶ në Janar të vitit 2020 ka ndërmarrë takime me studentët e programit të studimit në lidhje me cilësinë e ofruar të shërbimeve të ofruara nga AU.</p> <p>Raporti vjetor i departamentit³¹⁷, në të cilën parashtrohet një informacion mbi programet e studimit që janë aktive, stafin akademik, mësimdhënia dhe studentët, infrastruktura, bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar, mobilitetet e stafit e studentëve etj. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitet përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat dhe njësia bazë duket se inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes hapësirave në drejtim të organizimit të trajnimeve³¹⁸ leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj³¹⁹. Institucioni duket se bën përpjekje në këtë drejtim përmes kërkesës për përditësim të literaturës për lëndët përkatëse dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Optime” dhe shfrytëzimit të platformave online Elsevier, Eric, Cambridge Journals³²⁰.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Duke iu referuar nevojës në rritje për cilësi në mësimdhënie, një sër aktivitetesh janë ndërmarrë nga institucioni, si trajnime të stafit akademik³²¹, leksione të hapura, tryeza të rumbullakta etj. Ndër to mund të evidentojmë trajnimin e Prof. G. A. me tematikë mbi “Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit</p>

³¹⁵Evidenca 30. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

³¹⁶Evidenca 29. Shkresa për fokus grupet.

³¹⁷ Evidenca 33. Raporti vjetor 2020-2021.

³¹⁸ Evidenca 17. Shkresa për modulet e trajnimit.

³¹⁹ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

³²⁰ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

³²¹ Evidenca 17. Shkresa për modulet e trajnimit.

	ERASMUS+ ³²² . Përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Optime” dhe pjesmarrjes në konferencat që AU organizon pa pagesë për stafin e tij akademik, gjithashtu synon të mbështetet ky aspekt nga institucioni.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Personelit të angazhuar në këtë program studimi i kërkohet të përmirësohet vazhdimisht, kjo lidhur me kërkesën për kualifikim dhe avancim në kërkimin shkencor ³²³ , duke monitoruar nivelin e tyre të kualifikimit, publikimin në revista shkencore, pjesmarrjen në konferenca, projekte dhe mobilitete të ndryshme. Gjithashtu institucioni organizon trajnime ³²⁴ leksione të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj ³²⁵ me qëllim mbështetjen e stafit në këtë drejtim. Këto veprimtari jo vetëm ndihmojnë në kualifikimin e tyre por edhe në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie të stafit akademik për këtë program studimi.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik i angazhuar në programin e studimit MP në “Psikologji Shkollorë”, lidhur me këtë kriter nuk kemi evidence të qarta përsa i përket angazhimit për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja nga ana e stafit. Por duke iu referuar syllabuseve të lëndës në realizimin e temave mësimore kemi praninë e një sër formash interaktive të mësimdhënies si studime rasti, role-play etj të cilat ndihmojnë të nxënit.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Në lidhje me këtë kriter nuk kemi evidence të qarta përsa i përket testimit dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat e reja në mësimdhënie. Por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, dhe formulari i vetvlerësimit të performancës, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie. <i>Sugjerohet nga GVJ, një punë më e mirë nga njësia bazë në drejtim të monitorimit me kujdes të syllabuseve të lëndëve që</i>

³²² Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

³²³ Evidenca 3. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Formular i veprimtarisë kërkimore-shkencore Redina.

³²⁴ Evidenca 17. Shkresa për modulet e trajnimit.

³²⁵ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

	<i>miraton pasi ky aspekt duke iu referuar syllabuseve të lëndëve paraqeset mangësi të dukshme të cilat duhet të adresohen shpejt dhe drejt në mënyrë që të mos çenojnë programin e studimit dhe cilësinë e shërbimit që meritojnë të marrin studentët e masterit profesional në "Psikologji Shkollore".</i>			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka përfshirë edhe personel nga struktura të tjera të brendshme të AU dhe nga bashkëpunëtor të jashtëm ³²⁶ . Duke iu referuar analizës vjetrore ³²⁷ të realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë realizuar një sërë vepritarishë si trajnime, tryeza të rrumbullakta, leksione të hapura me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas. Ndër to mund të evidentojmë trajnimin e Prof. G. A. me tematikë mbi "Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit ERASMUS+.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit ³²⁸ , sistemin e vlerësimit të studentit, formatin e tezës së provimit përfundimtar, mbi punimin e diplomës. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar sistemin google classroom apo platformat elektronike që përdoren nga studentët e këtij program studimi. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe

³²⁶ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

³²⁷ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

³²⁸ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

	vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët edhe përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Proçedura që aplikohet nga AU paracakton detyrimin e stafi akademik për të informuar studentët në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuse ³²⁹ në fillim të çdo lënde apo moduli. Gjatë vizitës në institucion na u referua nga stafi dhe studentët e këtij program studimi se ky informacion u jepet studentëve edhe në departamentin e psikologjisë. Bazuar në hartimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore” në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve mësimore u japin studentëve hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlerësimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit. Duke u dhënë në këtë mënyrë mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet me shkrim, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma, për

³²⁹ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

	programin e studimit. Nuk kemi evidenca për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Proçedura e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit³³⁰ në MP “Psikologji Shkollore”, parashikon vlerësimin e studentëve në mënyrë të vazhdueshme duke pasur si qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit; - realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit; - duke e ndarë notën në disa komponentë; <p>Në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim kjo metodë synon vlerësimin e ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Duke iu referuar përdorimit të sistemit elektronik për realizimin e procesit të testimit dhe të vlerësimit, si një mjet që rrit transparencën në vlerësim dhe eliminojnë pandershmërinë akademike nuk kemi evidence për përdorimin e një forme të tillë nga institucionit për këtë proces. Edhe pse në vendin tonë, disa IAL-e, tashmë kanë nisur që këtë proces ta realizojnë me ndihmën e sistemit

³³⁰ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore



	elektronik "CleanScore", i cili ju vjen në ndihmë stafit akademik përmes korrigjimit të provimeve në mënyrë të automatizuar, i cili mbulon të gjitha pyetjet e provimit dhe është i organizuar me alternative/ VB/ kombinime, duke e bërë procesin sa më transparent dhe të besueshëm për studentët.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Njësia bazë ka një procedurë të mirëorganizuar në drejtim të hapave e afateve kohore që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës. Disa prej këtyre aspekteve kanë të bëjnë me; dorëzimin të paktën një ditë përpara zhvillimit të provimit për t'u miratuar nga Përgjegjësi i njësisë bazë, kur numri i studentëve në sallën e provimit e tejkalon 50% të kapacitetit të saj, pedagogu duhet të përdorë dy teza të ndryshme. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik. Praktikat profesionale, dhe mbrojta e diplomave realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e personelit ndihmës akademik të departamentit që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimat e çdo studenti. Çsekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Nuk kemi evidenca për përdorimin e mjeteve të tjera të survejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Procedura e pas provimit në lidhje me komentet apo feedback-un mbi rezultatet e testimit nuk kemi evidenca për të gjykuar plotësisht mbi këtë aspekt, por bazuar në rregulloren e programit të studimit ³³¹ ka procedura të mirëorganizuar për mënyrën, sesi hartohet teza dhe realizohet vlerësimi në mënyrë të copëzuar që t'u japë mundësi studentëve dhe t'u përshtaten stileve të ndryshme të të nxënimit. Pedagogu i lëndës pas provimit dorëzon në departament tezën orgjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet.

³³¹ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore



<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësia bazë është në rolin e monitorueses dhe mbikqyrëse lidhur me respektimin e procedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik lidhur me rregullat e realizimit të detyrave dhe detyrimeve për përmbylljen me sukses të programeve lëndore. Një sër elementësh që lidhen me mospërdorimi i së njëjtës tezë provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin mundësi të mirat për të shmatur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra. Drejtuesi i Departamentit garanton zbatimin e këtij rregulli.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme disponon një procedurë të mirëfilltë përse i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Shkollore”. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit³³² dhe në syllabusin e lëndës.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë MP në “Psikologji Shkollore” respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlersimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit³³³. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit. Studenti njihet me rezultatet në datën e përcaktuar nga pedagogu i lëndës për konsultimin e provimit ose përmes sekretarisë mësimore.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e brendshme të programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore” cdo student ka të drejtë të konsultoj tezën, të kërkoj sqarim për notën, të kërkoj rivlersim të notës përmes komisioneve të posacme që ngrihen nga njësia bazë për këtë qëllim. Duke u bazuar në rregulloren e</p>

³³² Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

³³³ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

	njësisë bazë ³³⁴ , të programit të studimit ³³⁵ dhe tek dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Duke iu referuar këtij kriteri shihet me skepticizëm thellimi i njohurive teoriko-didaktike dhe zhvillimi i kompetencave profesionale që i përgjigjet profilit të psikologut shkollorë. Programi i studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Shkollore duhet t’u garantoj studentëve thellim njohurish dhe zhvillimin aftësive profesionale të nevojshme për të përmbushur me sukses kërkesat që të imponon roli profesional, gjë e cila bazuar në cv e stafit akademik ³³⁶ të angazhuar në mësimdhënie, syllabuseve ³³⁷ dhe literaturës së përdorur duket e vështirë të përmbushet me sukses. <i>GVJ rekomandon njësinë bazë të angazhohet në rekrutimin e stafit që ka kualifikimin në profilin e psikologjisë shkollore ose ekspereincë punë në linjë me profilin profesional të këtij masteri, si dhe në monitorimin me kujdes të stafit akademik të këtij programi lidhur me përditësimin e njohurive akademike në linjë me zhvillimet e fundit në këtë fushë, të cilat gjithashtu edhe duhet të shpалosen në syllabusin e lëndëve.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit,	Programi i studimit MP në “Psikologji Shkollore” synon të garantojë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit përmes një program

³³⁴ Evidenca 19. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

³³⁵ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

³³⁶ Evidenca 64. Cv e pedagogëve.

³³⁷ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

<p>humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>mësimor që prek një sër fushas të përafërta që ndihmojnë studentët në zhvillimin e aseteve profesionale të nevojshme për tu futur lehtësisht në tregun e punës. Përmes lëndëve mësimore që janë pjesë e kategorisë D, ky aspekt është shpalosur në këtë program përmes komponentëve mësimorë të praktikës profesionale.</p> <p><i>Duke iu referuar rëndësisë që ka realizimi konform kushteve të paracaktuar në Urdhër të Hapjes dt.28.05.2013³³⁸ dhe në Vendimin e Bordit të Akreditimit, nr.57, datë 05.07.2019³³⁹, sugjerohet njësia bazë dhe strukturat përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në mësimdhënie të tregojnë kujdes që kjo veprimtari formuese të realizohet në terren dhe të mos tjetërsohet forma e realizimit të saj.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Ky program studimi i hapur me urdhër të MASH Nr. 202, dt.28.05.2013³⁴⁰, akredituar me vlersim pozitiv me rekomandime sipas VBA nr.57, datë 05.07.2019³⁴¹ ka të pasqyruar në brendi të syllabuseve konform VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” si dhe Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave³⁴² kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti si në programin e studimit³⁴³ dhe në syllabuset³⁴⁴ e secilës lënde mësimore.</p> <p>Gjithashtu në këtë drejtim, njësia bazë ka realizuar në mënyrë periodike analizën e punës³⁴⁵, ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Kontrolli i Brendshëm i Cilësisë, përmes fokus-grupeve me student, ka organizuar montorimin e kënaqësisë nga shërbimet e ofruara nga AU për studentët për nivelet BA, MP, MSh.</p>

³³⁸ Evidenca 1. Urdhër për hapjen e programit të studimit MSc, Psikologji Zhvillimi dhe Shkollore dhe MP Psikologji SHkollore ne Albanina University.

³³⁹ Evidenca 12. Vendim Nr.57, datë 05.07.2019

³⁴⁰ Evidenca 1. Urdhër për hapjen e programit të studimit MSc, Psikologji Zhvillimi dhe Shkollore dhe MP Psikologji SHkollore ne Albanina University.

³⁴¹ Evidenca 12. Vendim Nr.57, datë 05.07.2019

³⁴² Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYËx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UëZËNhMËEIYjdi> (Aksesuar më 04-06-2022).

³⁴³ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

³⁴⁴ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

³⁴⁵ Evidenca 34. Model raporti I vetvlersimit të programit.



<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në lidhje me aplikimin e këtij kriteri, bazuar në takimet me stafin akademik dhe studentët, konfirmohet se realizohen seanca për të nxjerr konkluzione dhe diskutimin e orientuar të studentëve para provimeve nga secili prej pedagogëve që është angazhuar në këtë program studimi. Pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtarë realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në këtë drejtim institucioni ka praktika të mira³⁴⁶ përsa i përket hapësirave që ka stafi akademik për të përfituar nga evente të ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik, si konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, veprimtari promovuese. Personeli akademik dhe studentët janë të angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari. Ndër to mund të evidentojmë trajnime, tryeza të rrubullakta, leksione të hapura mbi përdorimin e platformës elektronike “Google Classroom” nga lektore G.R. Përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Optime” dhe pjesëmarrjes në konferencat që AU organizon pa pagesë për stafin e tij akademik krijohen mundësi të tjera në këtë drejtim. Angazhimet në aplikimin në projekte nga ana e institucionit konsiderohen me ndikim pozitiv.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në lidhje me zhvillimin e mësimdhënies mbi bazë kompetencash ka evidenca që na ndihmojnë të gjykojmë mbi këtë aspekt. Referuar këtij kriteri syllabuse të lëndëve karakterizuese jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë të cilat përmes diskutimit të studimeve të rasteve të sjella nga vetë pedagogu zhvillojnë kompetencat profesionale të studentëve. Ky aspekt bazuar te syllabuset, literature e përdorur dhe kualifikimet e stafit akademik në profilin shkollor janë të pamjaftueshme. Gjithsesi, vlerësohet që ka problematika që ndikojnë negativisht në këtë aspekt si literature e vjetëruar, të cilat nuk janë përditësuar me literaturë të 5 viteve të fundit, dhe dublimi i literaturës bazë në lëndë të ndryshme mësimore. Kjo gjë të kapërcehet nëse stafi akademik angazhohet në një proces</p>

³⁴⁶ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.



	përmirësimit të literaturës për nevojat e lëndës mësimore dhe në përputhje me emërtimin e saj.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	<p>Duke iu referuar vizitës në institucion dhe takimeve të realizuar me stafin dhe studentët rezultojnë se ora mësimore bazohet në diskutimet në grup, studimet e rasteve, shkëmbimin e ideve student -pedagog. Por referuar syllabuseve të lëndëve mësimore,³⁴⁷ literaturës së përdorur dhe kualifikimit të stafit lidhur me profilin e psikologjisë shkollore, kjo gjë shihet me dyshim. Mënyra sesi do implemetojë në planin mësimorë të lëndës interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave konkretet, në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mbetet një sfidë.</p> <p><i>GVJ sugjeron njësinë bazë në përzgjidhjen e stafit të kualifikuar në linjë me këtë profil profesional si dhe monitorimin e stafit të angazhuar në mësimdhënie në përmirësimin e literaturës bazë të përdorur për nevojat e lëndës në linjë me emërtimin dhe tipologjinë e saj.</i></p>
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	<p>Duke iu referuar një klime të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore janë element që duhen parë në vijimësi, pasi një pjesë e personelit akademik është jashtë profilit shkollor, referuar syllabuseve të lëndëve mësimore ato paraqesin probleme që lidhen me literaturën e përdorur, dhe mënyra sesi do implemetohen në planin mësimor të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mund të ketë vështirësi. Kjo duke iu referuar përvojës profesionale të një pjese të stafit mund të jetë i mundur, por programi i lëndës dhe literatura e përdorur nga personeli akademik të një pjesë e lëndëve mësimore në drejtim të procesit të mësimdhënies duhet të përmirësohet.</p> <p><i>Bazuar në këto problematika të evidentuara GVJ rekomandon një angazhim më të madh nga strukturat përgjegjëse të njësisë bazë, në monitorimin dhe miratimin e syllabuse të lëndëve mësimore pasi në këtë mënyrë rrezikohet që lëndë të ndryshme të jenë përsëritje e njohuri të nivelit bachelor.</i></p>
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të	Bazuar në përmbushjen e këtij kriteri vlersohen si positive në këtë aspekt nismat për të aplikuar në projekte apo përfshirjen në botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim

³⁴⁷ Evidenca 9. Syllabuset e lëndëve dhe programet e lëndëve.

avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	me pedagogët, apo bashkëpunimi për konferenca. Kemi disa evidenca lidhur me organizimin e konferencës studentore, e cila është e përvitshme. Në këtë konferencë, studentët duke bashkëpunuar me pedagogët e tyre paraqesin punimet e tyre kërkimore ³⁴⁸ , kjo veprimtari organizohet në nivel njësie bazë dhe kryesore. Për vitin 2020-2021 bazuar në raportin e veprimtarive ekstra kurrikulare kemi raste të studentëve të departamentit të psikologjisë së përgjithshme të përfshirë në një aktivitete ekstrakurrikulare dhe bamirësie ³⁴⁹ .			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Duke iu referuar shqyrtimit të dokumentacionit ³⁵⁰ ka evidence lidhur me përpjekjet e AU lidhur me mundësitë e përfitimit nga projektet Erasmus + apo iniciativa të tjera që nxisin mobilitetin e stafit dhe të studentëve. Por duke iu referuar stafit akademik dhe studentëve të këtij program studimi nuk kemi ndonjë veprim konkret mbi bazën e të cilit të mund të gjykojmë këtë kriter.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Bazuar në dokumentacionin institucional që AU ka dorëzuar në ASCAL, infrastruktura fizike dhe në burime njerëzore si laborator, biblioteka, platformat online, stafi akademik dhe ndihmës akademik në mbështetje të mësimdhënies për këtë program studimi kanë ndikim pozitiv. Në mbështetje të procesit mësimor kemi një sër marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit ³⁵¹ si “Shoqata e Psikologëve të Shqipërisë dhe të Kosovës”, “Organizata Plan & Go”, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i Sarajevës, dhe Shkolla e Lartë “Nehemiah Gateway”

³⁴⁸ Evidenca 18. Konferencat studentore.

³⁴⁹ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

³⁵⁰ Evidenca 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

³⁵¹ Evidenca 16. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

	<p>Bucimas, Pogradec, SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës³⁵², dhe një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”. Këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit i janë shtuar edhe disa të tjera si Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multifunkionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”³⁵³, si dhe organizatën jofitimprurëse “Rrjeti Akademik Shqiptar”³⁵⁴, Bashkia e Tiranës³⁵⁵ synojnë të mbështesin këtë program studimi në drejtim të mësimdhënies dhe të nxënies.</p> <p><i>Sugjerimet tona si GVJ, për njësinë bazë lidhen me përpjekjen për të përfshirë edhe institucione si cerdhe, kopshte, shkolla publike dhe private, me qëllim që studentët të kenë mundësi ti prekin këto terrene profesionale që përkojnë më së miri me emërtimin e këtij program studimi në profilin shkollor, që të mund t'i shërbejë nevojave të praktikës profesionale por në përgjithësi nevojës për të njohur rolin dhe detyrat e psikologut shkollorë në terma praktik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Një sër problematikash lidhen me realizimin e praktikave dhe stazhit profesional kanë të bëjnë me mënyrën e realizimit të kësaj lënde në auditor dhe e ndërthurur me përvojën në terren. Qendra e përfshira në funksion të praktikës si “Shoqata e Psikologëve të Shqipërisë dhe të Kosovës”, “Organizata Plan & Go”, Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i Sarajevës, dhe Shkolla e Lartë “Nehemiah Gateway” Bucimas, Pogradec, SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës³⁵⁶, dhe një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”. Këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit i janë shtuar edhe disa të</p>

³⁵² Edivenca 8. Marrëveshje për praktikat mësimore.

³⁵³ Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje MP Psikologji Shkollorë.

³⁵⁴ Evidenca 5, Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje AU & RASH.

³⁵⁵ Evidenca 7. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje AU & Bashkia Tirane.

³⁵⁶ Edivenca 8. Marrëveshje për praktikat mësimore.

	<p>tjera si Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multifunkionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”³⁵⁷, si dhe organizatën jofitimprurëse “Rrjeti Akademik Shqiptar”³⁵⁸, Bashkia e Tiranës³⁵⁹. Këto marrëveshje nuk i përshtaten plotësisht nevojave të këtij masteri profesional duke qenë se nuk janë në linjë me profilin e shkollor.</p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Praktikat profesionale si pjesë e kurrikulës shoqërohen me 6 kredite që fitohen nga përmbushja me sukses e të gjitha parakushteve të lëndës. Bazuar në elementët që shoqërojnë këtë lëndë në planin mësimor, kjo lëndë duhet të realizohet në terren në 120 orë. Handikapi me këtë lëndë qëndron tek realizimi i saj në auditor dhe terren. Gjithashtu referuar syllabusit të lëndës duket e paqartë mënyra sesi përcaktohet roli i supervizorit të institucionit pritës. Format i vlerësimit të praktikës me notë nga pedagogu i lëndës gjithashtu nuk të lejon të kuptosh mënyrën e vlerësimit.</p> <p><i>Sugjerohet njësisia bazë të riformulojë syllabusin e praktikës profesionale konform planit mësimorë mbi të cilin është dhënë urdhri i hapjes dhe vendimi i akreditimit të programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore”.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Standardi III.9</p> <p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e</p>	<p>Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore”³⁶⁰ dhe në manualin e punimit të</p>

³⁵⁷ Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje MP Psikologji Shkollore.

³⁵⁸ Evidenca 5. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje AU & RASH.

³⁵⁹ Evidenca 7. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje AU & Bashkia Tirane.

³⁶⁰ Evidenca 15. Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

<p>diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>temës së diplomës³⁶¹, institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për studentët, të cilët mbrojnë diplomën. Kriteret për mbrojtje diplome me temë dhe lista e pedagogëve udhëheqës për këtë program studimi bëhen të ditura përmes kordinatorit të programit. Njësia bazë ka një format të posaçëm për realizimin e recencës³⁶² dhe oponencës³⁶³ për çdo student.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe personeli akademik asistojnë studentët e MP në “Psikologji Shkollore” duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të përgatitjes së temës së diplomës. Njësia bazë zbaton procedurën e përgatitjes dhe mbrojtjes së detyrimeve përmbyllëse me temë diplome. Bazuar në formatin e njësisë bazë, kemi një manual udhëzues³⁶⁴ për mënyrën e strukturimit të temës dhe të gjitha çështjet teknike. Mbrojtja e diplomës me temë ka një procedurë që e lehtëson punën e studentit në drejtim të përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës sipas profilit të temës, si dhe monitorimin e punës përmes seancave individuale me udhëheqësin, që janë të detyrueshme nga studenti për t’u ndjekur përgjatë gjithë procesit. Monitorimin e zbatimit të këtyre procedurave e realizon njësia bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Mbështetur në procedurat e njësisë bazë mbi administrimin e mbrojtjes së diplomës për programin e studimit MP në “Psikologji Shkollore” komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e përmbushjes së kriterëve shkencorë lidhur me praninë e të gjithë elementëve shkencorë dhe profesional që përmban qasja e përdorur nga studenti konform shkrimit të një punimi kërkimor shkencorë. Duke qenë një master profesional ka mungesa të thellimuar të njohurive në planin shkencorë që përvetësohen përmes realizimit të lëndëve të metodave të kërkimit shkencorë. Gjykojmë se do ishte e vështirë realizimi i temës së diplomës konform rregullave të kërkimit shkencorë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që njësia bazë të vlersojë mundësinë e zëvendësimit të temës së diplomës me një nga format e tjera të detyrimeve përmbyllëse që i përshtaten nivelit të</i></p>

³⁶¹Evidenca 24. Manuali I punimit të temës së diplomës.

³⁶²Evidenca 37. Formulari i pedagogut udhëheqës.

³⁶³Evidenca 38. Formulari i pedagogut oponent.

³⁶⁴Evidenca 24. Manuali i punimit të temës së diplomës.

	<i>njohurive të fituara nga studentët në përfundim të masterit profesional dhe në linjë me sugjerimet që ofron VKM 41, lidhur me realizimin e detyrimeve përmblylëse përmes provimit të përgjithshëm teorik ose studimit të rastit.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Stafi akademik i këtij programi studimi ka rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për t'u njohur me opsionet e procedurat që duhet të ndjekin gjatë realizimit të temës së diplomës, rregullat dhe përgjegjësitë e palëve, problematikat me plagjiaturën etj, duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët nëse kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me metodologjinë e përdorur. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësia bazë, e cila detyron studentin dhe pedagogun në realizimin e takimeve udhëheqëse përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jashtë institucionit ^{365,366,367,368} . AU ka nënshkruar një sër marrëveshjesh bashkëpunimi, të cilat janë tepër të vlefshme për këtë profil profesional. Megjithatë kemi pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me asistimin e ofruar nga institucioni në terma faktik. Përsa i përket asistimit brenda kemi një sërë lehtësirash që e ndihmojnë studentin, si takimeve me udhëheqësin, konsultat me pedagogët aksesit në bibliotekat online, mjedisi i brendshëm i mbuluar me wi-fi, biblioteka dhe salla e leximit.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi	Udhëheqësi i diplomës përmes takimeve udhëheqëse i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore. Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor origjinal. Një tjetër element që dokumenton këtë proces dhe të orienton dhe komisionin e mbrojtjes së diplomimit është edhe relacioni që

³⁶⁵ Evidenca 16. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

³⁶⁶ Evidenca 6, Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje MP Psikologji Shkollore.

³⁶⁷ Evidenca 5, Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje AU & RASH.

³⁶⁸ Evidenca 7, Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë, Marrëveshje AU & Bashkia Tirane.

është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	udhëheqësi ³⁶⁹ dorëzon për temën e studentit që ka monitoruar. Një sistem që i lejon institucionit të monitorojë pandershmërinë dhe lufton plagjiaturën do e lehtësonte mjaft këtë proces.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në rregulloren e njësisë bazë ³⁷⁰ ; dhe rregulloren e brendshme të programit të studimit ³⁷¹ vlerësimi i studentëve në përfundim të punimit të diplomës vlerësohet me notë nga komisioni i vlerësimit. Ky komision përbëhet nga personel me grada dhe tituj akademik, i përbërë nga 3 deri në 5 anëtarë. Komision në mbrojtjen e diplomës ka në dispozicion për çdo student një relacion nga udhëheqësi dhe oponenti i temës.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën ³⁷² , listë notash dhe suplementin e diplomës ³⁷³ në programin e studimit MP në "Psikologji Shkollore". Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionin që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin me të cilin programi ka marrë vendimin për riorganizim të tij nga MASR. Ky program studimi synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë profesionale referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ³⁷⁴ .
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një kopje zyrtare të syllabuseve të këtij programi studimin në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të vetë studentit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit	Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni në fuqi. Pas përfundimit të

³⁶⁹ Evidenca 37. Formulari i pedagogut udhëheqës.

³⁷⁰ Evidenca 19. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

³⁷¹ Evidenca 19. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

³⁷² Evidenca 61. Format diplome

³⁷³ Evidenca 63. Suplement dhe listë notash.

³⁷⁴ Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. <http://ëëë.akafp.gov.al/ëp-content/uploads/2014/09/NIVELET-E-KORNIZ%C3%8BS-SHQIPTARE-T%C3%8B-KUALIFIKIMEVE.pdf> (Aksesuar më datë 04-06-2022).

dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një database të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	Zyra e burimeve njerëzore është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program studimi. Stafit akademik dhe ndihmës kanë dosjet personale me të dhëna të plota. Kjo zyrë merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik. Kjo zyrë mban evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. ³⁷⁵ GVJ gjatë vizitës në institucion u njoh me përmbajtjen e dosjeve të stafit akademik me kohë të plotë që disponon Zyra

³⁷⁵Evidencë Aneks 4 Tabelat

	e Burimeve Njerëzore. Dosjet ishin të mirëorganizuara me dokumentacionin e nevojshëm për secilin pedagog.
Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka një procedurë rekrutimi për personelin akademik përmes disa hapash që fillon me shpalljen e thirrjes online, përgatitjen e short listave për komisionin e rekrutimit, i cili merr vendimin bazë të kriterve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik, Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” etj.
Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të universitetit “Albanian University”, janë konform nenit 29, 33-38 të Statutit të Albanian University, nenit 23 të Rregullores së Përgjithshme të AU-së, nenit 10 dhe 19/4 të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të universitetit “Albanian University” dhe përzgjedhja bëhet me konkurs ³⁷⁶ . Institucioni në fillim të vitit akademik publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti konform ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Kriteret e rekrutimit të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare web www.albanianuniversity.edu.al të universitetit “Albanian university”, pas identifikimit të nevojave.
Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	Institucioni ndjek procedura rekrutimi korrekte të shpalljeve publike përmes mjeteve të komunikimit që insitucioni ka në dispozicion si faqja e universitetit dhe rrjetet sociale, sipas të gjitha kriterëve. Vlerësimi bëhet mbështetur në thirrjen ku përfshihen kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ngrihet një komision ad-hoc i propozuar nga Departamenti i Psikologjise së përgjithshme i cili i përcillet Dekanit dhe miratohet nga

³⁷⁶ Evidencë IV.1 Procedurat e rekrutimit te stafit



përmbajtjen e programit të studimit.	Rektori, "Komisioni i vlerësimit të stafit akademik", i përbërë nga Dekani, përgjegjësi i burimeve njërezore, zyra e zhvillimit të kurrikulës, përgjegjësi i departamentit si dhe një pedagog i brendshëm, të cilët bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të personelit akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore i kalon dosjet komisionit ad-hoc, i cili bën vlerësimin dhe përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit. Komisioni ad-hoc nëpërmjet Dekanit ia kalon Rektorit kandidatët e përzgjedhur për emërimin e kandidatit fitues.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Universiteti "Albanian Univeristy" angazhohet në drejtim të përmirësimit të kushteve të përshtatshme për të realizuara detyrat e gjithsecilit sipas rolit dhe përgjegjësisë. Kapacitetet infrastrukturore ³⁷⁷ në dispozicion, sallat e departamenteve, zyrat, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm. Bazuar në informacionet e marra nga takimet me stafin si dhe nga informacioni i siguruar nga RVB rezulton se mësimi fizikisht në auditor zhvillohet në përputhje me rregulloret e brendshme si dhe ligjet në fuqi. Këto sigurojnë krijimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave.

³⁷⁷ Evidencë Aneks 4 Tabelat



<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit është nën administrimin e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore. GVJ gjatë vizitës në institucion në takim me stafin e institucionit konstatoi që Zyra e Koordinimit dhe kërkimit shkencor është njësi që organizon trajnimet periodike në përputhje me kornizën dhe statutin. Gjatë takimit me këtë njësi u konstatua që kjo zyrë siguron të dhëna për nevojat për trajnime dhe kualifikime të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përmes platformës Google Forms nga formularët e vetvlerësimit që plotëson cdo pedagog i brendshëm dhe i jashtëm cdo fundviti akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni disponon një Plan strategjik të Departamentit të Psikologjisë së përgjithshme ³⁷⁸ në të cilin janë të specifikuar si pjesë përbërëse e tij kualifikimi i mëtejshëm profesional i personelit akademik. Më tej është zbatimi i tyre i cili mundësohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Koordinimit dhe Kërkimit Shkencor e cila organizon trajnimet për rritjen dhe zhvillimin e personelit. Ekipi ofrues i trajnimeve përbëhet si nga trajnues vendas ashtu dhe trajnues të huaj. Universiteti “Albanian University” në bashkëpunim me Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe njësi të tjera të institucionit organizon trajnime për kualifikimin e stafit akademik për të përdorur metodat inovative mësimore si: Workshop online tre mujor për periudhën Mars-Maj 2022 me lektorin Thomas Shrei me temë “Kirchliche pedagogische hochschule”, etj.³⁷⁹</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar. Bazuar në informacionin e dosjes së vet-vlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se lektorët e këtij program studimi mbajnë titullin Profesor i Asociuar (1), gradën shkencore “Doktor i Shkencave” (2) dhe Master shkencor (1)³⁸⁰ edhe pse bazuar te syllbuset e lëndëve mësimore ky numër nuk akordon, pasi aty kemi vetëm 3 anëtar të stafit akademik.</p> <p><i>GVJ sugjeron kujdesin në akordimin e të dhënave lidhur me numrin e stafit akademik me kohë të plotë në këtë program studimi si tek tabelat përmbledhëse, syllabuset e lëndës.</i></p>

³⁷⁸ Evidencë 1.4 Plani strategjik i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme

³⁷⁹ Evidencë III.8 Trajnime të stafit akademik

³⁸⁰ Aneks 4 Tabelat, fq 11

Shkalla e përmbyshjes së standardit	Përmbyshet plotësisht	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Universiteti “Albanian University” e përmbyshet këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Mësimi në Programin e studimit Master profesional në “Psikologji Shkollore” ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra dhe një sallë laborator të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënies³⁸¹. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, laptop, dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike. Laboratori përmban programet kompjuterike të nevojshme për plotësimin e kërkesave të këtij programi studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore në Universitetin “Albanian University” janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Laboratori i teknologjisë së informacionit që është në funksion të zbatimit të këtij programi studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparatat dhe mjetet e</p>	<p>Ky program studimi profesional zhvillohet në ambjentet e Universitetit “Albanian University”, në të cilin vihen në dispozicion salla leksionesh dhe një laborator i informatikës. Bazuar në specifikat e Masterit profesional “Psikologji</p>

<p>nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Shkollorë” mjediset në dispozicion janë të favorshëm për të realizuar qëllimet mësimore të lidhura me përvetësimin e dijeve dhe kompetencave të kërkimore shkencore dhe profesionale të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Mjediset mësimore në universitetin “Albanian University” janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si laptopë, PC, projektor, wireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Laboratori i informatikës që është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Institucioni disponon një listë marrëveshjesh me institucione shtetërore, private dhe OJF për kryerjen e praktikave profesionale pranë tyre, megjithatë pjesa më e madhe e këtyre institucioneve nuk e kanë të integruar funksionin e psikologut shkollor në organikë.³⁸² Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit³⁸³ në funksion të praktikës profesionale për masterin profesional në “Psikologji Shkollorë” kemi disa marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e lartë Universitare “Nehemiah Gateëay” Pogradec; një tjetër institucion i quajtur SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës, një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”, Bashkia Tiranë, organizata “Rrjeti Akademik Shqiptar” dhe Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”³⁸⁴. Marrëveshjet e nënshkruara nga AU në funksion të realizimit të praktikës profesionale vazhdojnë të mos kenë impakt në cilësinë e programit të studimit PM “Psikologji Shkollorë” duke mos qenë të lidhur drejtpërdrejt me fushën e psikologjisë shkollorë, por më tepër i përshtaten</p>

³⁸² Evidencë R.3 Marrëveshje për praktikën mësimore

³⁸³ Evidencë R.3. Marrëveshje për praktikën mësimore.

³⁸⁴ Evidenca 6. Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë. Marrëveshjet MP psikologji SHkollorë

	nevojave të profilit të psikologjisë klinike. <i>GVJ sugjeron që Institucioni të rregullojë praktikat profesionale përmes marrëveshjeve specifike në terma specifike, përfshirë në to edhe sistemin e mentorimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e Universitetit “Albanian University” ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolinë studimi, dy kompjutera dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme. AU disponon një Bibliotekë e cila ka një fond librash, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duke përfshirë edhe tituj të fushave të ndryshme, ndër të cilat ka dhe tituj të fushës së psikologjisë, sociologjisë dhe filozofisë ³⁸⁵ . Krahas literaturës fizike, institucioni përdor materiale ndihmëse dhe informuese për studentët si dhe forma e leksioneve në Pdf të cilat i vihen në dispozicion studenteve nëpërmjet faqes online. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të aksesojë bibliotekën online.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e	Kapaciteti që ka biblioteka garanton deri diku mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Për fushën e psikologjisë janë më shumë libra në versionin online sesa në atë të printuar. AU bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfutur edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre.

³⁸⁵ Evidencë III.9 Titujt e librave-Biblioteka

<p>përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p><i>Sugjerohet nga GVJ që fakulteti të shtojë përpjekjet për pasjen në dispozicion të më shumë librave të printuar në fushën e “Psikologjisë Shkollore” në gjuhë të huaj dhe shqip.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët e programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore” kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformat elektronike të aksesimit në tre bibliotekat online. AU ka vënë në dispozicion bibliotekën online në Elsevier, Eric, Cambrige Journals³⁸⁶. Pranë bibliotekës të AU kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët. AU bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfituar edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e AU dhe për personelin e institucionit. Për t’u bërë anëtar i bibliotekës mjafton një regjistrin i thjeshtë me një kartë indentiteti dhe studenti hap librezën e bibliotekës. Përmes saj, studentët dhe stafi kanë të drejtë të tërheqin libra nga biblioteka për afate të përcaktuara. Biblioteka on-line Elsevier, Eric, Cambrige Journals ofrojnë gjithashtu akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët si fizikisht ashtu dhe në biblioteka on-line.³⁸⁷</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>AU parashikon një buxhet vjetor për pasurimin me literaturë të fundit në bazë të kërkesave të stafit akademik paraqitur nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme realizohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të AU, sipas kërkesave të hartuara nga stafi akademik i departamentit të psikologjisë për shtimin e titujve në bibliotekë në mbështetje të programit të studimit Master profesional në “Psikologji Shkollore”³⁸⁸.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në</p>	<p>Biblioteka punon gjatë orarit 08.00-16.00. Studentët njihen me orarin në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Gjatë vizitës në bibliotekë, konstatoam që edhe gjatë sezonit të provimeve biblioteka ka të njëjtat orare. Çdo student konstatoam që kishte kartelë rregjistrimi.</p>

³⁸⁶ Evidencë 8. Vizita dy ditore në IAL, dhe dokumentacioni shtesë. Raporti vjetor NJSBC v.a.2020-2021.

³⁸⁷ Aneks 4 Tabelat

³⁸⁸ Evidencë 2.55 Propozim dhe vendim për blerjen e titujve në Bibliotekë.

përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>I gjithë informacioni në lidhje me studentët e AU menaxhohet nga sekretaria mësimore e programit të studimit përkatës, kryesekretarja e fakultetit si dhe administratori i përgjithshëm. Të dhëna në lidhje me studentët që nga pranimi deri në diplomim, statistika vjetore të ndryshme në lidhje me studentët, apo dhe largimet para përfundimit të programit të studimit etj, janë të ruajtuara jo vetëm në variant hardcopy por dhe elektronikisht. Në variantin elektronik janë të ruajtuara edhe të dhënat të regjistruara në Rregjistrin Themeltar, Rregjistrin e Indeksit, Rregjistrin e Rezultateve Akademike, Rregjistrimin e Diplomave.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua nga AU që institucioni së shpejti do të implementojë platformën “Pitagora” nga Rrjeti Akdemik Shqiptarë për menaxhimin e brendëshëm të informacionit.</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	AU nuk ka një platformë e cila ti shërbejë drejtpërsëdrejti sistemit të brendshëm të menaxhimit që administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Megjithatë i gjithë dokumentacioni në formë elektronike, si dhe komunikimet e stafit me kolegë dhe studentë realizohen përmes Microsoft office Outlook, Teams.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e	Emaili zyrtar që përdorin stafi akademik, ndihmës akademik, stafi akademik me kohë të pjeshme dhe studentët në AU është i aksesueshëm nga të gjithë.

dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.									
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Komunikimi midis stafit akademik dhe studentëve në AU mundësohet përmes platformës Microsoft Teams që AU ka vënë në dispozicion të stafit dhe studentëve. Kjo platformë shpesh përdoret edhe për lajmërimi të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre.								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	AU zotëron faqen zyrtare www.albanianuniversity.edu.al . Në këtë faqe publikohen të gjithë aktivitetet akademike dhe administrative të cilat zhvillohen në universitet. Aktivitetet pasqyrohen në gjuhën shqipe dhe anglisht. Gjithashtu, aktivitetet që ndodhin në AU pasqyrohen dhe në rrjetet sociale të cilat janë në pronësi të institucionit.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen zyrtare të "Albanian University" janë të publikuara të gjitha të dhënat mbi Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme si dhe programet që ky department ofron. Në website të AU janë të pasqyruara të dhëna dhe për stafin akademik të departamentit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të	Buxheti vjetor i akordohet AU nga Shoqëria UFO sh.p.k në përputhje me nevojat që ka si institucion. Ky buxhet bazohet në programin afatmesëm tre vjeçar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Buxheti vjetor i AU dhe buxheti afatmesëm tre vjeçar, diskutohen në Rektorat, më pas në

<p>studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Senati Akademik. Senati Akademik pasi e miraton paraprakisht ia kalon për miratim final Bordit të Administrimit të AU. GVJ konstatoi që plani i financimit të programit hartohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren. AU harton pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore shërbim të realizimit të programit shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekën on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit³⁸⁹ përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. Ky plan financimi i programit të studimit MP në “Psikologji Shkollore” është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm me anë të Zyrës së Auditit të brendshëm si dhe auditim të jashtëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare. Zyra e Auditit të brendshëm është njësi administrative e ngritur dhe funksionale brenda institucionit e cila ka si mision kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrës së financës dhe auditit të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet</p>	<p>Duke iu referuar RVB së, konstatojmë se AU ka të dokumentuara raportet financiare të tre viteve të fundit, procedurat e të cilave fillojnë të kryhen gjatë periudhës Mars-Maj. Rektoriat përgatit raportin financiar të realizuar,</p>

³⁸⁹ Aneks 4 Tabelat



e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit. Në përfundim të kësaj faze realizohet edhe një analizë që planifikon ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen për mbarëvajtjen e programve të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Duke iu referuar dhe numrit të studentëve të regjistruar çdo vit në këtë program studimi, konstatojmë si GVJ se ky program ka qëndrueshmëri financiare të mjaftueshme për përmirësim të ndjeshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmirësim i pjesshëm	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmirësim i pjesshëm	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Si GVJ konstatojmë se informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu, informacion mbi organigramën e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, dhe strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e AU si edhe një informacion më pak i detajuar shfaqet në faqen e internetit të AU. Ky program

	<p>studimi është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe kuotat e pranimit, procedurën e aplikimit publikohet online dhe është pjesë e fushatave informuese përmes broshurave³⁹⁰.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Mësohet se Universiteti “Albanian University” mbështetet në rregulloren e tij, procedurën e transferimit³⁹¹, për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje.³⁹² Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi.³⁹³ Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në faqen zyrtare të Universitetit “Albanian University” janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen e AU mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta</p>	<p>AU në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në</p>

³⁹⁰ Aneks 5 Broshurat

³⁹¹ Evidencë V.5 Shkrese për komisionin e transferimeve dhe ekuivalentimeve.

³⁹² Evidencë V.1 Rregullore e ZKMS.

³⁹³ Evidencë II.6 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve

për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Republikën e Shqipërisë”, vendimin e Senatit ³⁹⁴ si dhe Rregulloret e këtij programi studimi ³⁹⁵ , ka miratuar kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen zyrtare duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë. Pranimi i studentëve në programin Master profesional në “Psikologji Shkollore” është rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit vendoset nota mesatare në hyrje për çdo vit akademik.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Universiteti “Albanian University” angazhohet përmes një sërë formash në promovimin dhe reklamimin e programeve të studimit kryesisht duke përdorur faqen zyrtare të webi. dhe faqen zyrtare në facebook. Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në AU. Format, me të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t'u regjistruar në programin e Master Profesional në “Psikologjisë Shkollore”, janë të shumta si këshillimi në ambjentet AU gjatë periudhës së regjistrimeve, etj. <i>Sugjerimet e GVJ për njësinë bazë që të shoh mundësinë e vendosjes së kriterëve të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për të vijuar studimet në MP në “Psikologji Shkollore” me vijimësi në ciklin e parë të studimeve në Psikologji me qëllim që të lehtësohet jo vetëm trasmetimi i dijeve dhe njohurive në auditor për një grup homogjen studentësh por edhe të lehtësohet licensimi nga Urdhri i Psikologut, për studentët në përfundim të studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

³⁹⁵ Evidencë nr.1.6-Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore.pdf



<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Universiteti “Albanian University” vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit³⁹⁶ akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore, por edhe takimet informuese që realizohen ditët e para të fillimit të vitit akademik, lehtësojnë njohjen e studentit me këto procedura.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet “Java e Orientimit”, e cila është e përvitshme në AU. Gjatë kësaj jave realizohen takime, leksione të hapura për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të AU. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit. AU mundëson transferimin e studentëve sipas akteve ligjore në fuqi, procedurave të parashikuara në rregulloren mësimore si dhe në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve. Njësia bazë disponon një procedurë për njohjen e studimeve të mëparshme. Në fillim të çdo viti akademik Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme bën të mundur ngritjen e Komisionit të Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve³⁹⁷ i cili është i përbërë nga stafi akademik me një përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe njohës të specializuar të arsimit të lartë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>AU ka procedura të unifikuara për të gjithë njësitë e tij, të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të silabusit të lëndës³⁹⁸. Njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e programit profesional përgjatë fundit të semestrit të parë dhe fillimit të semestrit të dytë në lidhje me Provimin e diplomës. Për provimin e përgjithshëm përfundimtar jepet një udhëzim në lidhje me tematikat e përfshira. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me provimin e përgjithshëm përfundimtar e realizon koordinatori dhe drejtuesi i njësisë bazë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se në rregulloren e</p>

³⁹⁶ Evidencë 1.6-Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollore

³⁹⁷ Evidencë nr.V.5 Shkrese per komisionin e transferimeve dhe ekuivalentimeve.pdf

³⁹⁸ Evidencë Aneks 4 Tabelat



me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	diplomimit, studentët njihen me udhezime të specifikuara lidhur me strukturën e punimit të diplomës, i cili është gjithashtu është pjesë e prezantimit që bëhet në fillim të vitit akademik. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me mbrojtjen e diplomës me temë e realizon koordinatori i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme në bashkëpunim me njëzinë bazë dhe stafin akademik.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi. Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj çdo fillim vitit akademik AU përmes Zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë të cilët informojnë studentët me programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata në vendimarrje. Format si; njoftimet në faqen zyrtare të web, rrjetet sociale, standat e AU dhe manualit të studentit ³⁹⁹ ndërmerren me qëllim tërheqjen e studentëve të interesuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Jo përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes një mori formash. Studenti informohet duke nisur me informacionin në faqen online të AU, përmes kontratës që nënshkruan, informacionit që merr nga Zyra e koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme si dhe rregullores mësimore të programit të studimit.

³⁹⁹ Evidencë V.4 Manuali i Studentit

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Duke iu referuar RVB si dhe takimeve gjatë vizitë në institucion konstatuam se AU vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi kurrikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në bashkëpunim me Zyrën e koordinimit dhe mbështetjes për studentët, Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, organizon takime informuese me studentët si dhe u prezanton studentëve Broshurat si dhe “Udhëzuesin për zhvillimin e karrierës”⁴⁰⁰. Syllabuset e lëndëve mësimore⁴⁰¹ përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion të orientimit profesional të studentëve Zyrën e koordinimit dhe mbështetjes për studentët dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Gjatë intervistave në AU, GVJ u informua në lidhje me organizimin e panairove të punës dhe aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me aktorë nga tregu i punës si pjesë e realizimit të praktikës profesionale, si veprimtari që synojnë të qartësojnë studentët dhe të orientojnë rreth mundësive për punësimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni në lidhje me infrastrukturën dhe programin e studimit vihet në dispozicion në faqen zyrtare të “Albanian University”, si dhe në të gjitha rrjetet sociale ku ky univeristet ka llogaritë e veta zyrtare, në syllabuset e lëndëve përkatëse etj.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>GVJ ka konstatuar se AU nuk ka një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit, por arrin të përmbush informimin përmes mënyrave të tjera elektronike. Siç u lartpërmend, AU i ka të shpallura informacionet në lidhje me programin e studimit Master Profesional në “Psikologji shkollore”, në webin zyrtar www.albanianuniversity.edu.al</p>

⁴⁰⁰ Evidencë nr V.3 Udhezues per zhvillimin e karrieres.pdf

⁴⁰¹ Evidencë R.4-Syllabuset e lendeve dhe II.5 Programet lendore.pdf



lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	si dhe në postimet e ndryshme në rrjetet sociale përmes llogarive zyrtare që disponon AU.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	I gjithë informacioni i studentëve ndër vite menaxhohet nga sekretaria mësimore, kryesekretarja e fakultetit si dhe nga Administratori i përgjithshëm. Të gjithë të dhënat e studentëve gjenden të rregjistruara në databasen e sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave. Gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me dosjet e studentëve dhe regjistrin themeltar të tyre. Sekretaria disponon statistika për të diplomuarit në vite në hardcopy dhe elektronikisht. Referuar RVB dhe vizitës në institucion numri i studentëve të regjistruar për tre vite akademike në këtë program rezultoi: Për vitin akademik 2019-2020 - 24 studentë; Për vitin akademik 2020-2021 - 25 studentë; Për vitin akademik 2021-2022 - 26 studentë;
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Çdo student është i pajisur me dosjen personale, pavarësisht statusit që ka si student efektiv, i çregjistruar nga programi i studimit, apo si ish student. ⁴⁰² I gjithë ky dokumentacion gjendet i arkivuar pranë sekretarisë mësimore, kryesekretarisë së Fakultetit. Çdo vit AU harton statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, të largimeve para përfundimit të programit apo të mospërfundimit me sukses të programit të studimit si dhe të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

⁴⁰² Evidencë Tabelat

<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në AU se të dhënat statistikore burojnë nga Rregjistri themeltar, Rregjistri i Indeksit, Rregjistri i rezultateve akademike si dhe Rregjistri i diplomave. Të dhënat statistikore gjenden në AU në version elektronik dhe letër. Këto të dhëna raportohen rregullisht pranë MASR dhe rektoratit të AU.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Zyra që merret me regjistrimin e studentëve, sekretaria mësimore në AU është strukturë e posaçme që merret me ruajtje dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e saj në drejtim të menaxhimit të rekordeve të studentëve realizojnë edhe përmes sistemit informatik të rregjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e AU. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin informatik për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Raportet analitike mbi profilet e studentëve të ardhur, aktualë si dhe shkalla e punësimit të studentëve në AU realizohen nga Zyra e sekretarisë mësimore, zyrës së Karrierës dhe Alumnit si dhe Departamentit të Psikologjisë së përgjithshme. Nga të dhënat që paraqet zyra e Karrierës dhe Alumnit rezultojnë së më shumë se gjysma e të diplomuarve në programin Master profesional “Psikologji shkollorë” janë të punësuar në profilin e psikologut shkollor në institucion publike dhe jo publike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbyhet pjesërisht</p>	<p>Përmbyhet kryesisht</p>	<p>Përmbyhet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe</p>	<p>Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet</p>

<p>angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>vendimmarrëse. Përfshirja e studentëve në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli studentor, Komisioni për kurrikulat dhe mësimin, Komisioni për vlerësimin intitucional, Komisionin për kërkimin shkencor dhe Botimin, si dhe në komisionet për hartimin e RVB⁴⁰³ në raste akreditimi institucional ose programesh studimi është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren dhe statutin e vetë AU.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve në AU. Ato janë pjesë aktive e mbedhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit dhe sipas interesave personale. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes pyetësorëve dhe përmes takimeve në grup.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi MP në “Psikologji shkollorë” është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni dhe me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestral. Ka rregullore dhe procedura që lehtësojnë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të realizuara më pare ose më pas nga studenti.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët përfshihen në Komisionin për kurrikulat dhe mësimin, Komisioni për vlerësimin Institucional si dhe Komisioni për kërkimin shkencor dhe botimin (Komisione të përhershme). Duke pasur këtë përfshirje në vendimmarrje idetë dhe sugjerimet e tyre merren në konsideratë për të rishikuar dhe përmirësuar programin e studimit.</p> <p>GVJ konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion përfshirjen e studentëve në procese të rëndësishme të zhvillimit të programit të studimit Master Profesional “Psikologji</p>

⁴⁰³ Evidencë H. Ngritja e grupit te vleresimit te brenshem.pdf



	Shkollorë". Gjatë intervistës me GVB studentja u përfshi në diskutimet në lidhje me ecurinë e programit të studimit. ⁴⁰⁴			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit ⁴⁰⁵ . Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ka Zyrën e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në "Albanian University" e cila është në shërbim të informimit të studentëve. Kjo zyrë përdor faqen zyrtare të webit www.albanianuniversity.edu.al ku pasqyron aktivitetet që zhvillohen në AU dhe përditëson informacione të detajuara për studentët, stafin dhe palët e treta. Institucioni është aktiv dhe në rrjetet sociale.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje	AU ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion vihet re se veprimtaria e kordinatorit të programit, njësia bazë dhe Zyra e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj

⁴⁰⁴ Vizita dy ditore në IAL

⁴⁰⁵ Evidencë nr.1.6-Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Shkollorë.pdf



<p>që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentëve orientohen drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj. Zyra e Karrieres dhe Alumnit ka hartuar Udhëzuesin e studentëve për zhvillimin e karrierës i cili i vihet në dispozicion studentëve.⁴⁰⁶ Po ashtu ky institucion me qëllim mbështetjen profesionalisht të studentëve dhe ti ndihmojë ata në planifikimin e karrierës ofron dhe udhëheqje dhe kujdestari (tutorat) për studentët dhe përgjegjëse për këtë është zyra koordinimit dhe e mbështetjes ndaj studentëve e cila ofron mbështetje në drejtim të koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve për tu orientuar në tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e kordinimit dhe mbështetjes ndaj Studentëve si dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Këto zyra janë në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Në AU funksionon Alumni, me të cilët bëhen takime të përvitshme për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. Këshilluesi i karrierës është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë javës dhe ofron një sërë shërbimesh si këshillim karriere, informacion mbi vende të lira pune, informacion mbi praktikën profesionale, informacion në lidhje me trajnimet dhe workshop-et etj.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion</p>	<p>Zyra e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të AU e cila ka si objektive të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim</p>

⁴⁰⁶ Evidencë nr V.3 Udhëzues për zhvillimin e karrieres.pdf

studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	vlerësimin më objektiv të mundësive që studentit ka në dispozicion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm. Universiteti “Albanian University” ka miratur një grup pune, i cili do të drejtojë këtë strukturë, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. ⁴⁰⁷
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për	Struktura e Njsbc në AU është një strukturë e ngritur që në vitin akademik 2009-2010. Kjo njësi është ngritur konform ligjit të arsimit të lartë, Kodit të cilësisë, si dhe me Vendim të Senatit akademik të AU me nr 178, datë 23/07/2010 ⁴⁰⁸ . Gjithashtu, në mënyrë që sistemi i sigurimit të cilësisë të konsolidohet më tej AU ka ngritur me vendim të Senatit

⁴⁰⁷ Evidencë nr. VI.8-Rregullore Njsbc.pdf

⁴⁰⁸ Evidencë nr. VI.1-Vendim Senati mbi ngritjen e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pdf.pdf

<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>akademik edhe Komisionin e Përhershëm të vlerësimit institucional, strukturë në të cilën AU ka përfshirë dhe një student⁴⁰⁹. Studentët janë të përfshirë gjithashtu, edhe në rastet kur AU ndërmerr akreditime të jashtme në nivel institucional ose të programeve të studimit.⁴¹⁰ AU me qëllimin e konsolidimit të kulturës së cilësisë në institucion ka ngritur gjithashtu dhe Grupin e Sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë, ku anëtarësia e grupit përditësohet çdo vit.⁴¹¹ AU ka të miratuar në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë edhe Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.⁴¹² AU në zbatim të Strategjisë institucionale si dhe Strategjisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë me qëllimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë të programeve dhe kurrikulave angazhon ekspertë të jashtëm.^{413 414}</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni ka aplikuar për riakreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat burokratike që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të riakreditimit për këtë program studimi, por jo vetëm. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato</p>	<p>Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes planit të saj të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë trajnime me stafin akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre trajnimeve do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencorë, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët,</p>

⁴⁰⁹ Evidencë nr. VI.2-Vendim Senati mbi krijimin e Komisioneve të Përhershme në rang Institucional_pdf.pdf

⁴¹⁰ Evidencë H. Ngritja e grupit të vlerësimit të brendshëm.pdf

⁴¹¹ Evidencë nr VI.3-VS Sigurimi cilësisë-Njesia bazë.pdf

⁴¹² Evidencë nr. VI.4-Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_pdf.pdf

⁴¹³ Evidencë nr. VI.5.a-Vendim i Bordit të Administrimit_konsulete juridike pranë NJSBC Dr .Entjola Pano (1).pdf

⁴¹⁴ Evidencë nr. VI.5.b-Vendim mbi caktimin e personelit akademik si konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Prof.Asoc (1).Be.pdf

<p>synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>zyra e karrierës, kordinatorët e departamenteve dhe senati akademik. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në universitet, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme plotëson raportin e vetvlerësimit të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>AU ka ngritur në nivel departamenti struktura specifike për ruajtjen, përmirësimin dhe monitorimin e cilësisë. Grupet e sigurimit të cilësisë të ngritura në nivel departamenti⁴¹⁵ janë komisione të ngritura Ad-hoc të cilat kanë në përbërje të tyre 2-3 anëtarë të stafit akademik të brendshëm. Këto komisione punojnë për rishikimin e kurrikulave, silabuseve në bashkëpunim me titullarët e lëndëve përkatëse. Gjithashtu, këto komisione kanë detyrë të hartojnë RVB për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhurnimin e syllabuseve. Për të nxitur dhe monitoruar procese të tilla një rol kyç luan</p>

⁴¹⁵ Evidencë nr VI.3-VS Sigurimi cilesise-Njesia baze.pdf



	<p>Departamenti, Komisioni i Sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave në AU,⁴¹⁶</p> <p><i>GVJ nga verifikimet e bëra për syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi sugjeron se Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe Zyra e Zhvillimit të kurrikulave duhet të ndër marrë masa urgjente në monitorimin e mënyrës së ndërtimit të syllabusit të lëndëve sipas standarteve të institucionit dhe legjilacionit në fuqi, për programin e studimit Master profesional në “Psikologji shkollore”.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përdor metodologji vlerësimi si dhe instrumente matëse vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit MP “Psikologji Shkollore” të tilla si: metoda të tërthorta pyetësorë të studentëve (2 herë në vit)⁴¹⁷; fokus grupe (në fund të vitit)⁴¹⁸, mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës pyetësorë për pedagogët,⁴¹⁹ etj. Komisioni njofton në mënyrë zyrtare strukturat përgjegjëse dhe përgjatë procesit të monitorimit përdor format raporte që të japin mundësi të vlerësosh aspekte të ndryshme që lidhen me mënyrën sesi respektohen standartet nga strukturat përgjegjëse.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>NJSBC pas realizimit të procesit monitorues, harton një raport, i cili u përcillet departamenteve për reflektim. Kjo nënkupton që departamentet mund të argumentojë dhe qartësojnë disa aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve. Procedura që ndiqet është e tillë që pas përfundimit dhe mbledhjes së të dhënave informacioni / raporti i dërgohet Rektoratit dhe çdo njësi bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, departamentit i diskuton dhe ia komunikon personelit akademik. Këto gjetje diskutohen dhe në mbledhje të Senatit Akademik, si dhe pasqyrohen në raportet vjetore të AU.</p>

⁴¹⁶ Evidencë nr VI 6 Rregullore e zyrës njësisë së monitorimit të kurrikulave (1).pdf

⁴¹⁷ Evidencë nr. III.1-Pyetësori i studentëve-broshura (1).pdf

⁴¹⁸ Evidencë nr. III.2-Shkresë për fokus grupet.pdf

⁴¹⁹ Evidencë nr. III.4-Formulari pedagogut.pdf

<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se raportin e vetëvlerësimit të programit të studimit kryhet në përfundim të çdo viti akademik dhe ky proces përfshin të gjithë aktorët duke filluar që nga Njësia Bazë me grupet e sigurimit të cilësisë. Përsa i përket strukturës që merret me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ai është i lidhur me KSBC. Kjo strukturë monitoron standartet e cilësisë për të gjitha programet e studimit në rang universiteti. Grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë është ngritur nga departamenti me qëllim hartimin e një raporti vlerësimi të brendshëm për këtë program studimi. Kjo njësi pasi e përfundon raportin ja dërgon NJSBC e cila e përfshin në raportin e saj vjetor.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Albanian University”, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor</p>

	<p>metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: pyetësi i studentëve, takimet në grup që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që të masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se ndër metodat të drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni përfshijnë vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e</p>	<p>Dy herë në vit NJSBC realizon pyetësorë me studentët aktualë, si dhe një herë në vit fokus grupe. Gjithashtu, AU ka ndërmarrë dhe vlerësimin e personelit akademik me kohë të plotë.⁴²⁰ Duke iu referuar RVB dhe intervistave gjatë vizitës në AU konstatoam se zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me Alumnin.</p>

⁴²⁰ Evidencë nr. VI.7-Pyetesori i personelit akademik.pdf

dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti “Albanian University” përpiqet të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të paramentrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të palëve të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e NJSBC. KSBS përmes aktiviteteve që ndërmer synon të garantojë sigurimin e cilësisë.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimin të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupi i vlerësimin të brendshëm. Personeli ndihmësakademik e administrativ ka mbështetur punën e

administrativ dhe studentët e programit të studimit.	grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtrojnë detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu, edhe përfshirja e studentëve në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Përbërja e GVB është e përbërë vetëm nga anëtare të brendshëm të departamentit dhe një student. ⁴²¹ Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët departamenti bashkëpunon mund të ishte një mundësi e mirë për marrjen e opinioneve që do të përmirësonin cilësinë e këtij programi studimi. <i>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ sugjeron se institucioni duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmes	Përmes pjesërisht	Përmes kryesisht	Përmes plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit MP në "Psikologji shkollore" janë transparente. Politikat e institucionit në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksionin të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë

⁴²¹ Evidencë H. Ngritja e grupit të vlerësimit të brendshëm.pdf

	<p>trasparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e AU. Në funksion të transparencës do të ishin të nevojshme vijimi i praktikës së mirë të nisur si diskutimet me stafin dhe studentët, fokusgrupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin transparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, dhe gjithashtu do të lejonin marrjen e një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike – profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e AU. Raportet janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi këto vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë dhe nuk ka evidenca që na japin mundësi të gjykojmë mbi çënimin e lirisë për të dhënat personale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se insitucioni sigurohet që raportet dhe rezultatet e vetëvlerësimit të programit përfshijnë edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi. Institucioni në këto dokumenta kryen dhe adresimin e masave që duhen analizuar dhe reflektuar. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimit e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përse i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të</p>	<p>Universiteti “Albanian University”, në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësive, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet</p>



cilësisë së programit të studimit.	institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, si dhe ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Bazuar në dokumentacionin dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në Universitetin “Albanian University”, GVJ konkludon se institucioni me anë të veprimtarive periodike si java e orientimit, sesione trajnimi të shumta që realizon në fillim të çdo viti akademik, realizon shumë mirë informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Një sërë strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (KSBC, GVB) staf akademik dhe studentë me qëllimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë si një detyrim që e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret e AU, statuti, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: “Psikologji Shkollore

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik;
2. Abonimi në bibliotekat online dhe platformat elektronike në funksion të procesit të mësimdhënies;
3. Klima pozitive në komunikimin midis stafik akademik dhe studentëve të këtij programi studimi;



4. Nxitja e shkëmbimeve në arsimin e lartë për stafin akademik dhe studentët, përmes Erasmus +;
5. Veprimtaritë ekstrakurrikulare të realizuara nga institucioni ndihmojnë në avancimin në kërkimin shkencor për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi;
6. Infrastruktura fizike në funksion të këtij programi studimi u jep mundësi studentëve të këtij programi për kushte të përshtatshme në të cilin realizohet procesi i mësimnxënies;

b. Pika të dobta:

1. Syllabuset e programit të studimit paraqesin mangësi në drejtim të instrumentave të nevojshëm që të lejojnë përkthimin e aftësive didaktiko-akademike në kompetenca profesionale;
2. Syllabuset e programit të studimit paraqesin mangësi në organizimin e formulimin e tematikave, literature e papërshtatshme në funksion të realizimit të programit të studimit;
3. Një pjesë të pedagogëve jasht profilit profesional të psikologjisë shkollore;
4. Praktika profesionale realizohet e ndërthuruar midis orëve në auditor e terren dhe mungesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikën me insitucioneve publike të arsimit parauniversitar si shkolla, cerdhe, kopshte sipas profilit profesional të këtij programi studimi;
5. Syllabusi i praktikës profesionale paraqet boshllëqe lidhur me formën e organizimit dhe mungesa e përfshirjes në brendi të sistemit të mentorimit;
6. Mungesa e aplikimit në projekte kombëtare e ndërkombëtare në fushën e psikologjisë shkollore nga ana e stafit akademik të këtij program studimi;

Rekomandime

1. Përfshirja në syllabuset e programit të studimit të instrumentave të nevojshëm për përkthimin e aftësive didaktiko-akademike në kompetenca profesionale;
2. Institucioni të rishikoj syllabuset e programit të studimit lidhur me organizimin dhe formulimin e tematikave si dhe përditësimin e literaturës në funksion të realizimit të programit të studimit, mbështetur në programe të ngjashme në nivel kombëtar e ndërkombëtare;
3. Një vëmëndje e shtuar duhet të tregohet në lidhje me disa pedagogë të cilët u përkasin disiplinave të tjera dhe që mund të cungojnë nivelin e njohurive të trasmetuara tek studentët e masterit profesional në “Psikologji Shkollore”;
4. Si formë e menaxhimit të detyrimeve përmbyllëse në kuadër të diplomës, konform akteve ligjore në fuqi (VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe VKM Nr.185, datë 25.03.2021), mund shfrytëzohen dy opsione: ai i dhënies së një provimi të përgjithshëm të formimit teorik , ose dosje profesionale përmes një studimi rasti;
5. Realizimin e lëndës së praktikës profesionale konform rregullave në fuqi (VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe VKM Nr. 185, datë 25.03.2021) dhe mënyrës sesi është dhenë leja për hapje dhe akreditimi i mëparshëm për programin e studimit MP në “Psikologji



Shkollore si dhe përfshirjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shkolla, cerdhe, kopshte publike e private;

6. Institucioni të rregullojë praktikat profesionale përmes marrëveshjeve institucionale në terma specifike, duke përfshirë në to edhe sistemin e mentorimit;
7. Institucioni të shtoj aplikimet në projekte aplikative kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e psikologjisë shkollore dhe të mundësojë përfshirjen në to të stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle of "Professional Master" in "School Psychology"

a. Strengths and affirmations:

1. Involvement of the student in the periodic evaluations of the forms of teaching and of the academic staff;
2. Subscription to online libraries and electronic platforms as part of the teaching process;
3. Positive climate in the communication between the academic staff and the students of this study program;
4. Promoting exchanges in higher education for academic staff and students, through Erasmus +;
5. The extracurricular activities carried out by the institution help to advance in scientific research for the academic staff and students of this study program;
6. The physical infrastructure in function of this study program gives opportunities to the students of this program for suitable conditions in which the learning process is realized;

b. Weaknesses:

1. The syllabus of the study program presents shortcomings in terms of the necessary instruments that allow the translation of didactic-academic skills into professional competencies;
2. The syllabus of the study program represents deficiencies in the organization and formulation of topics, inappropriate literature in function of the realization of the study program;
3. A part of the pedagogues outside the professional profile of school psychology;
4. The professional internship is intertwined between the classes in the auditorium and in the field and the lack of cooperation agreements for the internship with public institutions of pre-university education such as schools, kindergartens, nursery according to the professional profile of this study program;
5. The syllabus of professional practice presents gaps regarding the form of organization and the lack of involvement within the mentoring system;

6. Lack of application in national and international projects in the field of school psychology by the academic staff of this study program;

Recommendation:

1. Inclusion in the syllabus of the study program of the necessary instruments for the translation of didactic-academic skills into professional competencies;
2. The institution needs to review the syllabus of the study program regarding the organization and formulation of topics as well as the updating of the literature in order to realize the study program, based on similar programs at national and international level;
3. Increased attention should be paid to some professors who belong to other disciplines and who may truncate the level of knowledge transmitted to professional master students in "School Psychology";
4. As a form of management of closing obligations within the diploma, in accordance with the legal acts in force (DCM No. 41, dated 24.01.2018 and DCM No. 185, dated 25.03.2021), two options can be used: that of granting a general examination of theoretical formation, or professional portfolio through a case study;
5. Implementation of the course of professional practice in accordance with the rules in force (DCM No. 41, dated 24.01.2018 and DCM No. 185, dated 25.03.2021) and the manner in which the permit for opening and previous accreditation was given for the MP study program in "School Psychology as well as the inclusion of cooperation agreements with public and private schools, kindergarten and nursery;
6. The institution needs to regulate professional practices through institutional agreements in specific terms, including the mentoring system;
7. The institution needs to increase the applications in national and international applied projects in the field of school psychology and to enable the inclusion in them of the academic staff and students of this study program;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

